



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME PLENARE TË KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 21 PRILL 2013**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE
KOSOVA, ODRŽANE 21. APRILA 2013. GODINE**

**PRILL - APRIL
2013**

Rendi i ditës

1. Raportimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës në Kuvendin e Kosovës për Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, e parafuar më 19 prill 2013, nga kryeministri i Republikës së Kosovës dhe kryeministri i Republikës së Serbisë

Dnevni red

1. Izveštavanje premijera Republike Kosova u Skupštini Kosova za porazum normalizacije odnosa Republike Kosova i Srbije, koja je parafirana 19. aprila 2013. godine od premijera Republike Kosova i premijera Republike Srbije

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar ambasadorë dhe diplomatë të akredituar në Kosovë,
Të nderuar qytetarë,
I hap punimet e mbledhjes plenare të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së kryeministrit të Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

E kemi vetëm një pikë të rendit të ditës:

1. Raportimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës në Kuvendin e Kosovës për Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, e parafuar më 19 prill 2013, nga kryeministri i Republikës së Kosovës dhe kryeministri i Republikës së Serbisë

Kryeministri i Kosovës i është drejtuar kryetarit të Kuvendit me kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme më 21 prill 2013, në orën 20:00, për të raportuar para Kuvendit të Republikës së Kosovës për Marrëveshjen për normalizimin e raporteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, e cila është parafuar më 19 prill 2013 nga kryeministri i Republikës së Kosovës dhe kryeministri i Serbisë.

E ftoj kryeministrin ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Krasniqi,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,
Të nderuar ambasadorë të vendeve të Bashkimit Evropian, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të organizatave të ndryshme ndërkombëtare,
Zonja dhe zotërinj,
Fillimisht më lejoni që, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të falënderoj dhe përshëndes Rezolutën e Parlamentit Evropian për heqjen e fusnotës për Kosovën, që ndodhi dy ditë më herët.

Më lejoni ta falënderoj Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës që e ka miratuar kërkesën time, të bazuar në nenin 69, paragrafi 4, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe neni 38, paragrafi 2, pika b, të Rregullores së Kuvendit të Kosovës për ta thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme ndërmjet së cilës, në cilësinë time si kryeministër i Republikës së Kosovës, kam kërkuar që t'i informoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për rundin e nëntë dhe të dhjetë të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që është zhvilluar në Bruksel, me ndërmjetësimin e baroneshës Eshton, më 17 dhe 19 prill 2013.

Duke mos dashur të përsëris në tërësi rrjedhën e gjithë procesit, që nga momenti i fillimit zyrtar të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili filloi në muajin tetor të vitit të kaluar, unë sot do të përqendrohem vetëm në raportimin e gjithë asaj që është arritur në takimin e nëntë dhe dhjetë, që rezultoi edhe me arritjen e marrëveshjes së parë të parimeve udhëheqëse për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë.

I nderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,
Edhe një herë dëshiroj të ju falënderoj të gjithëve për mundësinë që na keni dhënë vazhdimisht për të ju informuar dhe raportuar pas çdo takimi.

Ju falënderoj për besimin dhe mbështetjen tuaj, por i falënderoj edhe kritikët ndaj këtij procesi me sugjerimet e tyre, kritikën e tyre dhe unë që në fillim dëshiroj të theksoj se ato kritika na kanë ndihmuar që ne të jemi edhe më këmbëngulës, edhe më aktivë, edhe më dinamikë, edhe më pozitivë dhe të përgjegjshëm në proceset që kemi kaluar. Pra, edhe këto kritika kanë qenë ndihmuese.

Pardje, pra të premten, më 19 prill 2013, në Bruksel, Kosova e përmbylli edhe një tjetër pjesë thelbësore të konsolidimit të shtetësisë së saj.

Pardje, Republika e Kosovës e vulosi shtrirjen e sovranitetit, të ligjshmërisë dhe Kushtetutës së saj në tërë territorin e vendit.

Pardje, Republika e Kosovës çimentoit të ardhmen e saj në familjen e madhe evropiane.

Të premten, në Bruksel, si rezultat i një pune shumë të madhe dhe serioze, e ardhmja e ndritur ngadhënjeu mbi të kaluarën e hidhur. Edhe pse marrëveshja nuk është ideale, që do ta dëshironim të gjithë ne, megjithatë është marrëveshja më e mirë e mundshme.

Them kështu me plot përgjegjësi, sepse jam i bindur se kjo marrëveshje ndërshtetërore, e arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e që është e para e kësaj natyre, i hap rrugë të sigurt integritetit të Kosovës dhe i jep fund njëherë e përgjithmonë izolimit.

I nderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,
Ka qenë një rrugë e gjatë dhe jo e lehtë, një cikël i gjatë plot një shekull, i cili në pjesën më të madhe ka qenë i hidhur dhe me plot dhimbje. Është në rrugë të mbarë për t'u përmbyllur me sukses.

Kosova e ka shënuar dhe vulosur njëherë e përgjithmonë shtetësinë dhe sovranitetin e saj.

Gjatë gjithë këtij procesi të këtyre negociatave gjashtëmujore, e më herët negociatave teknike, njësoj siç na ka ndodhur në proceset e mëhershme, si në Rambuje dhe në Vjenë, unë dhe ekipi im i shkëlqyeshëm, me mbështetjen tuaj, e kemi pasur në mendje dhe kemi i kujtuar të gjitha përpjekjet tona të gjatë dhe të mundimshme për liri e shtetësi.

Në çdo moment i kam kujtuar sakrificat tona, humbjet dhe dhimbjet tona. I kam pasur në mendje dhe do t'i mbaj përgjithmonë bashkëluftëtarët e mi, dëshmorët e lirisë, heronjtë e kombit, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës. I kam pasur në mendje dhe në shpirt familjet e tyre, kolonat e gjata të qytetarëve tanë të dëbuar e të pastrehë nga Serbia, mësuesit tanë që pa asnjë kompensim material na frymëzuan e mësuan çdo ditë. Minatorët tanë krenarë, mjekët që na i shëruan plagët dhe që tani përkujdesen për shëndetin e qytetarëve të vendit tonë. Pensionistët që me punën e tyre kanë ndërtuar Kosovën tonë, e shumë e shumë të tjerë.

Por, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Dhe ju qytetarë të Republikës së Kosovës, Republikës sonë krenare,
Mbi të gjitha, në momentet vendimtare, në mendje dhe shpirt i kisha fëmijët tanë dhe të ardhmen e tyre. E kisha në mendje të ardhmen e fëmijëve tanë dhe doja të sigurohesha që ata kurrë të mos e përjetojnë luftën që e përjetuam ne dhe gjeneratat përpara nesh. Pra, ishte përkushtimi për të ardhmen e sigurt evropiane ai që më dha mua dhe ekipit tim forcë dhe energji për ta pranuar marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilën ju tash më e keni në duart e tuaja dhe e keni lexuar.

I nderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,
Kjo marrëveshje është marrëveshje për të ardhmen, për paqen dhe për integritet euroatlantike. Kjo është marrëveshje e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Është marrëveshje nëpërmjet së cilës ne do ta shtrijsim autoritetin tonë në tërë territorin e Kosovës.

Kushtetuta dhe ligjet tona do të funksionojnë në tërë territorin e shtetit tonë. 14 vjet pas çlirimit dhe 5 vjet pas shpalljes së pavarësisë, ne do t'u japim fund strukturave ilegale të Serbisë në veri të vendit tonë. Dhe, Serbia e ka pranuar tashmë këtë fakt. E ka nënshkruar.

Me maturi dhe nacionalitet kemi arritur që bashkërisht me partnerët tanë ndërkombëtarë, Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ta ruajmë karakterin unitar të shtetit tonë në Dogana, Polici dhe Gjyqësi.

Marrëveshja në asnjë pikë, në asnjë moment, nuk e cenon funksionalitetin e shtetit tonë, nuk e cenon ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e shtetit tonë. Përkundrazi, mundëson që pas shumë vitesh të mungesës së sundimit të rendit dhe ligjit në veri të vendit tonë, tani e tutje, rendi kushtetues i Kosovës do të shtrihet dhe respektohet në çdo cep të vendit tonë.

Sigurisht, marrëveshja ideale do ta nënkuptonte një të tillë që do t'u mundësonte sot Kosovës dhe Serbisë shkëmbimin e notave verbale të njohjes reciproke edhe formalisht, por edhe kjo në të ardhmen do të ndodhë.

Megjithatë, më lejoni ta përdor një shprehje amerikane e cila thotë: “E përkryera nuk duhet të jetë armik i së mirës”. E unë, me plot bindje e them se kjo marrëveshje është më e mira e mundshme për rrethanat e tanishme.

I nderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,
Kabinet qeveritar,
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni po ashtu të ju drejtohem me një mesazh qytetarëve në veri të vendit tonë. Të nderuar qytetarë, mos u frikësoni nga kjo marrëveshje, mos bini pre atyre që tani 14 vjet e kanë mbajtur peng të ardhmen tuaj, mos bini pre atyre që tani 14 vjet e shfrytëzuan mungesën e rendit dhe ligjit për t'u pasuruar dhe për të përfituar në emrin tuaj. Marrëveshja dhe implementimi i saj do të sjellë mundësi të reja për ju dhe fëmijët tuaj. Marrëveshja do të sjellë më shumë ligjshmëri, më shumë zhvillim, më shumë investime dhe më shumë mundësi për punësim. Ju nuk keni arsye për t'u frikësuar. Ju keni fituar dhe Kosova ka fituar. Ka fituar i gjithë rajoni.

I nderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,
Kabinet qeveritar,
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni ta ritheksoj edhe një herë se marrëveshja e arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, është jashtëzakonisht e rëndësishme për vetë faktin se është marrëveshja e parë, e cilat pritet të ratifikohet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Tani më lejoni që ta prezantoj marrëveshjen në tërësinë e saj dhe t'i japë sqarimet përkatëse, ligjore dhe politike për secilën pikë që përmban ajo.

Do të filloj nga titulli i saj, si në vijim: Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve.

Nga vetë emërtimi i marrëveshjes, lehtë e kuptojmë se kjo marrëveshje, për të cilën po diskutojmë ne sot dhe për të cilën unë shpresoj se do të marr autorizimin e Kuvendit të Kosovës për ta nënshkruar dhe pastaj edhe ratifikuar nga ju, të nderuar deputetë, paraqet

vetëm marrëveshjen e parë, për të cilën lirisht mund të them më të rëndësishme në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Siç e keni të qartë edhe nga vetë përmbajtja e pikave të kësaj marrëveshjeje, procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të vazhdojë në faza tjera dhe ky proces mund të quhet i përmbyllur vetëm atëherë kur Serbia do ta njohë shtetësinë e Kosovës dhe dy shtetet do të vendosin marrëdhënie diplomatike ndërmjet tyre.

Bazuar në suksesin e arritur me marrëveshjen e parë të rëndësishme ndërmjet dy shteteve, unë mbetem optimist se diku nga fundi i këtij procesi të normalizimit të marrëdhënieve, Serbia do ta marrë vendimin e duhur për ta njohur shtetin e Kosovës dhe pastaj do të ndodhë njohja reciproke.

Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,
Pika e parë e marrëveshjes thotë:

1. Do të krijohet një asociacion, bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Anëtarësia do të jetë e hapur për çdo komunë tjetër, nëse anëtarët janë në pajtim.

Sqarim: Kjo pikë e parë është plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Ky parim në asnjë rrethanë nuk paraqet tejkalimin e kompetencave të nivelit qendror apo atij lokal, apo të fuqive juridike dhe legjislative.

2. Bashkësia/Asociacioni do të formohet nëpërmjet statutit. Shpërbërja e tij mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse, do të ketë garanci ligjore nëpërmjet ligjit të zbatueshëm dhe ligjit kushtetues, përfshirë rregulloren për shumicën prej 2/3.

Sqarim: Themelimi dhe shpërbërja e këtij asociacioni janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet përkatëse dhe ky parim është i natyrës së njëjtë me mënyrën se si themelohen dhe shpërbëhen asociacionet e ndryshme.

Kushtetuta dhe ligjet tona i përmbajnë dispozitat përkatëse ligjore, të cilat garantojnë përfaqësimin adekuat të komuniteteve dhe ruajtjen e karakterit multi-etnik në të gjitha institucione shtetërore të Kosovës.

Në rast se bëhen pyetje të shumta se përse, dhe e di se do të bëhen pyetje të shumta, se përse ne kemi pranuar përdorimin e termit “Bashkësi”, dhe jo vetëm “Asociacion”, natyrisht se unë sqaroj para juve, deputetë të nderuar, Kabineti qeveritar dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke theksuar se Serbia ka insistuar që ta përdoret termi “Bashkësi”, ndërsa ne kemi insistua që të përdoret termi “Asociacion”. Si kompromis i përbashkët jemi pajtuar që të përdoren të dyja termet.

Mirëpo, për sqarimin tuaj dhe për t'i shmangur keqkuptimet e mundshme, dua të sqaroj se asociacion apo partneritet mund të quhet çfarëdo iniciative, e cila preferon të emërtohet ashtu, duke u bazuar në ligjet dhe parimet e përgjithshme dhe në përputhje me ligjet e Kosovës.

3. Struktura e Asociacionit-Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë si edhe statuti i asociacionit të komunave të Kosovës. Si për shembull, kryetari, nënkryetari, Kuvendi, Këshilli.

Sqarim: Ky parim e specifikon qartë atë çfarë e kemi thënë shumë herët, që asociacioni i komunave me shumicë serbe në Kosovë do të ketë të njëjtën strukturë si të asociacionit të komunave të Kosovës edhe asociacioni aktual i Kosovës e ka edhe kryetarin apo presidentin, siç po kanë dëshirë t'i thonë, edhe zëvendëskryetarin, edhe Kuvendin, edhe Këshillin, edhe Bordin. Një gjë e tillë është krejtësisht në përputhje me ligjet dhe normat juridike të Kosovës.

4. Në përputhje me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjes Lokale dhe sipas ligjeve të Kosovës, komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë me ushtrimin kolektiv të kompetencave të tyre nëpërmjet Bashkësisë-Asociacionit. Asociacioni-Bashkësia do të kenë vështirësi të plotë mbi fushat, si zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, planifikim urban dhe rural.

5. Asociacioni-Bashkësia do të ushtrojë kompetenca të tjera, siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore.

Sqarim për pikat katër dhe pesë: Pikat katër dhe pesë po ashtu janë kushtetuese dhe ligjore. Bazuar në ligjet e Kosovës, autoritetet qeveritare, në të gjitha nivelet, kanë të drejtë t'i ushtrojnë të drejtat e tyre edhe nëpërmjet mekanizmave të tjerë, siç është ky asociacion.

Kjo nënkupton se komunat, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e këtij asociacioni, mund ta delegojnë një pjesë të kufizuar të autoritetit të tyre tek asociacioni për t'i kryer këto funksione të caktuara publike.

Kjo përgjegjësi apo funksione, të cilat mund të delegohen nga komunat tek asociacioni, mund të revokohen në çdo kohë nga vetë komunat, të cilat i kanë deleguar ato.

Pra, puna dhe funksionet e asociacionit do të mbeten në mbikëqyrje të plotë të komunave pjesëmarrëse.

Mbikëqyrje e plotë nënkupton që asociacioni mund të monitorojë dhe vlerësojë punën në fushat e përmendura.

Në këtë parim nuk ka asgjë të pazakontë, sepse një rol i tillë mbikëqyrës mund të ushtrohet nga çdo qytetarë i zakonshëm, organizatë qeveritare apo joqeveritare, të cilët

mund të bëjnë vlerësim apo rishikim në ndonjë fushë të caktuar, qoftë të Administratës Publike, apo fushave tjera.

6. Bashkësia-Asociacioni do të ketë një rol përfaqësues te autoriteti qendror dhe për këtë qëllim do të ketë një përfaqësues në Këshillin Konsultativ të komuniteteve. Në përmbushje të këtij roli, parashihet funksioni monitorues.

Sqarim rreth pikës së gjashtë: Kjo është e ngjashme me rolin dhe punën që bën shoqëria civile te ne.

Përfaqësuesit e asociacionit do të jenë në gjendje që t'i prezantojnë pikëpamjet e asociacionit lidhur me çështjet e ndryshme, në veçanti lidhur me çështjet legjislative që kanë të bëjnë me nivelin lokal.

7. Do të ketë një polici në Kosovë, e quajtur Policia e Kosovës.

E gjithë Policia në veri të Kosovës do të integrohet brenda kornizës së Policisë së Kosovës, pagat do të jepen vetëm nga Policia e Kosovës.

8. Pjesëtarëve të strukturave serbe të sigurisë do t'u ofrohet vend ekuivalent në strukturat e Kosovës.

Sqarim për pikat 7 dhe 8: Në mënyrë të qartë rikonfirmojmë një ndër çështjet më të rëndësishme për ne. Këto dy prime saktësojnë se strukturat ilegale të Serbisë që kanë ekzistuar në veri të vendit tash e 14 vjet, tani e tutje nuk do të ekzistojnë dhe nuk do të mund të operojnë. Kjo marrëveshje zyrtarisht u jep fund atyre.

9. Do të ketë një komandant rajonal të Policisë për katër komunat me shumicë serbe në veri, Mitrovica e veriut, Zveçani, Zubin-Potoku dhe Leposaviqi. Komandant i këtij regjioni do të jetë një serbë i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, nga lista e ofruar nga katër kryetarët e komunave, në emër të Bashkësisë-Asociacionit. Do të ketë komandant tjetër rajonal për komunat e Mitrovicës jugore, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Komandanti rajonal i katër komunave në veri do të bashkëpunojë me komandantët e tjerë rajonalë.

Sqarim: E kuptoj që edhe kjo pikë ndoshta është ajo që mund të lërë pak shije të hidhur, apo të nxisë edhe debate dhe jam shumë i vëmendshëm për këtë. Por, dua ta keni të qartë se marrëveshja e arritur është kompromis ndërmjet palëve të përfshira në këtë proces.

Për më tepër, dua të bëj të qartë se të gjithë komandantët rajonalë janë në kontroll të plotë nga autoriteti i nivelit përkatës në nivelin qendror në Prishtinë.

Ata, kudo që janë, në çdo rajon të Kosovës do ta zbatojnë rendin kushtetues, ligjet tona dhe zinxhirin e vetëm komandues.

Për më tepër, procesi i selektimit, i cili i sqarua në këtë paragraf, është në përputhje me ligjin ekzistues të Kosovës.

10. Autoritetet gjyqësore do të integrohen dhe do të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës. Gjykata e Apelit nga Prishtina do të themelojë një panel të përbërë me shumicë të serbëve të Kosovës për t'i gjykuar të gjitha rastet në komunat me shumicë serbe. Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë nga stafi administrativ dhe gjyqtarët, do të vendoset në mënyrë të përhershme në veri të Mitrovicës, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Secili panel i divizionit të mësipërm do të ketë përbërje me shumicë të gjyqtarëve të përkatësisë serbe të Kosovës. Gjyqtarët përkatës do të vendosin në panel, në varësi të natyrës së rastit në fjalë.

Sqarim: Kjo pikë rikonfirmon faktin se strukturat ilegale në fushën e drejtësisë, të cilat kanë vepruar në veri të vendit, tani e tutje nuk do të mund të funksionojnë, nuk do të mund të veprojnë. Ato kanë qenë ilegale. Ato do të shpërbëhen.

Kjo marrëveshje tani rikonfirmon se të gjitha autoritetet në fushën e drejtësisë, respektivisht të gjyqësisë, që do të veprojnë në Kosovë, do të jenë pjesë e sistemit unik të drejtësisë së Kosovës dhe do ta zbatojnë vetëm rendin kushtetues, që buron nga Kushtetuta jonë.

Përbërja e paneleve me gjykatës me shumicë serbe për komunat me shumicë serbe është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet tona përkatëse.

Kjo është në tërësi në përputhje me Kushtetutën, ligjet për gjykatat dhe Prokurorinë. Është e qartë se në Kosovë do të aplikohen vetëm ligjet tona.

11. Zgjedhjet lokale në komunat e veriut do të organizohen në vitin 2013. Qëllimi dhe gatishmëria jonë është që këto zgjedhje të organizohen në të njëjtën kohë kur është edhe afati kushtetues dhe ligjor i organizimit të zgjedhjeve lokale të Kosovës, pra në vjeshtën e këtij viti. Zgjedhjet lokale do të lehtësohen nga OSBE-ja, në përputhje me ligjet e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare.

Sqarim: Më në fund, pra pas 14 vjetësh të mungesës së demokracisë dhe mundësisë për të organizuar zgjedhjet e lira dhe lokale në veri të vendit, qytetarët e Kosovës që jetojnë atje do të kenë mundësi që pa frikë dhe nëpërmjet një procesi legjitim zgjedhor, i cili do të bëhet sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me rolin lehtësues të OSBE-së, ata do t'i zgjedhin udhëheqësit e tyre legjitimë lokalë, të cilët do t'i zbatojnë ligjet e shtetit tonë.

Me këtë, ne i japim fund periudhës së qeverisjes së keqe nga kryetarët, të cilët nuk kanë qenë të zgjedhur nga qytetarët, por kanë qenë të emëruar apo të imponuar nga Serbia.

Kjo është një fitore e madhe e demokracisë. Kjo është një fitore e madhe e kësaj marrëveshjeje. Kjo është një fitore për normalizimin e gjendjes në veri.

12. Një plan zbatimi, i cili përfshin edhe afatin kohor, sepse secilit nga ju e di që ju intereson edhe afati kohor, edhe mekanizmat implementues, do të krijohet deri më 26 prill.

Në zbatimin e kësaj marrëveshje do të trajtohet edhe parimi i financimit transparent.

Sqarim: Kjo pikë është thelbësore për zbatimin e marrëveshjes, sepse fati i kësaj marrëveshjeje varet nga zbatimi i saj.

Për informimin tuaj, të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,

Ju të nderuar ambasadorë të Bashkimit Evropian, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të të gjitha organizatave ndërkombëtare,

Unë mund të ju konfirmoj se Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me EULEX-in dhe KFOR-in, tashmë e ka përgatitur një plan zbatues shumë serioz, i cili i përmban të gjitha detajet lidhur me afatet kohore dhe aktorët që do ta bëjnë zbatimin në praktikë.

Javën që vjen, ekipi ynë do të udhëtojë në Bruksel dhe me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, në koordinim të plotë me përfaqësuesit e Serbisë, do ta përpilojë planin zbatues, i cili do të jetë i obligueshëm për të dyja palët.

13. Diskutimet lidhur me energjinë, telekomin dhe çështjen e personave të zhdukur do të intensifikohen nga të dyja palët dhe do të përfundojnë deri më 15 qershor.

Sqarim: Ekipet e dy shteteve duhet patjetër që të arrijnë marrëveshje në fushën e energjisë dhe telekomit deri më 15 qershor.

Ju e dini sesa e rëndësishme për Kosovën është marrëveshja për këto dy fusha për shkak të një humbje të madhe financiare që ka Kosova si rezultat i mungesës së ligjshmërisë në këto dy fusha përkatëse në veri.

14. Është dakorduar që asnjëra palë nuk do ta bllokojë apo t'i inkurajojë të tjerët që ta bllokojnë progresin e palës tjetër në rrugën përkatëse drejt Bashkimit Evropian.

Sqarim: Kjo është një ndër pikat kyçe, e cila do ta forcojë subjektivitetin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. E theksoj se kjo marrëveshje e kompletton dokumentin e presidentit Ahtisari.

Për më tepër, ne me plotë të drejtë presim që së paku pesë vendet anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës ta bëjnë një gjë të tillë në të ardhmen e afërt. Tani këto shtete nuk kanë arsyetim dhe ne presim që ato të reflektojnë në këtë drejtim. Jam mirënjohëse për përshtetjen që i kanë bërë këto shtete arritjes së marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, pra Sllovakia dhe Greqia.

Tani, pra Serbia nuk do të mund t'i inkurajojë të tjerët, t'i bllokojë përpjekjet tona për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, apo në organizatat tjera regjionale dhe ndërkombëtare.

Rruga jonë drejt Bashkimit Evropian nënkupton anëtarësimin në konventat dhe traktatet kyçe rajonale dhe ato ndërkombëtare, siç janë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për Ekstradim, Konventa Evropiane për Ndihmë Ligjore, Reciproke e të tjera.

Anëtarësimi në këto traktate përmbush nevojën për respektimin e obligimeve të parapara me kriteret e Kopenhagës. Kjo nënkupton se çdo përpjekje për të penguar apo inkurajim të të tjerëve për ta penguar anëtarësimin tonë në organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe OSBE-në, do të ishte në kundërshtim me këtë parim, që e përmban kjo marrëveshje.

Lidhur me këtë pikë, baronesha Eshton pritet të bëjë një sqarim shtesë në raportin e saj, i cili do të bëhet publik dhe do të jetë zyrtar pas marrjes së miratimit zyrtar për pranimin e marrëveshjes nga Kosova dhe Serbia.

15. Do të themelohet një komitet zbatimi nga të dyja palët me lehtësimin e Bashkimit Evropian.

Sqarim: Edhe kjo pikë është jashtëzakonisht e rëndësishme për mbikëqyrjen e zbatimit të plotë të marrëveshjes në praktikë, pra në terren.

Ne kemi propozuar që ky komitet i zbatimit të jetë në nivelin më të lartë politik, pra të përbëhet nga të dy kryeministrat e dy shteteve, të Kosovës dhe Serbisë, dhe në emër të Bashkimit Evropian përsëri të jetë baronesha Eshton.

I nderuari kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Zonja dhe zotërinj,

Ju të nderuar ambasadorë,

Në fund, më lejoni që edhe një herë ta theksoj faktin se kjo marrëveshje është plotësisht në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e Kosovës, të cilat i kemi miratuar të gjithë së bashku, pra me Kushtetutën, të cilën si rezultat i kësaj marrëveshjeje tani e tutje do të jemi në gjendje ta shtrijmë dhe zbatojmë në gjithë territorin tonë.

Kjo marrëveshje konsolidon edhe më shumë tërësinë territoriale të shtetit tonë, konsolidon institucionet tona të rendit dhe të ligjit dhe na mundëson që ta avancojmë subjektivitetin shtetëror në arenën ndërkombëtare.

Për më tepër, kjo marrëveshje e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e forcon paqen dhe stabilitetin në rajonin tonë dhe i hap Kosovës një perspektivë të qartë në procesin e integritimeve euroatlantike.

Përveç kësaj, më duhet ta bëj të qartë për të gjithë se nëpërmjet kësaj marrëveshjeje dhe këtij procesi të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ne të gjithë së bashku kemi arritur që t'i thellojmë marrëdhëniet tona bilaterale ndërshtetërore me shtetet dhe miqtë tanë ndërkombëtarë.

Dhe, për arritjen e këtij procesi, të nderuar deputetë, Kabinet qeveritar, ju qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës, dëshiroj të ju falënderoj të gjithëve. Dëshiroj të ju falënderoj ju, deputetë të nderuar, partitë që ju i përfaqësoni, sepse konsideroj se ky është një sukses yni i përbashkët, i cili duhet të konsiderohet si një vlerë e lartë e shoqërisë sonë dhe e shtetit tonë.

Për të gjitha arsyet e mësipërme dhe i bindur thellë se kjo marrëveshje është në interesin tonë të plotë shtetëror, unë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës kërkoj mbështetjen tuaj, të nderuar deputetë, në favor të kësaj marrëveshjeje. Pra, të nderuar deputetë, kërkoj pëlqimin tuaj.

Unë si gjithmonë do të mbetem i hapur për t'i dëgjuar me kujdesin më të madh të gjitha shqetësimet tuaja, të gjitha rekomandimet tuaja, për t'i adresuar shqetësimet tuaja të mundshme. Ju falënderoj edhe një herë për durimin tuaj, për mbështetjen tuaj, për sugjerimet që na i keni dhënë vazhdimisht. Ato sugjerime kanë qenë jashtëzakonisht ndihmuese për ne. I kemi respektuar gjithmonë, i kemi integruar në proces dhe dëshiroj të theksoj edhe një herë - jam thellësisht i bindur se ky proces apo kjo marrëveshje historike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për paqe do të reflektojë në gjithë rajonin për të mirën.

Edhe një herë - dëshiroj ta falënderoj baroneshën Eshton për udhëheqjen e saj të shkëlqyeshme të këtij procesi. I falënderoj të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, që në mënyrë unike e mbështetën baroneshën Eshton në këtë përpjekje të jashtëzakonshme për sukses të jashtëzakonshëm, për suksesin historik, për paqen në rajon. Dëshiroj t'i falënderoj Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e fuqishme që i dhanë këtij procesi.

Në anën tjetër, dëshiroj ta falënderoj NATO-n dhe të gjitha organizatat ndërkombëtare që gjithashtu qëndruan afër nesh dhe i dhanë mbështetje të jashtëzakonshme këtij procesi të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,

Marrëveshja e arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë i ka tejkaluar kornizat e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve dhe popujve tanë. Ajo është marrëveshje dhe mesazh për paqe në rajon, për evropianizimin e rajonit. Prandaj, edhe ka fituar një

mbështetje të fuqishme ndërkombëtare, duke u nisur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet sekretarit të shtetit, Xhon Keri.

Gjithashtu dëshiroj ta falënderoj edhe zëvendëspresidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili edhe konkretisht, në takimet në Romë që i kemi pasur, i ka dhënë mbështetje këtij procesi dhe gjithmonë duke qenë në dijeni presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Obama. Pra, u jemi shumë mirënjohës.

Këtë marrëveshje e kanë përgëzuar dhe e kanë mbështetur fuqishëm të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, ministri i Jashtëm, Hejg; ministri i Jashtëm gjerman, Vestervelle; ministri i Jashtëm francez, Fabius; ministri i Jashtëm turk, Daut Ogllu; Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Ban Ki-Mun; gjithashtu presidenti i Këshillit Evropian Rompoj; Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Rasmussen; gjithashtu presidenti i Komisionit Evropian, Barroso; komisionar për Zgjerim, zoti Shtefan Fyle, si dhe shtetet të tjera, që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Dëshiroj ta falënderoj për mbështetje edhe presidentin Ahtisari, edhe zotin Rohan, edhe ambasadorin Uizner, dhe të gjithë miqtë dhe partnerët e Kosovës, partnerët e paqes, të stabilitetit, të bashkëpunimit rajonal në Ballkan, por edhe të perspektivës euroatlantike.

E falënderoj kryeministrin e Shqipërisë dhe gjithë politikën e Shqipërisë për mbështetjen e plotë të këtij procesi; liderin e shqiptarëve në Maqedoni, zotin Ahmeti, dhe liderët e tjerë dhe gjithë liderët shqiptarë, edhe në Preshevë, edhe në Mal të Zi. E falënderoj edhe Diasporën për mbështetje. Ju falënderoj shumë për përkushtimin tuaj, për durimin tuaj, për vëmendjen tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Zoti kryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Më lejoni që në emër të grupit më të madh politik, Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, të shpreh qëndrimin e Partisë Demokratike në katër pjesë.

E para, vlerësimin e përgjithshëm të marrëveshjes; e dyta, analizën e përgjithshme të marrëveshjes; e treta, konkluzionet finale rreth studimit të kësaj marrëveshjes, dhe e katërta, rekomandimet që ne i kemi dhënë në implementim të kësaj marrëveshjeje.

Grupi Parlamentar, nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet dy shteteve sovrane dhe të pavarura e konsideron si një akt historik, si një moment të fillimit të një epoke të re, të një epoke civilizuese, të një epoke ku Kosova dhe Serbia për herë të parë, në mënyrë paqësore, civilizuese dhe evropiane, arrin një marrëveshje historike, me të cilën fillon edhe një epokë e re, epokë e evropianizimit të këtyre dy vendeve.

Pa dyshim se ne vlerësojmë që ky moment historik është fillimi i fundit të konfliktësisë shekullore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pra, nuk është fundi, por është fillimi i fundit të një konflikti shekullor që kanë pasur dy shtetet tona dhe fillimi i një epoke të re, kur dy shtete tona do të njihen reciprokisht dhe do ta kenë një agjendë të përbashkët evropiane.

Ne vlerësojmë se nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, e cila nuk është prefekte, arrihet një kompromis real, një kompromis që është edhe në pajtim me raportin faktik që e kemi dhe arrihet një kompromis, me të cilin fakt ruhen vlerat kombëtare të Republikës së Kosovës, ruhen interesat kombëtare të Kosovës, ruhen interesat kushtetuese të Kosovës. Dhe, kjo marrëveshje është plotësisht në pajtim me sistemin unik kushtetues të Republikës së Kosovës, është plotësisht në pajtim me Rezolutën e Kuvendit të Kosovës, me të cilën Kuvendi e ka autorizuar Qeverinë e Kosovës që t'i fillojë këto procese.

Kjo marrëveshje i jep fund një gjendjeje të padurueshme që e kemi pasur në veri që nga periudha e pasluftës. I jep fund destruksionit të vazhdueshëm që e kemi pasur në veri, nëpërmjet së cilit Serbia, në fakt, në mënyrë permanente e ka rrezikuar sistemin kushtetues të Kosovës dhe nëpërmjet kësaj marrëveshjeje përfundimisht shpërbëhen të gjitha strukturat jokushtetuese dhe jolegjitime, jo vetëm strukturat e sigurisë, por edhe strukturat civile, të cilat nuk kanë qenë në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe vendosen autoritetet legjitime të Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e hap një epokë të re të rrugës evropiane për Kosovën, e hap një epokë të re, ku raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk do të jenë raporte të pengimit reciprok, raporte të mbajtjes peng të Kosovës, por raporte të plotësimit të kushteve dhe integritetit të dyja vendeve tona brenda familjes së gjerë evropiane.

Kryeministri i bërë analizë pikë për pikë marrëveshjes, e unë do reduktoj pak kohën, sepse do ta balancoj kohën në pjesën finale. Analizën time do ta ndaj në tri pjesë kryesore.

E para, prej pikës 1 deri në pikën 6, marrëveshja përmban zgjidhjen apo aranzhmanin për të ashtuquajturin asociacion i komunave dhe definitivisht po shihet se ky asociacion i komunave nuk është një entitet kushtetues, nuk është një entitet shtetëror, por është një mekanizëm i bashkëpunimit, i paraparë me Kartën Evropiane, i paraparë me pakon e Ahtisarit, i paraparë me legjislacionin e Kosovës dhe definitivisht po shihet se ky entitet nuk është asnjë autoritet ekzekutiv, asnjë autoritet legjislativ, asnjë autoritet gjyqësor, por sfondi i veprimit të këtij asociacioni është sfond i qeverisjes lokale.

Aranzhmani që është paraparë për asociacion të komunave na tregon se entiteti i tij është i njëjtë me asociacionin ekzistues të Kosovës dhe akti më i lartë i këtij asociacioni do të jetë statuti i komunave. Do të thotë, nuk do të ketë asnjë kompetencë vendimmarrëse, asnjë kompetencë politike, kurse fushëveprimi i kompetencave të këtij asociacioni do të jetë kryesisht fushëveprimi i qeverisjes lokale, i paraparë dhe i zbërthyer me Pakon e Ahtisarit.

Dispozitat që parasheh delegimin eventual të kompetencave të asociacionit duhet të sqarohet, sepse thuhet shprehimisht se një delegim i tillë mund të bëhet vetëm me një ligj të Kuvendit të Kosovës dhe nëse kjo aplikohet, vlen për të gjitha komunat, jo vetëm për komunat veriore, në qoftë se dëshirohet të shkohet te pushteti i dekoncentrimit, apo te një bartje e kompetencave që mund të bëhet vetëm me një proces legjislativ nëpërmjet Kuvendit të Kosovës dhe nëpërmjet miratimit me 2/3.

Pika 7 dhe 8 janë shumë e rëndësishme, meqë u jepet fund strukturave paralele të sigurisë në Serbi dhe shprehimisht thuhet se ekziston vetëm një autoritet, një polici unike e Kosovës, me një zinxhir unik të komandimit. Aranzhmanet e zgjedhjes së komandantit të rajonit parashihen edhe me Pakon e Ahtisarit dhe në fakt me këtë pikë u jepet fund strukturave paralele të sigurisë që kanë qenë element permanent dhe i vazhdueshëm i stabilizimit të gjendjes së sigurisë në Kosovë.

Pika 9 dhe 11 e sigurojnë sistemin unik gjyqësor, e sigurojnë zinxhirin unik të zgjedhjes së gjyqtarëve, sigurojnë se Gjyqësori do të funksionojë me ligjet që ne i kemi miratuar në Parlament.

Tani të nderuar kolegë,

Ne e dimë që fusha gjyqësore është plotësisht e mbuluar me ligjet e reja, me ligjet që janë në pajtim me standarde evropiane dhe, në fakt, komplet zinxhiri i zgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve është unik. Janë paraparë disa zgjidhje sa i përket Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit në Mitrovicë, të cilat nuk e cenojnë karakterin unitar të Gjyqësorit, por japin mundësi që disa panele, në raste të specifikuara, ta kenë një përbërje me shumicë prej gjyqtarëve serbë, natyrisht në rastet gjyqësore kur palët do të jenë të përkatësisë serbe. Kështu që Policia dhe Gjyqësori integrohen brenda sistemit unik gjyqësor.

Pika 12 është shumë e rëndësishme, sepse kjo pikë, krahas shpërbërjes së strukturave jokushtetuese të sigurisë, parasheh edhe shpërbërjen e strukturave jokushtetuese dhe joligjore civile për shkak se parasheh obligimin e mbajtjes së zgjedhjeve plotësisht me ligjet e Kosovës, me Kushtetutën e Kosovës dhe natyrisht do të monitorohen nga OSBE-ja, e cila i monitoron të gjitha zgjedhjet, i ka monitoruar edhe te ne, dhe me këtë mundësohet që atje të instalohen autoritetet legjitime dhe kushtetuese të qeverisjes lokale, autoritetet të cilat do ta kenë pastaj një hierarki me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe autoritetet që plotësisht do të dalin nga vota e lirë dhe nga autoriteti ligjor i Republikës së Kosovës.

Gjithashtu pika 13 i obligon shtetet që vazhdojnë edhe me çështje tjera, me energjinë dhe me telekomunikacionin, dhe këtu e kemi një afat të limituar.

Është me shumë rëndësi edhe pika 14, e cila definitivisht e ndal destruksionin serb në procesin e integritimeve evropiane. Edhe në mbledhjen e kaluar, unë kam diskutuar dhe kam thënë se Kosova nuk mund të mbetet peng në rrugën evropiane i bllokadave dhe destruksioneve, që bëhen nga Serbia. Definitivisht, rruga e Kosovës drejt integritimeve evropiane nuk është më peng i Serbisë, por është një rrugë që duhet vlerësohet.

Gjithashtu në pikën 15 janë caktuar mekanizmat me të cilët sigurohet implementimi i kësaj marrëveshjeje.

Tani më lejoni t'i prezantoj konkluzionet që ne i kemi bërë në analizën si Grup Parlamentar.

Konkluzioni i parë, ne vlerësojmë se kjo marrëveshje është plotësisht brenda Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e ruan karakterin unitar të shtetit, e ruan sistemin unik kushtetues dhe nuk kërkon asnjë ndryshim kushtetues, apo ndryshim legjislativ.

Çështja e dytë, ne mendojmë se nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Kosovës i trasohet rruga për konsolidimin e shtetit, për marrjen me probleme të brendshme, për procesin e zhvillimit ekonomik dhe për procesin e integriteteve evropiane dhe definitivisht ndalohet procesi permanent i destrukcioneve që Serbia i ka bërë në Kosovë.

Ne vlerësojmë se teksti i marrëveshjes nuk është prefekt, i shkruar me gjuhë juridike. Është një tekst ndoshta i kombinuar edhe me gjuhën politike, siç janë të gjitha tekstet ndërkombëtare. Ne disa këtu në sallë kemi përvojë me proceset e negociatave nga Rambujeja dhe e dimë se tekstet ndërkombëtare nuk janë të shkruara me shkollën tonë juridike, por e kanë edhe atë gjuhën pragmatike politike, dhe ne urojmë që teksti të mos e lejojë asnjë dilemë në dy kuptime. Por, një metodë e tillë ka qenë e pranishme pothuaj në të gjitha tekstet, edhe në Pakon e Ahtisarit. E dimë ne që edhe kemi marrë pjesë në konceptimin e asaj pakete, se e ka pasur një gjuhë të tillë.

Tani të respektojmë dhe të nderojmë deputetët,

Më lejoni që t'i paraqes disa kërkesa në emër të Grupit Parlamentar për implementimin e kësaj marrëveshjeje, kërkesa këto që besoj se do të mbështeten nga të gjitha grupet parlamentare.

1. Ne e përkrahim Qeverinë dhe bashkësinë ndërkombëtare që ta punojnë një plan detaj implementues, një plan operativ të implementimit, që do t'i përmbajë të gjitha afatet dhe të gjitha veprimet që do të ndërmerren, në mënyrë që kjo marrëveshje të implementohet plotësisht dhe të evitohet çfarëdo mundësie e destrukcionit.

2. Kërkojmë që marrëveshja ta ketë një monitorim të fuqishëm ndërkombëtar në implementim. Kërkojmë që të gjitha autoritetet ndërkombëtare...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Përmbylle, të lutem! Urdhëro, edhe një minutë!

ARSIM BAJRAMI: ...gjithashtu kërkojmë që, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, pas kësaj qasjeje shumë të moderuar të delegacionit të Kosovës, pas kësaj qasje shtetërore, Bashkimi Evropian ta krijojë unitetin e nevojshëm dhe të bëjë një presion që Kosova të njihet edhe nga pesë shtetet e Bashkimi Evropian dhe të shpejtohet rruga e Kosovës drejt integriteteve evropiane.

Gjithashtu, kërkohet që Kosova më në fund të kalojë në procesin e stabilizim-asociimit dhe ta shpejtojë procesin e liberalizimit të vizave dhe të fillojë procesin e anëtarësimit të Kosovës në organizatën e Kombeve të Bashkuara, në mënyrë që të bëhet shtet fuqi plotë në të gjithë mekanizmat evropianë dhe anëtare me drejtë vote në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: I nderuar kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Lidhja Demokratike e Kosovës, me gjithë vërejtjet që i ka në këtë draft-marrëveshje në pika të caktuara të saj, jep pëlqimin e saj në parim dhe u bëjmë thirrje njëkohësisht Bashkimit Evropian dhe SHBA-ve që ta garantojnë implementimin e saj.

LDK-ja është e vetëdijshme se dialogu me fqinjët e saj është parim evropian dhe rrjedhimisht e përkrahim si parim.

LDK-ja insiston dhe do të këmbëngulë në ruajtjen dhe në mbrojtjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe, veçanërisht karakterin unitar të saj.

Patjetër se duhet ta vlerësojmë angazhimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, BE-së, baroneshës Eshton dhe të NATO-s në gjithë këtë proces.

Ne e themi qartë se garancitë dhe mbështetja e SHBA-ve, BE-së dhe NATO-së janë arsyeja kryesore, se pse ne e përkrahim në parim këtë draft-marrëveshje. Po e përsëris, janë arsyeja kryesore se pse ne e përkrahim në parim këtë draft-marrëveshje. Janë po të njëjtit faktorë që na përkrahën në momentet vendimtare për lirinë tonë, në shtet-formimin e Republikës së Kosovës dhe besojmë thellë edhe në ndërtimin e shtetit tonë.

Ne si subjekt politik, si parti shtet-formuese dhe shtet-ndërtuese, interesat shtetërore dhe nacionale i vëmë mbi çdo interes tjetër.

LDK-ja konsideron se ka ardhur koha që në Ballkanin Perëndimor duhet të vendoset paqja e qëndrueshme dhe afatgjate. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”. Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!
Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Së paku prej se është shpallur pavarësia nuk ka pasur moment më të rëndësishëm institucional për shtetin e Kosovës.

Sonte, me këto 15 pika të marrëveshjes ndërmjet Thaçit e Daçiqit, Kosova politikisht ndodhet në pikën e saj më të ulët.

Ngutja që kjo seancë të bëhet të dielën në mbrëmje është shumë e dëmshme. Mirëpo, qëllimi i saj është i qartë, duan që sonte ta fitojnë pëlqimin për këtë marrëveshje, në mënyrë që të hënën në mëngjes Serbia ta dijë saktë qëndrimin e Kosovës dhe kështu Daçiçi, Nikoliqi e Vuçiçi të mos kenë kurrfarë ankthi të paparashikueshmërisë.

Nuk pati raportim të Thaçit në Kuvendin e Kosovës as pas takimit të tetë, e as pas takimit të nëntë me Daçiçin, kurse marrëveshja, siç e dimë, u bë pas takimit të dhjetë.

Ky e pranoi marrëveshjen pa raportuar për atë takim 13-orësh dhe dy të tjerët, gjithashtu shumëorësh. Pra, ajo rezoluta e 18 tetorit të vitit të kaluar është shkelur dhe nuk ka njeri normal që mund të thotë se ajo rezolutë është respektuar.

Po ashtu, ftesës së Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ia kemi bërë kryeministrit më 11 shkurt të këtij viti, ky nuk i është përgjigjur as sot e kësaj dite. Prandaj, ky dialog e do një Komision Hetimor Parlamentar që të marrim vesh se çfarë kanë folur, e çfarë nuk kanë folur, çka janë marrë vesh e çka nuk janë marrë vesh dhe si janë marrë vesh.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Pas demonstratave të vitit 1981, në Kosovë ka nisur diferencimi ideopolitik dhe përfaqësimi politik, e vendimet institucionale nuk merreshin më sipas strukturës nacionale të popullit të Kosovës, por praktikisht me konsensus të domosdoshëm me serbët, me të drejtën e tyre të vetos, në emër të parandalimit të, siç quhej atëherë, majorizimit nga shqiptarët.

Po këtë frymë e ka edhe kjo marrëveshje Thaçi-Daçiçi më shumë se tri dekada më vonë. Por, fundja, çka mund të presim nga ky kryeministër dhe nga partia e tij, e cila më 20 janar të vitit 2012 e miratoi kundërmocionin kundër reciprocitetin me Serbinë, duke e betonuar raportin asimetrik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Me këto 15 pika, Kosova bosnjëzohet duke u shndërruar në shtet jofunksional drejt dështimit të sigurt. Për hir të pushtetit të tij, Thaçi, i zhytur në korrupsion dhe në krim të organizuar, i sakrifikoi e braktisi, si shqiptarët në veri të Kosovës, ashtu edhe ata në Kosovën Lindore.

Kjo marrëveshje është përgjithësisht realizim i platformës së Serbisë të 13 janarit dhe për këtë gjë më hollësisht do të flasë deputeti Afrim Kasolli.

Pesë kushte kapitale është dashur që t'i vihen Serbisë, para çfarëdo dialogu me të. Kushti legal dhe juridik - Serbia duhet ta ndryshojë Kushtetutën, ku shkruan që Kosova është pjesë integrale e Serbisë dhe duhet ta pranojë pavarësinë e Kosovës.

Kushti humanitar dhe moral - Serbia duhet të kërkojë falje për krimet nga e kaluara dhe duhet t'i kthejë trupat e 1 700 të pagjeturve.

Kushti politik - Serbia duhet të pushojë me diskriminimin, terrorin, shfrytëzimin ekonomik dhe shtypjen politike të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, dhe duhet të pushojë me financimin e strukturave ilegale kriminale e armiqësore në Kosovë drejt shpërbërjes e shuarjes së tyre.

Kushti i katërt, ai i drejtësisë - në Kosovë janë vrarë 12 mijë njerëz veç në luftën e fundit. Numri i atyre që janë në burg për këtë është njëshifror. Serbia duhet t'ia dorëzojë Kosovës kriminelët serbë të luftës.

Dhe kushti i pestë, zhdëmtimi - 119 855 shtëpi janë shkatërruar, dëmtuar ose rrënuar. Asnjë cent nuk e ka paguar Serbia.

Depozitat bankare, kontributin pensional, 1200 artefakte kulturore, regjistrat civilë dhe dokumentacionin kadastral e ka plaçkitur dhe duhet t'ia kthejë Kosovës.

Por, të gjitha këto kushte, jo vetëm që nuk janë bërë nga Qeveria, por ato sot e kësaj dite në asnjë rund të dialogut teknik ose atij politik nuk ishin as tema atje.

Tash do ta bëjmë një zbërthim pikë për pikë të kësaj marrëveshjeje të turpshme të kryeministrit të Kosovës me atë të Serbisë.

Pika e parë tregon që shumica bëhet kategori e vlefshme vetëm si e shoqëruar me fjalën “serbë”. Pra, nuk ka më shumicë të popullsisë së Kosovës, shumica e popullit, vetëm shumica serbe. Dhe, themelohet asociacioni apo bashkësia e komunave me shumicë serbe, si dhe e drejta e vetos së saj për zgjerim.

Në pikën e dytë, instalohet e drejta e vetos së këtij asociacioni apo bashkësie për shpërbërje. Siç e dini, presidenti mund ta shpërbëjë Kuvendin, por jo edhe këtë asociacion, apo këtë bashkësi. Kryeministri njësoj mund ta shpërbëjë Qeverinë nëpërmjet dorëheqjes së tij, por ai nuk mund ta shpërbëjë këtë asociacion apo bashkësi. Dhe, nuk thuhet qartë në pikën dy se cilit ligj e cilës kushtetutë i referohet kjo pikë. Pra, do të kemi probleme me interpretim, e dihet që përparësi ka ai që është më i fuqishëm.

Pika e tretë flet për president, zëvendëspresident, Kuvend dhe Këshill, që do të thotë se flet për organe të larta të autonomisë, që tash po e quajnë asociacion apo bashkësi. Po krijohet asociacion - bashkësi paralele, pra strukturë paralele në nivelin shtetëror.

Në pikën e katërt flitet për kompetenca në zhvillimin ekonomik, arsim, shëndetësi dhe planifikim urban e rural. Këto fusha kaq të shumta e përbëjnë shtrirjen e pushtetit të autonomisë serbe, që quhet asociacion apo bashkësi. Fjala e parë këtu konsiston praktikisht në delegimin e pushtetit nga komuna te asociacioni, apo bashkësia. Kjo e vështirëson edhe më tej deri në pengim të pakapërcyeshëm kthimin e shqiptarëve të dëbuar nga veriu, rindërtimin e ndërtimin e shtëpive të tyre dhe të drejtat e tyre pronësore.

Pika e pestë krijon mundësi për rritje kompetencash për asociacionin apo bashkësinë, por jo edhe për zvogëlimin e tyre. Pra, nuk është i mundur zvogëlimi i kompetencave, por vetëm rritja e tyre.

Pika e gjashtë flet për bashkësinë dhe asociacionin që duhet ta ketë një përfaqësues në autoritetet qendrore. Nuk sqarohet se çfarë përfaqësimi dhe ku. Sido që të jetë, asociacioni apo bashkësia, duke pasur përfaqësinë e vet kundrejt autoriteteve qendrore, e shkatërron integritetin institucional të shtetit të Kosovës. Përfaqësuesi i këtillë bëhet figura dhe personifikimi i vetos.

Në pikën e shtatë thuhet se të gjithë policët në veri duhet të integrohen në strukturat e Policisë së Kosovës. Ky është aspekt formal, i cili në pikat 8 dhe 9 tregon që përmbajtësish do të jetë ndryshe.

Po ashtu, luftimi, arrestimi i strukturave ilegale, kriminale e armiqësore të Serbisë, por edhe shpërbërja ose largimi i tyre strukturave zëvendësohet tash me integrimin e tyre.

Pika e tetë është në vete dhe nuk u përfshi te pika shtatë. Dhe, kjo tregon që pjesëtarët e strukturave të sigurisë serbe, siç janë BIA, VBA, të ashtuquajtura të Mbrotjtjes Civile e Rojat e Urës e të tjera, do të integrohen dhe atë jo vetëm në Policinë e Kosovës, por edhe në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë të G-2-shi i FSK-së, e të tjera.

Pika 8 shënon amnisti për strukturat kriminale, rehabilitim të plotë të Serbisë dhe legjitimim e forcim të saj përbrenda shtetit të Kosovës, që ajo vazhdon të mos e njohë.

Në pikën e 9-të veriu e fiton forcën e vetë policore si regjion i veçantë. Komandanti thuhet të jetë serb e jo i zgjedhur nga serbët apo organet e tyre. Përderisa në Graçanicë shumica dërrmuese e policëve janë serbë, ky nuk do të jetë rasti, me shqiptarët për shembull, në Çabër të Zubin Potokut apo në Mahallën e Boshnjakëve në Mitrovicë.

Madje, Thaçi po merret vesh me Daçiqin edhe për Mitrovicën e jugut edhe për Skenderajn edhe për Vushtrinë, sepse këtu e keni një fjali që thotë: do të jetë një tjetër komandant regjional për komunat e Mitrovicës jugore, Skenderajt dhe Vushtrisë.

Në pikën e 10-të kemi ndarje të gjyqësisë mbi baza etnike dhe themelim të Gjykatës së autonomisë së serbëve, që po e quajnë asociacion apo bashkësi të komunave me shumicë serbe. Ky është homogenizim dhe autonomi gjyqësore e të gjithë serbëve në Kosovë, sipas kërkesës së Beogradit.

Le ta sqarojmë një gjë, ne nuk jemi kundër serbëve të Kosovës, por jemi kundër Serbisë, sepse ajo është kundër nesh. Këto privilegje shtesë, serbët e Kosovës nuk po i fitojnë pse kanë bërë protesta paqësore në Graçanicë, ku kërkuan të drejta kundrejt Republikës së Kosovës, por pse strukturat e Serbisë bënë krime në veri të Kosovës.

Në pikën 11, ku flitet për njësitin e Gjykatës së Apelit, praktikisht tregohet që veriu i Mitrovicës po bëhet si Banja Luka, do të kemi kryeqytet paralel, shqiptarët kryeqytet

Prishtinën, serbët kryeqytet veriun e Mitrovicës. Dhe, është një fjali e tmerrshme këtu në fund: “Gjykatësi përkatës do të vendosen, varësisht nga natyra e rastit, në të cilin janë përfshirë.” Pra, rastet përcaktojnë gjykatësit e përshtatshëm. Ky është arbitraritet marramendës.

Në pikën 12, ku flitet për zgjedhjet dhe OSBE-n, askund nuk i referohet Kushtetutës së Kosovës. Përfshirja e OSBE-së në organizimin e zgjedhjeve paraqet shkelje të Kushtetutës, aq më tepër që kjo bëhet në marrëveshje me Serbinë.

Në pikën e 13-të, ku flitet për debatin e mëtutjeshëm për energjinë dhe telekomin, tregohet që vazhdon dialogu...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Mirë, vazhdoja një minutë e gjysmë.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Në këtë pikën 13 pra, thuhet që vazhdon dialogu, ndërkohë që Serbia s’na njeh, përkundër koncesioneve të bëra nga Kosova.

Në pikën 14, Serbia mund të angazhohet kundër anëtarësimit të Kosovës në çdo forum ndërkombëtar, përveç në Bashkimin Evropian, ku edhe ashtu jemi tepër larg e madje as Serbia s’na bën dot gjë edhe për shumë vite, meqë as ajo s’do të anëtarësohet së shpejti. Kjo është më shumë që Kosova të mos e pengojë Serbinë.

Pika e 15-të, trashet varësia Kosovë-Serbi, të cilën BE-ja e Serbia e quajnë Beograd-Prishtinë dhe institucionalizohet ajo. Ndërkohë, Serbia nuk e ndryshon Kushtetutën e saj ku shkruan që Kosova është pjesë integrale e Serbisë dhe vazhdon të mos na njohë, përmbajtje e kësaj marrëveshjeje kundër vullnetit të popullit dhe kundër Kushtetutës. Leximi i kësaj përmbajtjeje nga kryeministri është agresion konstitucional ndaj shtetit të Kosovës.

Në këto momente që po zhvillohet kjo seancë, perimetri i ndërtesës dhe oborrit të Kuvendit është përplot policë, po mungojnë vetëm edhe tanket dhe gjithçka të duket sikurse më 23 marsin famëkeq të vitit 1989, kur regjimi i Millosheviqit suprimoi autonominë e Kosovës. Kjo marrëveshje është e padrejtë dhe e turpshme, ajo kursesi s’duhet të pranohet.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës e ka fjalën deputeti Blerim Shala.

BLERIM SHALA: I nderuari kryetar,

Kabinet qeverisës,

Deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Një histori e treguar fare shkurt dhe thjesht do të thoshte kështu.

Në qershorin e vitit 1999, Kosova doli nga Serbia, ku nuk do të duhej të ishte kurrë, ndërsa veriu i Kosovës faktikisht mbeti jashtë Kosovës, që nuk do të duhej të ndodhte kurrë.

Jetuam me këtë realitet që prej vitit 1999 të gjithë ne, duke u munduar ta ndryshojmë atë në të gjitha mënyrat, pa mbërri asnjëherë në cakun e dëshiruar.

Në shkurtin e vitit 2008, Kosova u bë shtet i pavarur, me tërësinë territoriale dhe kufijtë, që nuk lanë vend për dyshim për fatin ligjor të veriut të Kosovës, por integrimi i veriut të Kosovës, nuk ndodhi në ndërkohë.

Kjo gjendje në veri pastaj, herë u kualifikua si konflikt i ngrirë, herë si burim i mundësive për ndarjen territoriale të Kosovës apo edhe për shkëmbim terriroresh, ndërsa vazhdimisht veriu ishte dhe mbeti vatër e tensioneve të shumta politike dhe të sigurisë, duke kërcënuar qëndrueshmërinë afatgjatë të Kosovës.

Kryesorja, asnjëherë rendi dhe ligji nuk arriti ta kalojë lumin Ibër, asnjëherë kjo pjesë nuk u integrua ashtu siç do të duhej në Republikën e Kosovës. Pas korrikut të vitit 2011 u kumtua prej të gjithëve që Serbia është në veri të Kosovës, që ajo asnjëherë nuk është larguar në fakt, prej veriut, ndërsa prania e saj është në kundërshti me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, me raportet e Komisionit Evropian 2011, 2012 dhe me konkluzat e Këshillit të Ministrave të BE-së, dhjetor 2012.

Kur dihet çfarë ka ndodhur në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, në korrik të vitit 2010, mund të konkludohet që në aspektin legal, vendor dhe ndërkombëtar dhe në atë politik, Kosova tash e sa vjet ka fituar betejën për ruajtjen e tërësisë territoriale dhe për legalitetin e bërjes së shtetit. Në aspektin praktik, krejtësisht konkret, kjo nuk ka qenë e mundur deri më tash.

A do ta mundësojë këtë marrëveshja e parë e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila u arrit më 19 prill në Bruksel?

Politika është dyzim i vendimit e i procesit të jetësimit a zbatimit të tij dhe pa jetësimin e atij vendimi, ai si i tillë nuk ka fare vlerë apo peshë, por natyrisht nuk ka implementim, pa pasur vendim të njëmendtë.

Në rastin e veriut të Kosovës, të dialogut politik në mes Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë, i cili synon hyrjen në fazën e paparë në historinë shqiptaro-serbe dhe të atyre në mes të Kosovës dhe Serbisë, atë të normalizimit të marrëdhënieve, vendimi ka ndodhur, pikërisht me Marrëveshjen e 19 prillit në Bruksel.

Siç është parë tashmë janë bërë shumë interpretime të përmbajtjes së saj edhe duke e përqendruar në një detaj, duke e bërë atë një burim të kontesteve tashmë ekzistuese politike të tensionit të lartë në Kosovë, por edhe duke u përpjekur për ta kuptuar dhe për ta lexuar atë në kontekstin politik të kohës sonë.

Mbase gjërat e tilla, leximet kësisoj, tensionimet politike janë të pashmangshme në këto raste. Kjo është politika e cila në thelbin e saj ka përplasje në organizimin e zgjedhjes së problemeve të një shoqërie dhe të raporteve në mes të dy vendeve, duke përfshirë këtu edhe rendin ndërkombëtar.

E në rastin e kësaj marrëveshjeje, në fakt që të tri këto dimensione të politikës janë brenda saj: zgjidhja e temës së veriut të Kosovës; raportet midis dy shteteve, në mes të Kosovës dhe Serbisë; si dhe pozicioni ndërkombëtar i Kosovës apo kahet e integritit të Kosovës në BE.

Me marrëveshjen në fjalë krijohen mundësitë ligjore dhe politike për integrimin e veriut të Kosovës, pa dëmtuar legalisht dhe politikisht shtetin e Kosovës. Me këtë marrëveshje krijohen rrethanat ligjore dhe politike që qytetarët e veriut të Kosovës të jenë kontribuues në policinë, në gjyqësinë e Kosovës, të bëhen tatimpagues dhe votues, të bëhen qytetarë me të gjitha të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në politikë ashtu si dhe në jetë, ka zgjidhje të mira, të këqija dhe zgjidhje të domosdoshme. Në rastin e kësaj marrëveshjeje domosdoshmëria e saj është virtyti kryesor i saj, është e mira sipërore politike e saj. Në këtë kontekst domosdoshmëria na del edhe si rezultat i vetëm i vendimmarrjes pozitive të Kuvendit të Kosovës, në seancën që po mbahet sonte.

Tash i vie koha qëndrimit i cili ndryshe është i njohur për të gjithë ne, qofshim politikanë apo qytetarë të Kosovës. Ky qëndrim nga flet për dyshimet e bazuara, fatkeqësisht shumë herë të provuara si fakte historike dhe politike, sipas të cilave del që jetësimi i çdo marrëveshjeje me Serbinë është çështje e hapur, e paqartë, e panjohur, problematike gjithsesi.

Dihet përndryshe që Serbia nuk do të marrë datën më 28 qershor të këtij viti, për fillimin e bisedimeve për hyrje në BE, po qe se nuk ndodh zbatimi i marrëveshjes, së paku në segmentin më të rëndësishëm të sigurisë, zhbërja e strukturave të sigurisë të Serbisë në Kosovë.

Po ashtu, dihet që së shpejti apo brenda pak ditësh duhet të përgatitet edhe plani për jetësimin e marrëveshjes nga Zyra e zonjës Eshton, i cili duhet të dakordohet në emër të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Megjithatë, do të ishte gabim, i cili shfaqet fillimisht në trajtë të iluzionit, të mendohet që ndryshimi rrënjësor i gjendjes në veri të Kosovës, i cili njihet gradualitetin që mbërrin kulmin me legjitimimin e udhëheqjes në katër komunat me shumicë serbe në këtë pjesë të Kosovës, në vjeshtë të këtij viti, me organizimin e zgjedhjeve të lira demokratike me lehtësimin e OSBE-së, do të ndodhë pa pengesa dhe probleme të mëdha, pa tensione të të gjitha llojeve.

Shqetësimet tona mund të adresohen si duhet për të mbërri tek caku i synuar, integritit të plotë të veriut të Kosovës dhe normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, vetëm nëse do të ketë partneritet politik dhe organizativ në mes të Prishtinës dhe

Perëndimit, i cili do t'ia pamundësojë Beogradit që ta dëmtojë pariparueshëm këtë marrëveshje.

Dihet me ke kemi punë, askush nuk mundet në këtë Kuvend, nuk mashtrohet dot. Pra, fati i kësaj marrëveshjeje është zbatimi i saj i plotë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, e ka fjalën kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit kryetar, por në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, do të flasë zoti Behgjet Pacolli.

(Debat në sallë)

KRYETARI: Zëvendëskryeministri mund të flas, por jo në emër të Grupit Parlamentar se nuk është deputet.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BEHGJET PACOLLI: I nderuari zoti kryetar i Parlamentit të Kosovës,
Të nderuar deputetë,
I nderuari zoti Kryeministër,
Të nderuar kolegë,
Që nga shpallja e Pavarësisë e këndej, Kosova është përballur me sfida të mëdha për të shtrirë sovranitetin e vet në gjithë territorin e Kosovës dhe për të mbrojtur integritetin dhe kushtetutshmërinë e vendit.

Nga ana tjetër me shumë kujdes dhe mençuri Kosova u mor me implementimin e ligjeve dhe obligimeve që dalin nga pakoja e Ahtisaarit. Këto ishin obligime, që bashkësia ndërkombëtare dhe miqtë e Kosovës i kishin parashtruar, ne i kishim pranuar dhe në formë të këshillave ata kërkonin çdo ditë nga institucionet e vendit që ato të zbatohen.

Prej këtyre obligimeve Kosova krijonte kushte dhe standarde për qytetarët e vet, pjesëtarët e kombësive joshqiptare, duke u krijuar atyre standarde të larta sikurse në të gjitha vendet evropiane, aty ku synojmë të arrijmë.

Krejt kjo nuk ishte e lehtë duke marrë parasysh luftën e sapopërfunduar, dhembjet që kjo luftë shkaktoi tek populli shqiptar i Kosovës, që të krijonte kushte të barabarta, bashkëjetesën në Kosovën multietnike ishte një prej sfidave më të mëdha dhe më të vështira të institucioneve të Kosovës. Krijimi i kushteve për një jetë të sigurt, pa diskriminime për të gjithë qytetarët e Kosovës, ishte pra një sfidë tejet serioze, për të gjithë njerëzit konstruktivë, njerëzit e civilizuar, njerëzit që duan paqe dhe ndërtojnë shtet të civilizuar.

Në anën tjetër, ne synojmë bashkëjetesën me shoqëritë e civilizuar, ne synojmë anëtarësimin në familjet e kombeve dhe duhet të këshillohemi dhe të mbështetemi tek

miqtë tanë perëndimorë, duke i ruajtur aleancat me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian dhe me miqtë tjerë.

Mu kjo që thashë i detyroi institucionet e Kosovës, që prej 14 vjet me radhë mos ta shtrijë sovranitetin edhe në veri të vendit. Kosova si një shtet i ri në konsolidim e sipër duhej të rregullonte me kujdes, që mos të lejonte gabime të cilat mund të ktheheshin në veprime që do ta dëmtonin shtet-ndërtimin tonë.

Nuk dua të hy në trajtimin e shkaqeve pse pjesa veriore mbeti jashtë kontrollit institucional, ama ishte edhe mbetem besnik në bindjet e mia, se kurrësi Kosova nuk ka mundur të shtrijë sovranitetin në veri me një formë tjetër pos dialogut, sado i vështirë që ishte ai dhe kështu ndodhi. Sot me këtë marrëveshje Serbia tërhiqet definitivisht nga kontrolli policor, administrativ i kësaj ane, në këtë pjesë të territorit tonë janë fuqitë e një shteti tjetër që në të ardhmen nuk do të ekzistojnë.

Është e fuqishme ideja, dita e së cilës i ka ardhur, prandaj, dialogut i ka ardhur dita, ka ardhur dita kur ky dialog duhet të fillojë, ka ardhur dita kur ky dialog duhet të vazhdojë. Unë nuk e konsideroj këtë dialog si zgjidhje definitive, por ky dialog është vetëm një udhërrëfyes, ku do të fillohet puna e normalizimit të marrëdhënieve me shtetin e Serbisë.

Kjo ide e kthyer në realitet është aq e fuqishme, sa që dita e firmosjes së kësaj marrëveshjeje do të jetë një ndër datat historike me rëndësi për shtetin e Kosovës dhe të ardhmen e saj evropiane. Kosovës vendit tonë, sipas marrëveshjes iu hoqën pengesat për të ardhmen evropiane, për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën, shumë shpejt do të ndërrojnë vendimin e tyre.

Jam i bindur, se Kosova do të ketë më tepër miq, Kosova do të ketë një perspektivë të re.

Pika e Marrëveshjes e veçanërisht ajo që i hap Kosovës perspektivën euro-atlantike është shumë e rëndësishme. Unë e di se shumë shtete nëpër botë presin që të ndodhë diçka me Serbinë, presin një marrëveshje, në mënyrë që menjëherë të marrin vendim të njohin Kosovën, sa mirë është që Kosova të ketë miq kudo që janë ata.

Është përshpejtuar rruga e integriteteve për Kosovën dhe unë jam i bindur se Kosova ka bërë zgjidhjen më të mirë për të dialoguar.

Unë e përgëzoj kryeministrin e Kosovës për kurajën, guximin që pat, që të marrë një vendim të tillë dhe të fillojë dialogun. I përgëzoj të gjithë ata që e mbështetën kryeministrin e Kosovës, i falënderoj të gjithë mbështetësit, e falënderoj baroneshën Eshton dhe jam i bindur se kjo grua njëherë e tani e përgjithmonë do të mbetet në mendjen e fëmijëve tanë e gjeneratave të ardhshme.

Gjeneratat tona nuk duhet të kenë brenga, gjeneratat e ardhshme duhet të jetojnë sikurse të rinjtë tjerë, të mos kenë brenga lufte, të mos kenë urrejtje, për arsye se me urrejtje nuk ndërtohet civilizimi, me urrejtje nuk shkohet kah civilizimi.

Unë personalisht, në emrin tim, në emrin e partisë sime, në emrin e mbështetësve të AKR-së e përgëzoj kryeministrin e Kosovës dhe i them që të fillohet implementimi i kësaj marrëveshjeje, implementim ky që nuk është i lehtë. Thashë edhe më parë, kjo marrëveshje është vetëm si udhërrëfyes për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Sa banale do të jetë pas 5 vjetëve të flitet për pikat e kësaj marrëveshjeje dhe jam i bindur, ashtu siç ndodhi me fusnotën, ashtu siç ndodhi me 6-pikëshin, ashtu do të ndodhë edhe me pikat e kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshjeje do të kthehet në një kontratë paqeje me Serbinë. Ne kemi nevojë për paqe, jemi një shtet i vogël dhe asnjëherë Kosova nuk duhet të ketë një kufi të blinduar. Kufiri ynë i blinduar sot me Serbinë përbëhet prej 70% të kufirit të vet, që ka me shtetet në rajon.

Unë vazhdoj të mbes besnik edhe një pikëpamjeje të mëhershme. Për të pasur një implementim të suksesshëm të kësaj marrëveshjeje, ne duhet të kemi edhe një ofertë ekonomike, integruese për veriun e Kosovës.

Kam folur edhe më herët për zonën e lirë ekonomike, ku do të përfshihej edhe pjesa e jugut të Mitrovicës, prandaj ne duhet të ngutemi dhe të krijojmë një perspektivë të re. Kjo perspektivë e re ekonomike do të zgjidhë problemin politik, i cili e ngulfat mbarëvajtjen e shtetit të Kosovës, vetëm zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia i garanton të arriturat politike.

Më vjen mirë që në marrëveshje është vënë theks edhe tek energjia dhe telekomunikacioni, sepse ne duhet të fitojmë pavarësinë e plotë dhe në këto sektorë, duke i hequr pengesat artificiale, që na pengojnë, që pengojnë zhvillimin dhe unë besoj se në këtë rrugë do të kemi mbështetjen gjithashtu të fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.

Zonja Eshton, që përkundër problemeve dhe angazhimit ditor, me përkushtim e përkreu misionin e saj, meriton çdo respekt. Zoti të bekoftë, zonja Eshton!

Gjermania, një aleate gjithë e fuqishme e Kosovës, po ashtu do të shërbejë, do të gjendet aty ku është në pyetje mbarëvajtja e rrugëtimit gjatë implementimit të kësaj marrëveshjeje.

Të nderuar deputetë, duke reflektuar në këtë marrëveshjeje ju kontribuoni për të ardhmen e fëmijëve tanë, prandaj ratifikojeni këtë, zgjidhja më e mirë është paqja dhe ju e dini, paqja zëvendëson dhunën.

Të nderuar deputetë, kemi humbur shumë kohë duke u marrë me probleme politike duke rënduar jetën e qytetarit me informata brengosëse, duke rënduar punën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka në emër të SLS-së, nënkryetari Petar Miletqi.

PETAR MILETIĆ: Gospodine predsjedniče Skupštine,

Gospodine predsedniče Vlade,
Članice i članove Vlade,
Koleginice i kolege poslanici,
Poštovani ambasadori,

Noćas je možda više nego ikada važno da svi mi koji smo u prilici, da učestvujemo u procesu uspostavljanja normalizacije odnosa Prištine i Beograda i konačno uspostavljanja razumevanja i suživota srba i albanaca, budemo odgovorni ljudi.

Privilegiju ali i breme odgovornosti da donesu ovako značajne i dugoročne odluke, retko imaju naše kolege iz parlamenata, čija su društva davno uređena.

Mi smo noćas odgovorni pred građanima koje predstavljamo, ali i pred budućnošću na koju ovom odlukom utičemo. Zato apelujem na vas ali i na sve druge, koji imaju odgovornost da završe ovaj predug i uništavajući period stagnacije nerazumevanja i neizvesnosti da svojom mudrošću i hrabrošću, konačno okrenemo novi list u našim životima.

Predugo se bežalo od istine da se samo razgovorom i upornim i teškim traganjem za rešenjima može postići dogovor o kosovskom problemu, za koji zna čitav svet. Bolan kompromis, kako ga neki nazivaju, manje je bolan od konstantnog propadanja i zaostajanja za civilizovanim svetom, koje status zamrznutog konflikta nosi.

Srpska zajednica na Kosovu postala je taoc nerešenih odnosa Prištine i Beograda i takvo stanje je za nas neodrživo. 14 godina postkonfliktnog društva mnogo je čak i za Kosovo bez obzira na sve razlike i uzroke zbog kojih je do konflikta došlo.

Samostalna Liberalna Stranka dogovor iz Brisela čeka od trenutka kada je osnovana. Uporno smo na njemu insistirali, radovali se njegovom otpočinjanju i danas dočekali da pred sobom imamo nekima ranije nezamisliv dokument, usaglašen tekst, koji će potpisati obe strane.

Nema u dialogu u Briselu pobeđenih i poraženih i takvo njegovo analiziranje dokaz je nečijeg nepoznavanja i Kosovskog problema i procesa, koji se u svetu dešavaju. Nepostizanje dogovora s druge strane, bio bi jasan i nedvosmislen poraz svih.

Dugo i oporno smo insistirali na učešću kosovskih srba u procesu dijaloga. U poslednjih nekoliko Briselskih susreta sa zadovoljstvom mogu da istaknem, učestvovao je i predsednik Samostalne Liberalne Stranke Slobodan Petrović. I po ko zna koji put, pokazao da je naše insistiranje na politici razumevanja i suživota težak ali jedino efikasan način za rešavanje problema.

Niko odgovoran ne može ni jednu reč zameriti ni predsedniku naše stranke Petroviću, niti Samostalnoj liberalnoj stranci na dobronamernosti, konstruktivnosti i strpljenju. Napadaju nas, međutim i danas, kao i prvog dana kada smo mi iz Samostalne liberalne stranke pogledali istini u oči i hrabro prihvatili da je u saradnje i kompromisa kao svoju

suštinu. I sada kao i tada, osim etiketa, demagogija i igranja vatrom, nismo čuli nijedan jedini predlog kako problem rešiti.

Kritičari postignutog kompromisa, koji najviše vlasti Prištine i Beograda smatraju zadovoljavajućim, ne nude ništa drugo osim tvrdoglavo zadržavanje statusa-quo ili čak rešavanje problema nasiljem. Sličnost takvog stava i vatrenog govora dežurnih patriota a suštinski neodgovornih ljudi i organizacija sa srpske i sa albanske strane je gotovo neverovatna.

Na sve to Samostalna Liberalna Stranka ima samo jedan odgovor, uporni rad i hrabro suočavanje sa svim izazovima, koji nam tek predstoje. Treba biti pošten pa se noćas treba zahvaliti i predstavnicima Evropske Unije i Sjedinjenih Američkih Država, bez čije pomoći i zalaganja ne bi došli do uspeha dijaloga. Kada već nismo mogli sami neko je morao da nam pomogne i ja im na tome zahvaljujem.

Nije međutim, vreme da se postizanje dogovora u dijalogu Prištine i Beograda bez obzira na njegov značaj smatra završetkom lošeg perioda. Ništa se na Kosovu i oko Kosova neće promeniti samim potpisivanjem Briselskog sporazuma. Njime se samo otvaraju preduslovi za konačno uklanjanje političkih prepreka u procesu normalizacije naših odnosa ali i normalizacije naših života.

Naš posao je da tek sada kada su stvoreni uslovi da se životi i odnosi uredi ili da se naponi koje ka tome činimo olakšaju, radimo više bolje i iskrenije. Implementacija dogovorenog i podjednako važno implementacija ranije dogovorenog, naš je najvažniji zadatak upravljanju normalnog i prosperitetnog društva i regiona.

Naši apeli da se poštuju zakoni preuzeti iz Ahtisarijevog Paketa da se poštuju manjinska prava ili poziv za prihvataje i implementaciju sporazuma iz Brisela nisu izrečeni radi sticanja političkih poena i ostvarenja prava samo srpske zajednice, već su u interesu celokupnog kosovskog društva.

Bez ispunjavanja svih obaveza koja se nalaze u zakonima i Ustavu Kosova a proizašlih iz Ahtisarijevog plana, poštovane kolegice i kolege, nema razvoja Kosova a bez razvijanog Kosova neće biti razvijena ni Srpska, Albanska niti bilo koja druga zajednica. Ignorisanje činjenice da svi mi imamo emotivan odnos prema Kosovu je necivilizacijski odnos prema različitostima. To je takođe i veoma štetno. Naše su istorije isprepletene ali će takođe i naša budućnost biti isprepletene.

Sporazum iz Brisela priznaje te proste činjenice. Zato vaz pozivam da prihvatimo ovaj dokument i pokažemo da smo ovde da bi našim sunarodnicima, našim porodicama i našoj deci stvorili preduslove za život koji zaslužuju.

KRYETARI: Në emër të grupit “6+”, kryetarja Myfera Shinik e ka fjalën.

MYFERA SINIK: Sayın Başkan, bakanlar ve milletvekilleri,

Bugünkü Meclis oturumunda, Kosova ile Sırbistan arasında ilişkilerin normalleşmesini düzenleyen Anlaşma görüşülmektedir.

Bu Anlaşmayı Kosova için olumlu bir adım olduğunu bilerek onu kabul eden Türk, Boşnak ve Rom temsilcilerinden oluşan 6+ Paralmenter Grubu, Kosova'nın geleceği konusunda atılan en önemli adımlardan biri olarak görmekteyiz.

Bu Anlaşmanın gerçekleşmesiyle:

- Kosova'yı bugüne kadar tanımayan bilhassa AB üye ülkelerinden kalan beş ülkenin tanımasını kolaylaştıracağını ve hızlatacağını;
- Kosova'nın AB üyeliğini hızlatacağını;
- Kosova'nın çoktandır beklediğimiz vize muafiyetinin tarihini yakınlatacağını;
- Bununla birlikte yakın bir tarihte, Kosova enstitülerinin ülkenin kuzeyinde yaşayan Sırp, Arnavut, Türk, Boşnak ve Rom topluluklarına istikrar sağlayacağına inanmaktayız.
- Bu Anlaşma sayesinde ülkemiz, dünya ülkeleriyle eşdeğer bir şekilde her toplantı, organizasyon, müsabaka ve uluslararası ve AB örgütlerinde kendini temsil edebilecektir.
- Başta Kosova olmak üzere tüm bölgeye huzur getireceğine inandığımız bu Anlaşma, ülkemize hayırlı olmasını temenni ediyoruz.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta.

AGIM KULETA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë,

Unë nuk mendoj që kryeministri Thaçi me këtë marrëveshje po e shet Kosovën, unë mendoj se me këtë marrëveshje kryeministri Thaçi po e blen jofunksionalitetin e saj dhe atë me çmim shumë të lartë, me hapjen e rrugës Serbisë, që pa i zgjidhur problemet me shqiptarët, të ecë drejt BE-së.

E keqja këtu nuk qëndron në dhënien e mundësisë për Serbinë, që të ecë përpara, por në mohimin e mundësisë së artë për Kosovën për t'i zgjidhur problemet në mënyrë që të mos mbesë mbrapa.

Ky dialog me Serbinë jashtë BE-së ishte një ecje nëpër livadh, në krahasim me dialogun për të cilin do të detyrohemi ta bëjmë, kur ky normalitet të shpërfaqë falsitetin e vet. Ne tani, si shtet e shoqëri jemi në një fazë, kur synimet tona duhet të jenë më ambicioze. Sot nuk jemi në një situatë kur duhet luftuar për mbijetesë, prandaj qëllimi i të gjitha veprimeve tona politike nuk duhet të jetë ngushëllimi i vetes me faktin që kemi ruajtur shtetësinë. Pavarësisht propagandës së lirë mediale, ky ishte një fakt i pandryshueshëm edhe para bisedimeve e do të mbetet si i tillë edhe pas tyre. Është realitet i krijuar në një

proces krejt tjetër dhe me sakrifica të mëdha. Qëllimi i bisedimeve është dashur të jetë avancimi i këtij shteti dhe rritja e funksionalitetit të tij, gjë që nuk ka ndodhur.

Në këto bisedime për të fituar diçka sipërfaqësore e formale, kemi hequr dorë nga diçka që është përmbajtjesore. Unë jam i vetëdijshëm, që kryeministri i Kosovës mund të jetë nën presion të jashtëzakonshëm përmes shantazheve të ndryshme, për ta pranuar atë, por nuk është ky lideri i vetëm në historinë e njerëzimit që ka pasur presione të tilla dhe prej këtyre liderëve, në bazë të përcaktimit të tyre në këto situata ka të tillë, që sot njihen si heronj dhe ka të tillë që sot njihen si frikacakë.

Por, nëse kryeministri nuk është në gjendje ta bëjë këtë, atëherë ta ndihmojmë ne si deputetë, të marrim edhe ne përgjegjësinë tonë në këtë situatë, për të refuzuar një marrëveshje të tillë.

Me këtë rast u bëj thirrje të gjithë deputetëve që janë të bindur që kjo marrëveshje nuk është e mirë për Kosovën e të tillët jam i bindur që janë me shumicë, të mos heqin dorë nga liria e tyre për të vendosur në përputhje me vullnetin e vet, të mos heqin dorë nga ndërgjegjja e tyre e pastër, e cila në rast se injorohet, do t'i injorojë ata deri në fund të jetës së tyre.

Gjithashtu i bëjmë thirrje kryeministrit të Kosovës që të heqë dorë nga ana e pandërgjegjshme e karakterit të tij dhe ta respektojë më shumë atë të ndërgjegjshmen. Kjo mund t'i duket si një humbje personale në karrierë, por do të jetë një fitore e madhe për popullin që udhëheq. Kjo mund të duket si një humbje momentale, por të jesh i bindur, zoti kryeministër, se për ju dhe popullin, në emër të cilit je duke vendosur, do të jetë një fitore historike.

Në bazë të deklarimeve të partive politike është krijuar përshtypja se kjo marrëveshje do të kalojë lehtë në Kuvend, por një gjë ju garantoj unë, në qoftë se kjo marrëveshje do të kalojë sonte, qoftë vështirë apo lehtë, aspak të lehta nuk do të jenë pasojat e saj për qytetarët tanë, do të vuajnë shumë bashkë me të gjithë ju, që e mbështetni dhe ne që jemi kundër, por nuk jemi mjaftueshëm të fuqishëm ta ndalojmë atë. Për këtë, ju paralajmëroj.

Pas kësaj marrëveshjeje Serbisë i mbetet të plotësojë edhe disa detyra të tjera teknike, që e bëjnë atë pjesë të Bashkimit Evropian, pas kësaj marrëveshjeje Kosovës i mbetet të harxhojë kohë e energji, për ta implementuar një marrëveshje që e bën atë jofunksionale.

Pra, ashtu siç edhe kemi deklaruar përmes deklaratës sonë për media, Lëvizja për Bashkim është e bindur se kjo marrëveshje do të prodhojë një paqe të rrejshme midis palëve dhe se pasojat e vërteta dhe shumë të dhembshme të saj për vendin, do të vërehen tek më vonë. Ndërsa, pasojat e menjëhershme të tyre shprehen qartazi, përmes legjitimitetit të spastrimit etnik të veriut të Mitrovicës, heshtjes së çështjes së Kosovës Lindore dhe rritjes së jofunksionalitetit të shtetit të Kosovës.

Ne, në këto bisedime kemi pasur mundësi të shkëlqyeshme të sillemi si shtet dhe të interesohemi për zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve që jetojnë në Serbi, ashtu siç ka

bërë Serbia me qytetarët e saj që gjenden në shtetin Kosovës. Kjo sjellje të bën shtet, jo ajo që kemi parë ne gjatë këtyre bisedimeve.

Lëvizja për Bashkim vazhdon të besojë se bisedimet politike janë mekanizmi më i mirë për zgjidhjen e problemeve që kanë mbetur në mes të Kosovës dhe Serbisë, por vetëm kur ato janë të përgatitura mirë, kanë agjendë të qartë dhe i adresojnë saktë problemet. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Zotëri kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Jam koncentruar nga shumë këndvështrime t'i analizojë 15 pikat e marrëveshjes veç e veç, duke u motivuar nga të gjitha dyshimet e njohura për publikun dhe nga dyshime të panjohura për publikun. Një puhizë freskie më ka sjellë fakti relevant që është ruajtur autoriteti kushtetues dhe zbatimi i ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Raportet tona me Serbinë dhe raportet e qytetërimit euroatlantik, pas 12 qershorit 1999, është dashur të ndërtohen në një realitet tjetër dhe në një koncept tjetër krejt logjik. Për leksion të të gjithë hegjemonizmave të mundshëm në të ardhmen; për ndëshkim të hegjemonizmit të shfrenuar të politikës së Beogradit, për gjakderdhje dhe dhunë mesjetare të manifestuar në Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë; për dhunën dhe gjakderdhjen, veçanërisht në Kosovë, dhe për të vendosur drejtësi në këto hapësira, të krijuara mbi padrejtësitë, është dashur që Krahina e Sanxhakut dhe Kosova Lindore me Preshevën, Bujanocin dhe një pjesë e Medvegjës t'i ktheheshin Kosovës. Ndërsa Vojvodina e hungarezëve t'i bashkohej Hungarisë dhe një pjesë e saj me kroatë, Kroacisë. Pjesët tjera me etnitë bullgare dhe rumune, shteteve përkatëse.

Kjo do të ishte logjika më racionale.

Nga që kjo drejtësi nuk u vendos dhe nga që dhuna e Serbisë nuk u ndëshkua plotësisht, mentaliteti i saj i dhunës dhe konceptet e saj hegjemoniste vazhduan, duke prodhuar konotacionet e saj në forma të reja në veri të Kosovës dhe duke penguar respektimin e ligjeve në fuqi dhe shtrirjen e autoritetit kushtetues.

Edhe tani, gjatë bisedimeve, bashkësia ndërkombëtare nuk insistoi të vendosë drejtësi të plotë në raportet Kosovë-Serbi.

Duke insistuar se kërkim-falja nuk mjafton për ta mbyllur armiqësinë shekullore me shqiptarët dhe për t'i harruar lumenjtë e gjakut, por për t'u pranuar kërkim-falja dhe për të dëshmuar vullnetin për fqinjësi të re, ajo do të duhej t'ia kthente Kosovës ato pjesë që janë pjesë natyrale të saj, Sanxhakun dhe Luginën e Preshevës.

Edhe kjo nuk ndodhi. Nuk u ndëshkua hegjemonizmi etatist i Serbisë dhe as ambiciet shoviniste të Beogradit.

Kështu u imponua një realitet i hidhur dhe një raport joreal, por i pakapërcyeshëm në konstelacion të forcave në arenën e kësaj hapësire. Kjo erdhi si rezultat edhe i raporteve tona konfrontuese dhe i ndikimit të Serbisë për të krijuar dhe investuar në diskurse armiqësore me shumë perfiditet brenda nesh, në emër të marrjes së pushtetit dhe në emër të parimësisë dhe të devotshmërisë sonë kombëtare. Pa lënë aspak dyshime të tjera.

Për të mos u vënë në dilemë ky diskurs, doemos është preferuar të sforcohej me dizajnim kuqezi, duke tërhequr edhe emra e familje me kontribute e respekt në të kaluarën. Pavarësisht që edhe zogjtë e malit po t'i pyesja se cila gjuhë dëgjohej në këto hapësira, do të përgjigjeshin saktë. Gjithashtu, edhe zogjtë në eter duke fluturuar, po t'i pyesje se çfarë imazhi ka ky vend, edhe ata do të thonë: nuk po shohim plisa të bardhë dhe tirq e jelek, e as gjyrdi, por këta njerëz shumica shqip po flasin dhe shqiptarçe po jetojnë dhe të tjerë që nuk janë të kërcënuar asnjëherë dhe flasin si të duan dhe jetojnë sipas dëshirës së tyre, pa i ngacmuar njeri. Madje, edhe kur nuk e respektojnë rendin e domosdoshëm të gjërave të rregulluara me kompromise, pa e instaluar logjikën e shumicës dhe të pakicës!

Agjenda e këtyre bisedimeve dhe përmbajtja e këtyre 15 pikave nuk mund të akceptohen plotësisht, pa u shërbyer me një digresion për një varg zhvillimesh:

Të kujtojmë ngjarjet në Universitet (ku është truri nacional), dyshimet në armatën e mjekëve dhe mantelbardhëve; dyshimet te veteranët e UÇK-së; mbjellja e dyshimeve te përkatësia e uniformës së TMK-së, dyshimet në Policinë e Kosovës dhe nga një varg zhvillimesh paradoksale, dyshimet në instancat e drejtësisë, dyshime në shumicën dërmuese te të gjallët. Të mirë thuhet se kanë qenë vetëm dëshmorët, por jo as edhe bashkëluftëtarët e tyre të gjallë etj. Nga të gjithë shembujt e mundshëm, do të zgjedh për ilustrim të idesë në trajtim grevën e aeroportit, që u motivua për paga më të larta të 16 kontrollorëve të aeroportit “Adem Jashari”.

Në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit në OKB për Kosovën, përfaqësuesja e Serbisë e akuzonte administratën ndërkombëtare dhe atë vendore në Kosovë se po krijojnë institucione të korruptuara dhe me karakteristika të dyshimta. Duke e ilustruar këtë tezë me theksin në aeroport. Në arsyetimin e zotit Petersen se ky aeroport është shpërblyer nga instancat përkatëse evropiane për shërbime korrekte dhe për suksese në kontroll të pasagjerëve dhe aeroplanëve, përfaqësuesja e Serbisë mbeti pa tekst. Por, pas dy ditësh filloi greva e njohur e 16 kontrollorëve për paga më të larta në aeroportin “Adem Jashari”, kërkesë shumë e arsyeshme dhe e pranueshme për opinionin e gjerë dhe veçanërisht për nivelin e pagave të Kosovës. Duke rrezikuar dy aeroplanë, njëri lëshohet pa komandë të plotë, duke e rrezikuar jetën e pasagjerëve dhe dëmet tjera materiale dhe në imazh të aeroportit dhe tjetri për pakëz arrin ta ndërrojë drejtimin dhe të aterojë në Shkup. Aeroporti u mbyll për një javë. Opinioni së shpejti do të mësojë se 16 kontrollorët ishin trajnuar në vendet evropiane dhe secili i kishte kushtuar aeroportit nga 100 000 euro, ndërsa pagat e secilit ishin më të mëdha se 1 800 deri në 2 500 euro. Gjendja kaotike në aeroport zgjati një javë. Pas kërcënimeve për përgjegjësi penale për rrezikim të pasagjerëve dhe për kthim të shumës së shpenzimeve për trajnimet, kontrollorët grevistë

u kthyen në punë. Dikush i kishte lajthitur për mundësinë e ngritjes së pagave. Ndoshta as që dinin se çka është folur në Këshillin e Sigurimit.

Me këtë grevë, efekti i vërejtjeve të përfaqësues se Serbisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së e dha efektin. Megjithatë, u dëshmuua se kishte diçka të parregullt, edhe përkundër asaj që deri me këtë rast nuk kishte ndonjë shembull për të keq në këtë aeroport. Përkundrazi. Nga ky shembull që merret për herë të parë në këtë kontekst, për të ilustruar manipulimin e qytetarëve tanë nga shërbimet inteligjente për ta dëmtuar imazhin e Kosovës në emër të së mirës individuale dhe kolektive.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës!

Pasi respektimi i ligjeve të Kosovës dhe autoriteti kushtetues nuk ishte vendosur në veri, janë imponuar këto bisedime.

Meqenëse ky realitet është kështu dhe meqenëse ne jemi këta që jemi dhe kështu si jemi, është imponuar kjo marrëveshje. Këtu, nga kjo përbërje, shumica prej neve i kemi përkrahur bisedimet. Gjithashtu, edhe unë çdo herë, kur është trajtuar kjo temë. Bisedimet e kanë prodhuar këtë marrëveshje me këto 15 pika, pa e lënduar bazën kushtetuese. Secili nga ne, por edhe përfaqësuesit tanë në bisedime po të lejoheshin ta shprehnin vullnetin vetëm të tyre, do të ndryshonin shumë finesa. Por, në çdo marrëdhënie kontraktuale me ndërmjetësues, ka një koncept dhe një teori, që përfaqësuesit tanë e kanë përvetësuar deri në perfeksion. Sa nga e drejta ndërkombëtare, sa nga empiria e pasur.

Por, edhe ata, edhe ne, jemi të vetëdijshëm se në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, në procesin e negociatave për të krijuar marrëveshje, për të mbyllur konflikte dhe për të ndërtuar marrëdhënie bilaterale në tavolinë, nuk funksionojnë konceptet e arenës, por duhet të gjendet harmoni e mundshme në përplasje të pretendimeve racionale dhe joracionale. Si përfundim, kurrë nuk ka një epilog perfekt. Por, një epilog të mundshëm dhe të imponuar, por të pranueshëm.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ky epilog ka premisa ngushëlluese për të gjithë njerëzit e ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm. Ka sfida për këtë brez dhe për brezat që do të vijnë. Këto kapacitete që ka shoqëria jonë dhe në perspektivën e saj, kjo marrëveshje është një shans për Kosovën dhe për perspektivat tjera që synon populli i saj.

Kjo marrëveshje atakon shumë diskurse politike në Serbi dhe në Kosovë. Ata në Serbi le të veprojnë çfarë të duan në realitet të ri me këtë sfidë, me diskursat e tyre politike. Por, i kisha lutur, i kisha përgjyruar, të gjithë ata në Kosovë, që ndihen të goditur në diskursin e tyre në të ardhmen nga kjo marrëveshje, të mos eksperimentojnë me teori e diskurse demagogjike në pragmatizmin e tyre politik, duke e shndërruar Kosovën në një teatër të absurditetit eksperimental. Vetëm e vetëm për t'i mbuluar e justifikuar teoritë e proklamuar me pompozitet, duke i lajthitur qytetarët me halle reale të aspekteve sociopolitike e me derte e preokupime të vërteta atdhetare, duke e paragjykuar këtë epilog dhe duke interpretuar subjektivisht përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje, duke mos marrë në konsideratë realitetin që e ka prodhuar atë, e cila është prodhuar në bashkëpunim edhe me mbështetje të miqve të Kosovës dhe të popullit të saj.

Gjithë energjinë tonë dhe kapacitetet tona duhet t'i drejtojmë në proceset tjera që do të kërkojë vendi dhe pesëmbëdhjetë mijë qytetarët shqiptarë për t'u kthyer në veri në pronat e tyre dhe në krijimin e kushteve për ta avancuar pozitën e përkatësive tona në Preshevë, Bujanoc, Medvegje dhe në Sanxhak. Për të hapur kapituj të tjerë për të pagjeturit, për suksesionin dhe për zhdëmtimet nga dhuna e luftës së fundit dhe madje edhe për zhdëmtimin e pronave dhe pasurisë së paluajtshme të të gjithë trashëgimtarëve të 647 fshatrave të ndjekur nga trojet e tyre, të cilët si dëshmi kanë vendosur në mbiemrat tyre vendbanimet nga janë ndjekur me dhunën e shfrenuar shumë mizore.

Gjithashtu, krejt në fund, duke qenë unik, pozitë dhe opozitë, në raport me Serbinë, do të trasojmë perspektiva të shumta individuale dhe kolektive. Duke qenë unik, do ta rritim dinjitetin e popullit të Kosovës dhe do ta forcojmë integritetin e saj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë do të doja të numëroja një sërë pasojash, që do të ishin të menjëhershme, nëse teksti i kësaj marrëveshjeje aprovohet përfundimisht.

Teksti, për të cilin ka rënë dakord Hashim Thaçi, mundëson që policët e pjesëtarët e sigurimit serb, të cilët kanë vrarë policë shqiptarë, t'i veshin uniformat e Policisë së Kosovës dhe të legalizohen.

Ligji për vetëqeverisjen lokale u garanton qytetarëve serbë të drejtën e organizimit komunal, por jo edhe atë etnik. Thirrja në nenet e këtij ligji për bashkim etnik të komunave është tejkalim i normave të tij.

Asociacioni i komunave serbe në kuptimin praktik përbën një autonomi etnike të serbëve në Kosovë. Autonomia e serbëve të Kosovës shprehet përmes asociacionit, i cili ka kryetar, zëvendëskryetar, kuvend, përfaqësues, ka kufij, buxhet, organe ekzekutive në fushën e arsimit, kulturës, sigurisë, gjyqësisë, urbanizmit dhe shëndetësisë. Ky asociacion është autonomi, për shkak se ngushton kompetencat e organeve qendrore karshi atyre të asociacionit si në fushën e sigurisë, ashtu edhe në të gjyqësisë, ndërsa zgjeron ato komunale përmes autonomisë.

Në momentin e ndarjes mbi baza etnike dhe bashkimit mbi këtë bazë, krijohen kushte për një ndarje etnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve dhe strukturat e reja shtetërore, të cilat në thelb shprehin një autonomi, që i ka të gjitha atributet e autonomisë, përveç emrit.

E drejta qytetare u predikua si një prej vlerave më të mëdha evropiane, por pa pritur në rastin e serbëve në Kosovë, kjo vlerë e lartë evropiane, së paku e proklamuar kështu te ne, u bë e parëndësishme.

Format reale të autonomisë do të shfaqen gjatë procesit të implementimit, atëherë kur do të krijohet kuvendi i asociacionit, statuti, financimi, policia dhe përfaqësimi i serbëve në të gjitha strukturat e shtetit. Në këtë kohë ndoshta Hashim Thaçi mund të mos jetë

kryeministër i Kosovës, por ai do të mbahet mend edhe nga serbët edhe nga shqiptarët, si njeriu i cili ka ndikuar në krijimin e këtij entiteti autonom politik serb në Kosovë, entitet ky i cili më pastaj ka realizuar interesat e shtetit serb brenda territorit të Kosovës.

Prandaj, të nderuar deputetë, më lejoni që ta bëj një shqyrtim të platformës politike të Serbisë, për bisedimet me Kosovën dhe ngjashmërinë që kjo platformë ka me tekstin e marrëveshjes aktuale. Platforma politike e Serbisë për bisedimet e Kosovës thotë se në pajtim me kushtetutën e saj dhe me parimet bazë të ligjit ndërkombëtar, Republika e Serbisë, me besim të mirë ofron platformën politike për bisedime me përfaqësuesit e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Prishtinë.

Pika fillestare themelore për bisedime me këta përfaqësues, sipas kësaj platforme në nivelin e lartë politik, është që Republika e Serbisë, në pajtim me ligjin ndërkombëtar dhe më tej sipas Kushtetutës së saj dhe vullnetit të popullit, nuk e njeh dhe kurrë nuk do ta njohë shpalljen unilaterale të pavarësisë së Kosovës. Pra, nuk do të ndryshohet asnjë ligj i Serbisë dhe as Kushtetuta e Serbisë, por ligjet në Kosovë do të duhet të ndryshojnë.

Parimi themelor i negociatave do të jetë: bisedime në pako, asgjë nuk është dakorduar derisa gjithçka të mos jetë e dakorduar. Më tej, kjo platformë thotë se Republika e Serbisë, përmes një përfaqësuesi të lartë të autorizuar posaçërisht dhe ekipit negociator të autorizuar posaçërisht, veçanërisht insiston:

- a) Në themelimin e komunitetit autonom të komunave serbe në Kosovë, të përbërë nga autonomia territoriale e katër komunave nga pjesa veriore e Kosovës dhe komunat tjera me popullatë shumicë serbe dhe minoritare.

Mund të shihet qartë se kësaj pike të platformës i korrespondon pika 1 e tekstit të Marrëveshjes, e cila konkretisht thotë: “do të ketë një asociacion, bashkësi me shumicë serbe në Kosovë. Anëtarësia do të jetë e hapur për secilën komunë tjetër, nëse anëtarët aktual pajtohen.” Më tej teksti i kësaj platforme thotë: “Kjo autonomi do të presupozojë ekzistimin e përgjegjësive autentike në fushat e arsimit fillor; sekondar; dhe të lartë; shëndetësisë; sportit; kulturës; shërbimeve të informimit publik; mbrojtjes e ambientit; formulimi dhe menaxhimi i politikave të mbrojtjes së ambientit dhe zhvillimit të qëndrueshëm; planifikimit urban; autoriteti ekzekutiv për rregullimin e planifikimit urban dhe menaxhimit të instrumenteve të tërë procesit sikur edhe në procedurat për procesimin e kërkesave dhe miratimin e tyre; autoritetin ekzekutiv për rregullimin e sistemit për zhvillimin e tokës urbane, që përfshinë përcaktimin e kriterëve për llojet e ndryshme të tokës dhe përdorimit të tokës; autoritetet ekskluzive për krijimin dhe zhvillimin e politikës për tokë dhe banim, bujqësi, pylltari, inxhinierim i ujit, gjueti dhe peshkatari.”

Kjo që sapo e lexuam i korrespondon plotësisht pikës 4 të tekstit të Marrëveshjes, e cila thotë: “Në përputhje me kompetencat e dhëna nga Karta Evropiane për Vetëqeverisje dhe Ligji kosovar, komunat pjesëmarrëse duhet të jenë në gjendje të bashkëpunojnë për të zbatuar fuqitë e tyre kolektivisht, përmes asociacionit të bashkësisë. Asociacioni, bashkësia, do të ketë mbikëqyrje për zhvillimin ekonomik, arsim, shëndetësi dhe planifikim urban e rural. Gjyqësia, prokurorët publik të instancës së parë dhe gjykatat e instancës së parë dhe të dytë, gjyqet në rajonin e këtij komuniteti autonom, siç quhet në

platformë, do të themelohen nga ligjet në nivelin krahinor, megjithatë, do të përcaktohen me marrëveshje, se kjo rezulton nga procesi politik, se ligjet duhet të parashohin një mekanizëm me të cilin qytetarët e Kosovës, munden përveç përfaqësuesve të tyre të ndikojnë dhe në zgjedhjen dhe përbërjen e gjykatave.

Këto gjykata do të kenë autoritetin në rajonin e këtij entiteti autonom, sipas rregulloreve të fuqizuara në Kosovë, për të vendosur në të gjitha çështjet gjyqësore, që ndërlidhen me marrëdhëniet bazike, personale, të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, të shpallin dënime dhe masa të tjera kundër kryerësve të veprave kriminale dhe veprave tjera të dënueshme të përcaktuara me ligj, për të vendosur rreth ligjshmërisë së akteve individuale të organeve dhe organizatave që ushtrojnë autoritetet publike, të vendosin rastet e ndërlidhura me çështjet pronësore apo çështje të Ligjit të punës dhe të vendosin rreth çështjeve të tjera në pajtim me ligjet në fuqi.”

Kjo pjesë i korrespondon pikës 10 dhe 11 të tekstit të marrëveshjes. Në to thuhet:

10. Sistemi i drejtësisë do të integrohet në kornizën ligjore të Kosovës dhe do të operojë brenda kësaj kornize. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të formojë një panel të përbërë nga shumica e gjyqtarëve serbë të Kosovës, për t’u marrë me të gjitha komunitat që kanë shumicë serbe.

Po ashtu, pika 11 thotë: një njësit i Gjykatës së Apelit, i përbërë nga stafi administrativ dhe gjyqtarët do të jenë të vendosur në Mitrovicën veriore, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë. Secili panel i divizionit të lartshënuar do të jetë i përbërë me një shumicë të gjyqtarëve serbë të Kosovës. Gjykatësit përkatës do të vendosin varësisht nga natyra e rastit, në të cilin jetojnë.

Punët e brendshme: thotë Policia autonome do të ishte në kuptimin formal, pjesa e platformës çka thotë: - pjesë e forcave policore të Kosovës, edhe pse do të funksiononte nën autoritetin e Këshillit ekzekutiv të këtij komuniteti autonom, siç quhet në platformë apo se tani po quhet bashkësi apo asociacion, në territorin e autonomisë dhe sipas përgjegjësisë të definuara me ligjet në pajtim me aktin më të lartë ligjor të APM apo KIM dhe statutin e këtij entiteti.

Pikërisht për këtë pikë të platformës së Serbisë bën fjalë pika 7, 8 dhe 9, pra thuhet: “duhet të ketë një forcë policore, të quajtur Policia e Kosovës, të gjithë policët në veri të Kosovës duhet të integrohen në strukturën e Policisë së Kosovës, pagat do t’i marrin vetëm nga Policia e Kosovës.”

Pra, ashtu siç e parasheh platforma serbe për bisedime, që do të ketë një forcë policore të Kosovës dhe policët e këtij rajoni do të integrohen brenda kësaj force policore, po ashtu edhe teksti i kësaj marrëveshjeje parasheh që do të ketë një forcë policore, ku të gjithë policët në veri të Kosovës do të integrohen në kuadër të Policisë së Kosovës dhe për më tepër, pjesëtarëve të strukturave tjera të sigurisë serbe, do t’u ofrohet një vend i njëjtë me strukturat kosovare.

Dhe, pika 9 thotë: do të ketë një komandant rajonal të policisë, për katër komunat me shumicë serbe: në Mitrovicë veriore, Zveçan, Zubin-Potok dhe Leposaviq. Komandanti i këtij rajoni duhet të jetë serb, shtetas i Kosovës, i nominuar nga Ministria e Brendshme, nga një listë e dhënë nga 4 pjesëtarë të këtyre komunave me emër të asociacionit. Përbërja e Policisë së Kosovës në veri do të reflektojë përbërjen etnike të popullsisë së 4 komunave.

Në platformë shënohet në këtë vazhde edhe minierat, energjia, telekomunikacioni e siç dihet dhe siç thuhet në tekstin e Marrëveshjes, në pikën 13 të saj, do të ketë dialog shtesë dhe këto çështje do të diskutohen deri më 15 qershor të vitit 2013.

Këshilli ekzekutiv ka autoritetin ekskluziv në çështjet që ndërlidhen me tregtinë dhe organizimin e panairëve. Po ashtu edhe politikat fiskale dhe financat, autoriteti i këtij entiteti, në pajtim me aktin më të lartë ligjor të Kosovës, një mundësi të garantuar për vendosjen e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me autoritetet e Republikës, sikurse edhe të drejtën e financimit shtesë nga mjetet e ndara nga buxheti i Republikës së Serbisë.

Për këtë platformë të Serbisë, tashmë është rënë dakord nga ana e kryeministrit Thaçi e kjo dakordësi është Fondi për zhvillimin e veriut, pra njëlloj buxheti paralel.

Ndërkohë, pika 3 e tekstit të Marrëveshjes, ku thuhet se strukturat e asociacionit, bashkësi do të ndërtohen mbi bazën që e parasheh statusi aktual i asociacionit të komunave të Kosovës, si presidenti, zëvendës-presidenti, Kuvendi dhe Këshilli, përkojnë me pjesën e poshtme të platformës së Serbisë.

Me këtë rast, ky komunitet autonom i komunave, siç...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Jakup Krasniqi e ka fjalën.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Se duhet një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, kjo është e kuptueshme, ajo i duhet edhe rajonit edhe Bashkimit Evropian.

A është arritur një marrëveshje e tillë, historike, ku Serbia do ta njihte vërtet Kosovën, shtet, këtë duhet ta shohim?

Nga informacionet që kemi, nuk mund të themi se kjo ka ndodhur. Ndoshta, koha do ta bëjë të tillë, koha di të bëjë edhe zgjidhje të duhura, bile ndonjëherë edhe të mrekullueshme.

Natyrisht, nëse kjo marrëveshje është e plotë, duhet përshëndetur. Dhe, e plotë do të ishte kur Serbia heq çdo pengesë për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të

Bashkuara. Kjo do të ishte marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve të plota në mes Kosovës dhe Serbisë apo nënshkrimi i traktatit të paqes, siç kanë thënë qeveritarët tanë.

Nëse marrëveshja është në mes shteteve të pavarura, ajo duhet të ratifikohej në Kuvend, kështu e parasheh edhe Kushtetuta, por jo edhe çështje të brendshme të Kosovës. Marrëveshja do të ishte historike, sikur vërtet do të shënonte një përmbyllje të plotë të çështjeve të pazgjidhura në mes dy vendeve tona e të cilat janë të shumta.

Koha do të tregojë se çfarë niveli është kjo marrëveshje, apo është marrëveshje e tipit të atyre teknike. Dhe, nëse vërtet Serbia ka njohur Kosovën, shtet të pavarur, siç po thonë qeveritarët tanë. Këtë gatishmëri nuk po e shohim nga ana serbe. Këtë duhet ta bëjë Serbia, përfaqësuesit e saj. Besoj që Serbia nuk i ka autorizuar qeveritarët tanë, që të flasin në emër të saj.

Unë kam qenë për bisedime, jam për normalizimin e plotë të marrëdhënieve me serbët e Kosovës e Serbinë, por kjo që e pamë të shkruar në 15 pika, nuk është e tillë. Këto janë kushtet e Serbisë, për t'i shuar strukturat e saj në Kosovë. Kush mund ta garantojë se politika në Beograd nuk do të veprojë ndryshe?

Ne e kemi parë sa e sa herë këtë. Këto 15 pika nuk e përmbyllin kompromisin apo kompromiset tona, përkundrazi hapin shtigje për kompromise të reja dhe që krijojnë premisa të shumta në dëm të stabilitetit dhe të sigurisë dhe jo vetëm në Kosovë.

Këto kërkesa kështu si janë do të duhet të ishin reciproke me komunitat shqiptare në Serbi. Ajo që duhet të vlente për serbët në Kosovë, pse të mos vlente edhe për shqiptarët në Serbi. Kjo marrëveshje këtu si është konceptuar, është largim nga koncepti qytetar dhe multietnik i Republikës së Kosovës dhe mund të shërbejë si precedent për gjithë rajonin. Këto bisedime siç është thënë dhjetëra herë nga kryeministri dhe vartësit e tij, kanë pasur për qëllim normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe se kjo marrëveshje do të përmbyllej me një traktat paqeje.

Po të ishte e tillë, nuk besoj që do të kundërshtohet nga njerëzit e politikës në Kosovë. Këto bisedime janë zhvilluar në mjegull, thënë më së buti dhe nuk mund të prodhonin diçka tjetër veç mjegullës. Nuk ka dyshim se për këto dokumente jemi njoftuar më shumë nga korrespondentët tanë në Bruksel, e fare pak nga raportimet, që kryeministri i ka bërë opozitës së urtë, presidentes dhe në fund edhe Kuvendit, institucionit përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, i cili është kthyer në institucion për miratimin e ligjeve me 31 vota.

Dhe, në fund, dokumentin që e kemi përpara dhe po e debatojmë, është dokument më shumë se gjysmak dhe nuk i jep të gjitha përfundimet e tij, vetëm lë të hapura çështje të ndryshme.

Çfarë dokumentesh politiko-ligjore prodhon ky dokument, ne nuk e dimë dhe me qëllim është i hartuar kështu. Kur të detajohet, ka mundësi të kuptojmë se ku fle djalli, por

atëherë do të jetë vonë, tepër vonë. Ndoshta, kompromisi që mund të përbëhej sikur marrëveshja të ishte e plotë dhe përfundimtare, dhe e plotë do të ishte sikur të përmbylej me traktatin e paqes, me njohjen e reciproke dhe të anëtarësimit të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në mekanizmat tjera evropianë e ndërkombëtarë, por kjo nuk po ndodh. Përkundrazi, po kundërshtohet fuqishëm edhe nga vetë bashkëbiseduesi i Thaçit, Tadiqi. Mandej, marrëveshja kështu si është nuk është ndërshtetërore, por për çështjet e brendshme të Kosovës. Kjo është jo vetëm kundër rezolutës së Kuvendit, por edhe në kundërshtim me dokumentin bazik të shtetit. Madje, as kështu si është, nuk po gjen përkrahje te popullata serbe në pjesën veriore të Kosovës.

Pra, nuk po na del se është marrëveshje, përveç emrit që e ka të tillë, edhe pse marrëveshja edhe kështu si është, nuk është e plotë. Vetë fjala që po flitet për kompromis, do të thotë se është shkuar përtej dokumentit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës. Përtej Kushtetutës dhe ligjit që e kemi miratuar. Ajo çka po mungon këtu është emri i vërtetë i kësaj autonomie. Sa është e thellë kjo autonomi me 15 pikat që i kemi në shqyrtim, e kemi vështirë ta themi kështu siç e kemi këtë dokument.

Në pikën e dytë, garancitë juridike sigurohen nëpërmjet ligjit në fuqi. Nuk thuhet nëpërmjet cilave ligje? Nuk thuhet nëpërmjet ligjeve të Kosovës. Pastaj vazhdohet 'të ligjit kushtetues me 2/3'. Çka ka konsituuese te asociacioni komunave, në pikën e tretë? Asociacioni i komunave e ka kryetarin, zëvendëskryetarin, Asamblenë dhe Këshillin. Nëse ky asociacion ose bashkësi do të ishte ashtu siç është në dokumentet tona, përse i kushtohen 6-7 pika të kësaj marrëveshjeje, ose parimeve të marrëveshjes.

Pika pesë thotë se asociacioni i komunave do t'i ushtrojë edhe përgjegjësitë e tjera shtesë, varësisht si delegohet nga autoritetet qendrore. Nga cilat autoritete, të kujt janë ato autoritete? Nuk e thotë. Pse nuk thuhet, 'autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës'. Përse është hezitur të përmendet Republika e Kosovës në këtë dokument të marrëveshjes. Pa e zgjatur, as pikat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe drejtësinë nuk janë më të mira, ndërsa pika 14 e lë mundësinë për vazhdimin e politikave agresive serbe ndaj Kosovës. Kjo do të thotë se lihen mundësi të shumta për kompromise të reja. Kjo do të thotë se me këtë marrëveshje, jo vetëm që nuk janë normalizuar marrëdhëniet, por, sipas rrethanave, edhe mund të acarohen. Unë nuk do të hezitoja të kontribuoj për ratifikimin e një marrëveshjeje që do t'i normalizonte marrëdhëniet Serbi-Kosovë, edhe me këtë nivel të kompromisit, por jo këtë farë marrëveshje të njohur si Marrëveshja Daçiq-Thaçi, e cila pothuajse nuk e zgjidh asnjë problem, as ndëretnik, as ndërshtetëror. Le të rrumbullakohet marrëveshja me të gjitha detajet, me të gjitha përfundimet dhe normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve tona. Atëherë, përgjegjësia dhe obligimi ynë do të ishin tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedavajući!
Poštovani predstavnici Vlade,
Poštovani ambasadori,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Ovaj istorijski događaj, koji smo sve zajednice na Kosovu sa nestrpljenjem pratili i očekivali pozitivne rezultate, i sa jedne i sa druge strane, se napokon posle 14 godina dogodio. Sporazum koji je potpisan o principima koji regulišu normalizaciju odnosa uspostavljanju mira, suzbijanju konflikta i netolerancije, sprovođenju Ustava Republike Kosova na celokupnoj teritoriji naše države, je od neprocenjive vrednosti, sa akcentom na pravosuđe, koje će biti integrisano u okvirima pravosudnog sistema Kosova. Bošnjačka zajednica koja živi u severnom i južnom delu opštine Mitrovica, ali u pograničnom delu sa Republikom Srbijom, zahvaljuje se svim domaćim i međunarodnim organizacijama, koje su na bilo koji način pomogle da do ovog sporazuma dođe, da se njihov život napokon normalizuje, uz međusobnu saradnju i uvažavanju sa Albanskom, Srpskom, turskom i drugim zajednicama, koje zajedno vekovima žive, poštujući kulturne vrednosti i norme svake nacionalne zajednice, kao i upotrebu službenih jezika u svakodnevnom životu. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Dialogu politik i Kosovës është pazar i çuditshëm. Serbia blen, kurse Kosova pagan. Kosova po pagan me territor dhe me dorëzimin e sovranitetit. Analizën e kësaj të ashtuquajtur marrëveshje e bënë kolegët e mi nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, prandaj unë nuk do të merrem shumë me analizë. Zaten, nuk do shumë mend për t’u analizuar se sa e dëmshme është kjo marrëveshje për Republikën e Kosovës.

Por, e ashtuquajtura marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e përsëris edhe një herë, nuk është marrëveshje e Kosovës me Serbinë, por është marrëveshje e Thaçit me Serbinë.

Duke qenë i tillë, populli i Kosovës as që duhet ta vlerësojë ndryshe prej asaj që është në të vërtetë. Pra, nuk duhet ta respektojë, por ta kundërshtojë fuqishëm. Kjo marrëveshje nuk i normalizon marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, as ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, por përkundrazi i ndan edhe më shumë popujt dhe konkretisht e ndan edhe Kosovën në dy entitete.

Kryeministrin e Kosovës e kemi dëgjuar para disa ditësh, në njërin nga tubimet në përkujtim të dëshmorëve, duke iu drejtuar kundërshtarëve të marrëveshjes me këto fjalë dhe me këtë zhargon. Po përpiqem ta parafrazoj: “Ku është ajo autonomi për serbët? Ku është Republika Sërpska? Ku është ndarja e Kosovës?”. Ne dhe i përgjigjemi: Aty e ke, zoti kryeministër, shpalose këtë marrëveshje dhe aty e gjen edhe autonominë për serbët, edhe Republikën Sërpska, edhe ndarjen e Kosovës, edhe të gjitha ato të zeza që ia solle Kosovës nga këto bisedime.

14 vjet u mundua zoti kryeministër të vijë deri këtu. E ka pasur shumë më lehtë. Dhe, ne ia bëjmë një pyetje: Pse u mundove kaq shumë kur këtë çështje ke mundur ta bësh para 14 vjetësh? Nëse do ta dinte Serbia që do t’ia sillje këtë marrëveshje, nuk do të sillte as ushtarë, as policë, as paramilitarë për t’i vrarë shqiptarët kundërshtarë të Serbisë. Këtë që

e bëre sot, ke mundur ta bësh para 14 vjetësh. Ka mjaftuar t'i dorëzoheshit Serbisë, e cila gabimisht ju paska ndjekur atëherë.

Para 14 vjetësh, ju e mashtruat popullin e Kosovës. Ju i mashtruat shqiptarët! Ju e mashtruat edhe Kuvendin. Ju e mashtruat edhe Preshevën. Ju i mashtruat edhe miqtë ndërkombëtarë. Ju i mashtruat edhe familjarët e dëshmorëve. Ju i gënjyet dëshmorët e kombit, sa herë shkuaat te varri duke u thënë se jeni në rrugën e tyre.

Ju i paskeni parasysh dëshmorët, ashtu siç tha kryeministri tani, edhe luftëtarët, edhe mësuesit, edhe punëtorët, edhe fëmijët. Nëse i paskeni pasur parasysh dëshmorët, pse e vratë qëllimin e tyre, kryeministër? Nëse i paskeni pasur parasysh punëtorët e “Trepçës”, pse ua ndatë “Trepçën”, kryeministër? Nëse i paskeni pasur parasysh fëmijët e Kosovës, pse ua mbylle shkollat shqipe në veri të Mitrovicës, kryeministër?

Dëshmorëve ua ndërrove flamurin, ua çarmatose ushtrinë, ua vrave qëllimin, ua shpërbleve armikun. Në vend që sot të raportoni sesi i keni luftuar strukturat kriminale në veri, ju sot po raportoni me mburrje se si ia mbyllët rrugën Forcës së Sigurisë të Kosovës që të mos shkojë atje. Me këtë gjë, ju po e bëni FSK-në ashtu siç tha Daçiqi, ‘çizme që nuk mund të shkelë në veri’. Madje, ju e bëtë edhe një marrëveshje të fshehtë për këtë. Zaten, ju vetëm e nënshkruat një kërkesë të Serbisë që ka të bëjë me FSK-në. Pra, kjo marrëveshje e fshehtë ia ndalon FSK-së të jetë e pranishme atje, përveç në rastet kur i kërkohet nga serbët lokalë si argatë të paarmatosur, ashtu edhe siç edhe jeni ju, zoti kryeministër sot, përballë Serbisë së armatosur.

Në vend që ju të raportoni sesi i keni arrestuar vrasësit e Enver Zymberajt, ju po ia bëni kolegë atij. Në vend që ju të raportoni sesi i keni shpërbërë strukturat e MUP-it të Serbisë, ju po i legalizoni dhe po i armatosni ato me uniformat e Policisë sonë dhe me armët e Policisë sonë. Ju edhe një herë po e ndani Policinë në baza etnike, ashtu siç edhe u analizua në marrëveshjen që ka të bëjë me Policinë dhe me komandantin regional të veriut të Kosovës.

Në vend që ju të raportoni se si i keni shpërbërë strukturat e BIA-së, ju po ato po i legalizoni dhe po ia bashkëngjithni AKI-së. Ju, në vend që t'i bëni presion Serbisë, po i bëni presion Kuvendit të Kosovës. Në vend që të dërgoni policë kundër kriminelëve serbë të Serbisë në veri të Kosovës, ju i keni sjellë ata që ta rrethoni Parlamentin. Ju me këtë po ia jepni Serbisë në dispozicion krejt strategjinë e mbrojtjes së Republikës së Kosovës, nëse e keni pasur ndonjëherë atë. Pra, ju i dhatë Serbisë atë çka nuk mund ta fitojë Milosheviqi as me luftë. Por, dijeni mirë se kur nuk do të jua njohim këtë marrëveshje të dëmshme për Kosovën dhe për popullin e saj.

Ne jemi marrë vesh njëherë me Serbinë, e nëse nuk e ke marrë vesh, ta rikujtojmë, sepse ju jeni marrë vesh me Serbinë, por nuk jeni marrë vesh me hanxhiun. Nëse ti i ke dhënë të drejtë Serbisë që ajo të jetë e pranishme brenda Kosovës, madje edhe brenda Parlamentit të Kosovës, këtë të drejtë nuk e keni ju. Këtë të drejtë nuk jua ka dhënë populli, madje as votuesit tuaj.

Por, dëgjo Hashim Thaçi, kudo që të jesh: Ky nuk do të jetë ballafaqimi juaj i fundit me ne! Ky nuk do të jetë ballafaqimi juaj i fundit me popullin e Kosovës! Mendoje përballjen me popullin e Kosovës para se t'ia bëni këtë padrejtësi. Ne vërtet jemi popull bujar, ne vërtet dimë të falim, por kur nuk do t'ia falim Serbisë atë çfarë ka bërë mbi popullin shqiptar të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Ju përshëndes,

E mirëpres informatën e sjellë nga kryeministri, sado që dua të them që në fillim se nuk m'i ka hequr dilemat e shumta që ka prodhuar teksti që e kemi përpara. Madje, as nuk më ka bindur se janë marrë parasysh sugjerimet e vërejtjet që janë bërë në këtë Kuvend. Dhe, që në fillim dua ta theksoj qartë - do të kisha dashur shumë që të isha në pozitë që sot të them e përkrah, e mbështes, madje edhe nëse kërkohet e pëlqej, siç u tha këtu. Like! Por, teksti që e kemi përpara nuk e krijon këtë mundësi, nëse duam të qëndrojmë në obligimin kushtetues që e kemi, që të veprojmë në përputhje me ndërgjegjen dhe me vullnetin e votuesve, të cilët i përfaqësojmë.

Dhe, le të kuptohem. Mbetem i bindur dhe i përcaktuar për dialog, madje për bisedime, edhe politike. Është ditur se këtu do të vinin. Pse vihem në lajthitje? Aq më shumë jam i përcaktuar për respektim të plotë të të drejtave të komuniteteve dhe të komunitetit serb, po ashtu. Kurrëgjë më pak se të tjerët, bile diç më shumë se të tjerët, por edhe unë pajtohem me ata që tërheqin vërejtjen se këtu nuk është fjala për të drejtat e minoriteteve. Është më shumë, është sherr politik, prandaj më lejoni që, megjithatë, disa nga vërejtjet t'i theksoj qartë.

Teksti që e kemi përpara e ka një mjegullnajë që frikëson, që lë shumë dyshime, madje edhe procedura, me të cilën po veprojmë. Në tekst të rendit të rendit të ditës kemi: Raport i kryeministrit. A është raport ky që e kishim? Ishte një informim. Faleminderit! Por, raport nuk është.

Flitet për marrëveshje. A është marrëveshje teknike, apo çfarë marrëveshje? Marrëveshje ndërmjet kujt? Në tekst nuk kemi asgjë. Ka shumë rëndësi cilësia me cilën nënshkruhet një marrëveshje. Është marrëveshje për çka? Për parimet që e rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve. A janë këto më poshtë parime? Apo janë disa prej tyre çështje teknike. Ta zëmë, a mund të jetë parim pika 8, po e marr cilëndo. 'Pjesëtarëve të strukturave serbe' në shqip, në serbisht 'pjesëtarëve të strukturave tjera serbe', u sigurohet, do t'u ofrohet vend ekuivalent në strukturat e Kosovës. Është parim ky? Pse nuk u themi me emrin që e kanë? Është 'parime për normalizimin e marrëdhënieve'.

A e normalizojnë raportin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë këto parime, le t'i quajmë, ose këto formula, quajini si të doni. Vetëm këto probleme kemi pasur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me zgjidhjen e të cilave të normalizohen raportet? Paska qenë lehtë! Dy-tri

formula, dhe u zgjidh çështja! A besoni, zoti kryeministër? Unë jam i bindur se nuk e besoni. E dini se do të jetë rrugë e gjatë deri te normalizimi dhe unë, besoni, ju kuptoj. E kuptoj edhe pozitën tuaj, por, megjithatë, sot këtu duhet ta themi të vërtetën.

Pastaj, ne paskemi pasur vetëm problem brenda Kosovës me Beogradin? E, a ka pasur ndonjë problem matanë kufirit? A kemi ne ndonjë çështje që do të duhej ta shtronim për ta zgjedhur në raport me Serbinë? Këtu janë shtruar sa e sa probleme, janë sugjeruar që të vihen në agjendë. Pse asnjë nuk e gjejmë? Dhe, a mund të konsiderojmë që u normalizua në këtë mënyrë të njëanshme? Druaj që të detyrohemi përsëri të kemi kontribute të reja dhe marrëveshje të reja.

Është një xhevahir, një marrëveshje që i ka dy emra, dhe bashkësi, edhe asociacion. Edhe thuhet se është e njëjta gjë, sepse është me të njëjtën bazë ligjore. Më lejoni vetëm kalimthi të shtroj disa nga dilemat. Është fjala për bashkësi, siç thuhet tekstualisht, të komunave me shumice serbe. Asociacioni, që e kemi ne është inkluziv. Asociacioni që krijohet është ekskluziv. A do të thotë që prishet asociacioni i mëparshëm? Çfarë ndodh me Kushtetutën në këtë rast? Çfarë ndodh me parimin kushtetues që e definon shtetin e Kosovës si shtet multi-etnik? A është ky njëfarë getoizimi apo aparteidi institucional dhe kush e merr përgjegjësinë në këtë çoroditje që po e ndërtojmë ne dhe nuk është as...?

Dhe, për më tepër, a është e njëjta gjë? Në pikën dy thuhet se asociacioni, bashkësia, “zajednica” shpërbëhet vetëm me vendim të komunave. Nuk është kjo për asociacionin e deritashëm. Dhe, kjo rregullohet me ligj kushtetues. A është e njëjta gjë, do ta pyesja edhe kolegun, ekspertin e Kushtetutës. A është e njëjta gjë një asociacion që rregullohet me statut dhe quhet ‘asociacion’, dhe një themelatë, që quhet bashkësi - “zajednica”, dhe kështu ka filluar Republika Sërpseka në Bosnjë, dhe kërkohet të rregullohet me ligj kushtetues. A kemi ne ligj kushtetues?

Më tutje, ‘shpërbëhet vetëm me vendim të 2/3 të komunave’. Nuk është kjo për asociacionin që e kemi. E çka nëse bashkësia, quajeni si të doni, asociacioni që po krijohet, del ndesh me Kushtetutën, del ndesh me Kartën Evropiane për të Drejtat e Pakicave, ose të pushtetit lokal? Çka do të ndodhë? A kemi të drejtë ta rishqyrtojmë edhe funksionimin e tillë jokushtetues, eventualisht po supozoj. Pse ky përcaktim që kurrqysh nuk mund të shpërbëhet në situata të caktuara? Për asociacionin e deritashëm është kjo formulë. Pse është fshirë?

Pastaj, janë disa kompetenca të tjera shtesë që delegohen nga autoritetet qendrore. Mirë u tha, nuk sqarohet cilat autoritete qendrore. Disa kompetenca që atje po barten, i ka pasur një autoritet qendror, për ne i huaj. Çka po ndodh tani? Dhe cilat janë ato? Pse nuk është ky asociacioni i deritashëm i komunave? A është e njëjta gjë?

‘Kanë rol përfaqësuesit e autoriteteve qendrore’. A ka të bëjë kjo me sistemin kushtetues, kolegë të nderuar, ekspertë juridikë? Nëse kanë si rol përfaqësues, çka ndodh me rolin përfaqësues që e kanë deputetët që janë zgjedhur këtu? Çka ndodh me rolin që e kanë deri tash komunat në sistemin tonë? A po hallakatet sistemi kushtetues? Pastaj, Policia e Kosovës duhet ekskluzivisht të ketë komandant të një kombësie. Komunat, tashmë me

shumicë shqiptare, në rast se 10% e komunës është e një komuniteti, duhet ta kenë zëvendëskryetarin e atij komuniteti. E pse nuk bëka që një zgjidhje e tillë të lejohet edhe në pjesën ku shqiptarët nuk janë shumicë? Ata zakonisht nuk përmenden fare, në asnjë variant, as kur janë shumicë, as kur janë pakicë. Ç'është ky trajtim anormal, asimetrik, alogjik? Pse? Kujt i vyen?

‘Strukturave tjera serbe’ në serbisht, në shqip vetëm ‘strukturave serbe’ u ofrohet vend ekuivalent në strukturat e Kosovës. Çka do të thotë? Çka do të thotë ‘vend ekuivalent’ dhe si funksionon kjo? Pastaj, në drejtësi themelohet një panel, që përbëhet me shumicë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kemi marrë qëndrim të mos e zgjasim, por edhe një minutë.

HYDAJET HYSENI: ...po e mbyll, por vërejtjet vazhdojnë dhe do të dëshiroja ta kemi rastin ndoshta në ndonjë ballafaqim publik në media, që t’i bisedojmë, t’i sqarojmë këto. Uroj që unë ta kem gabim. Unë në këtë Kuvend, zonja e zotërinj, e kam pas treguar një anekdotë për atë “dushk e gogla”. Dikush më ka thënë që ajo e ka vazhdimin. Kur ata që hiqen se e kanë mashtruar njërin me dushk e gogla, shkojnë edhe ua shesin pastaj njerëzve të vet ato me sukses. Uroj që kjo të mos ndodhë. Uroj që të mos jetë kjo një lajthitje e madhe, por teksti ma bën të pamundshme të votoj ‘për’, ose. Nuk mund të votoj edhe për “zajednicën”, edhe për asociacionin, me dallimet që i thashë. Prandaj, zgjedh, pa dashjen time, të abstenoj, dhe për këtë mendoj që fajtor përgjegjës janë ata që e kanë sajuar këtë gjuhë ambigu...

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Përderisa tani ndarja u realizua dhe shqiptarët në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë u tradhtuan sërish, shqiptarëve në fakt po u errësohet e ardhmja. Varësia nga Serbia u shtua, pasi u shtua pavarësia e veriut nga Kosova. Ndodhi ajo që e paralajmëruam, ndodhi pra thellimi i ndarjes në vija etnike, ndodhi më keq se në Bosnjë, pasi u eliminua plotësisht reciprociteti, edhe me serbët e veriut, e lëre më me Serbinë.

U braktis plotësisht shtet-ndërtimi. Shtet-ndërtimi nënkupton shtrirjen e sovranitetit, pasi ky është hapi elementar i tij. Shtrirja e sovranitetit nga forcat që burojnë nga brendia e një populli, e natyrisht jo nëpërmjet koncesioneve. Dhe, Lëvizja Vetëvendosje e konsideron të mundshme plotësisht një gjë të tillë, vetëm se për këtë është e nevojshme një politikë tjetër. Politikë që e forcon shtetin, e jo që e dobëson atë, dhe zgjidhja ekziston dhe janë dy hapa konkretë themelorë që do të duhej t’u paraprinin veprimeve në shtrirje të sovranitetit. Ata janë ndalimi i negociatave me Serbinë armiqësore, ku Kosova është objekt negociatash dhe palët janë të pabarabarta, dhe e dyta vendosja e sovranitetit, e reciprocitetit me Serbinë në aspektin ekonomik e tregtar.

Pa këta hapa dhe me këtë politikë që po vazhdon, Serbia armiqësore në raport me ne sot është më e fortë se dje, e dje është më e fortë se pardje. Me këtë politikë, ajo çdo ditë forcohet dhe rrjedhimisht edhe errësohet e ardhmja e shqiptarëve në Kosovë.

Më të fortë e bëjnë negociatat, ku ajo, përpos koncesioneve, fiton edhe hapjen e dyerve në BE, e të cilën gjë po ia mundësojmë ne. Ajo do ta kishte të lehtë integrimin atje pas njohjes së Republikës së Kosovës. Por, jo! Ajo do që të hyjë në BE pa na njohur, dhe këtë po ia mundësojmë ne. Në anën tjetër, 50 ditë të reciprocitetit e dëshmuar varësinë ekonomike të Serbisë nga Kosova. Ata dita-ditës hidheshin në krizë dhe ne, ekonomia jonë filloi të këndellet nëpërmjet prodhuesve vendorë pikërisht atyre ditëve.

Pra, është rast historik që Kosova e ka mundësinë tani ta kushtëzojë Serbinë me këto dy aspekte, që do ta ndryshonin totalisht rrjedhën në të mirë. Këta dy hapa do të bënin që Kosova t'i krijojë mundësitë e veta për shtrirjen e sovranitetit, pasi Kosova çdo ditë do të jetë më e fortë në raport me Serbinë. Këta dy hapa do ta ndryshonin për 180 shkallë raportin tonë me Serbinë dhe mundësitë për shtrirjen e sovranitetit atje do të bëheshin realitet dita-ditës. Ne do të forcoheshim dhe pashmangshëm sovraniteti do të shtrihej edhe në veri.

Politikë të ngjashme ka përdorur Kroacia, e cila sot është shtet sovran, dhe jo Bosnja, së cilës ne po i përngjajmë çdo ditë. Shtrirja e sovranitetit atje është natyrisht zgjidhje e mundshme, pas këtyre hapave që do të ndërmerreshin. Dhe, kjo pastaj do të nënkuptonte si hap të parë, kur FSK-ja do të duhej të shpallej ushtri dhe kjo do ta hapte rrugën pastaj për marrëveshjen SOFA me NATO-n për ushtrinë e Kosovës. Natyrisht, prania e Policisë së Kosovës duhej shtuar dhe njësitë speciale duhej t'i ndërtonin bazat edhe në pikat 1 dhe 31, përpos në zonat ku shqiptarët janë atje.

Kosova duhet t'i krijojë pastaj marrëdhëniet e fuqishme bilaterale me shtetet e veçanta që na ka njohur pavarësinë, e posaçërisht me Shqipërinë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet kryesore të BE-së dhe me Turqinë. Duhet të vihen patjetër në shënjestër burimet financiare të strukturave ilegale dhe armiqësore të Serbisë, duhet gjurmuar dhe prerë financimin e tyre nga Serbia dhe nga krimi i organizuar e bizneset informale. Këto ishin pikat në shtyllën e parë, që nënkupton shtyllën e sigurisë, në planin e Lëvizjes "Vetëvendosje" për shtrirjen e sovranitetit në veri. Dhe, natyrisht, jo vetëm kaq. Është e domosdoshme që në normalizimin e situatës të parashihet edhe integrimi social-politik dhe ekonomik i veriut.

Dhe, kjo mund të ketë paqe të qëndrueshme pa reciprocitet dhe simetri të të drejtave ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve në Serbi.

Shqipëria dhe Kosova bashkërisht duhet të angazhohen për shqiptarët kudo që janë, e posaçërisht për ata në Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Arsyeja kryesore pse Serbia e ka shënjuar decentralizimin në Anamoravë, është që ta hedhë farën ndarjes dhe izolimit të asaj pjese nga Kosova. Qeveritë dhe kryeministrat e pasluftës janë munduar t'i integrojnë serbët, duke u dhënë ose premtuar mijëra euro kesh, duke u falur traktorë dhe duke ua ruajtur pagat edhe kur ata punonin për Serbinë. Zgjidhja është krejtësisht ndryshe. Jo para e privilegje, por zhvillim arsimor, ekonomik e barazi para ligjit. Jo bisedime me Serbinë dhe strukturat e saj, por integritet territorial për vendin e sovranitet për shtetin.

Rivitalizimi i “Trepçës”, funksionalizimi i saj, që do të rezultonte me punësimin e rreth 8 000 vetave, do të kontribuonte në bashkimin e qytetit, sepse ndarja në Ibër e kalon minierën e Stan-Tërgut në njërin anë, ndërsa shkritoren, në anën tjetër. Kështu, Mitrovica u shndërrua në qytetin më të varfër dhe është i vetmi qytet në Kosovë, të cilit i është zvogëluar popullsia gjatë viteve.

Ofrimi i bursave për shqiptarët dhe serbët nga veriu për në shkollat e mesme dhe në Universitetin e Prishtinës, investim në Spitalin e Prishtinës dhe në atë në jug të Mitrovicës, në mënyrë që aty të ofrohen shërbime më të mira; forcim i fshatrave shqiptare dhe të lagjeve të Mitrovicës, të banuara me shqiptarë në veri, duke u ofruar mjete për rindërtim të shtëpive, infrastrukturë të mirë, transport publik falas për në jug të Mitrovicës dhe anasjelltas, tri herë në ditë; lehtësim në punësim, lehtësim për regjistrim në Universitet. Vetëm me 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000, 11 shqiptarë janë vrarë, me dhjetëra të tjerë janë keqtrajtuar ose lënduar, ndërsa 1 564 familje, me 11 364 anëtarë, janë dëbuar. Secili shqiptar i dëbuar duhet të kërkojë të kthehet në pronën e vet në veri, dhe njëkohësisht të organizohen dhe të mobilizohen për këtë. Ata që nuk duan, duhet ta thonë hapur këtë dhe t’ua shesin të tjerëve pasurinë, atyre që duan të kthehen atje.

Qeveria duhet ta ndihmojë dhe ta mbështesë këtë me një program të veçantë. Nuk duhet lejuar që Qeveria e Serbisë t’i blejë pronat e shqiptarëve në veri. Të gjithë shqiptarët që janë detyruar t’i shesin pronat e tyre, Qeveria e Kosovës duhet t’ua blejë ato. Këto ishin pikat që Lëvizja “Vetëvendosje” i ka publikuar prej kohësh për shtrirjen e sovranitetit në veri, që është një logjikë krejtësisht e kundërt me politikën e stome.

Marrëveshja tani, që është plotësisht në përputhje me platformën e Serbisë, ashtu siç e dëshmoi, siç e argumentoi deputeti Afrim Kasolli, në fakt krijon kushtet që Serbia ta njohë Kosovën. Serbia tash, nëse e krahasojmë me Bosnjën, i ka kushtet elementare për ta njohur Kosovën. Por, ajo nuk do ta bëjë këtë. Nuk do ta bëjë këtë, sepse ka shpresa ende për të që të vazhdojnë negociatat dhe të bëhen koncesionet për të, madje jo shpresa të kota, por është shumë e qartë që negociatat pas kësaj marrëveshjeje nuk do të përfundojnë. Do të vazhdojnë dhe do të ketë edhe koncesione të tjera, dhe prapë nuk do të ketë njohje nga Serbia.

KRYESUESI: Faleminderit! Zëvendëskryeministri Kuçi e ka fjalën për të sqaruar

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Natyrisht, më lejoni që edhe unë të jap perceptimet e mia lidhur me çështjen e dialogut, do të thosha në tërësi, por në veçanti me ato që është arritur, apo është parafuar në dialogun e përbashkët Kosovë-Serbi, me ndërmjetësimin e BE-së.

Më lejoni në fillim të them se dialogu ka filluar me një bazë juridike të qartë, që është marrë nga Rezoluta e Kuvendit të Kosovës, por me një bazë juridike që është krijuar, apo

është kërkuar edhe nga Rezoluta e OKB-së, me lehtësimin e BE-së në këtë fazë. Pra, deri më tani duhet të them se dialogu ka qenë me një bazë të qartë juridike dhe nuk ka hyrë askush në dialog në raport me Serbinë pa e ndërtuar bazën juridike të vendit.

Çështja e dytë ka të bëjë me dialogun në gjendjen dhe nevojën për dialog. Natyrisht që ne kemi pasur dy mundësi në raport me dialogun. Mundësia e parë ka qenë ta ruajmë një status quo, çfarë e kemi pasur për vite të tëra, në veçanti atë në veri, por edhe në raportet me Serbinë, dhe mundësia e dytë ka qenë që ta ndryshojmë atë gjendje. Natyrisht, ndryshimi i gjendjeve në botën demokratike bëhet në dy forma. E para, e preferueshme, është me dialog, e dyta është me dhunë, apo me fuqi. Natyrisht kur nuk e ke të dytën, shpeshherë, edhe pa dashur, duhet të jesh pjesë e së parës. Ne gjendjen në veri nuk e kemi pasur shumë të mirë dhe nuk e kemi edhe sot e kësaj dite. Si rezultat i pafuqisë tonë, si rezultat i mosmbështetjes adekuate ndërkombëtare dhe si rezultat të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të Serbisë. Kush ka qenë aktor në këtë marrëveshje? Kemi qenë ne, natyrisht, ka qenë Serbia natyrisht dhe ka qenë BE-ja, si dhe faktorët tjerë ndërkombëtarë. Por, edhe marrëveshjen e kanë prodhuar këta.

Nuk është prodhuar marrëveshja nga një anë dhe këtë duhet ta kemi parasysh. Të gjithë ne që kemi qenë për dialog, duhet t'i kemi parasysh dy gjëra: e para, kushdo që shkon në dialog e ka parasysh të arrijë marrëveshje, jo të mos arrijë marrëveshje, dhe e dyta, dialogu nënkupton një lloj kompromisi. Dhe, nëse ne themi sot që kemi dashur të shkojmë në dialog, por nuk kemi dashur të arrijmë marrëveshje, nuk dalim të sigurtë dhe seriozë dhe nëse themi sot se kemi shkuar në dialog dhe nuk kemi bërë asnjë kompromis, po ashtu nuk dalim shumë të sigurtë.

Dhe, çfarë ka qenë qëllimi ynë? Qëllimet tona në raport me brendinë e Kosovës kanë qenë tri: të ruhet ligji i aplikueshëm i Republikës së Kosovës dhe Kushtetuta. Dhe, unë e them me bindje të plotë, i dëgjova vërejtjet me vëmendje - asnjë nen i Kushtetutës së Republikës së Kosovës me këtë dokument nuk ka nevojë që të ndryshohet.

Çështja e dytë, ka qenë që të ruhet karakteri unik i sistemeve, në veçanti i drejtësisë dhe policisë dhe nëse e lexojmë me vëmendje, në asnjë vend nuk priset sistemi apo karakteri unik as i drejtësisë e as i policisë së Kosovës.

Dhe, e treta, ka qenë qëllimi ynë ta ruajmë hierarkinë shtetërore të institucioneve qendrore të Kosovës me ato lokale kudo që të mund të jenë, edhe në Leposaviq, edhe në Zubin-Potok edhe Zveçan, edhe në Mitrovicën e veriut, kurdo që krijohet ajo.

Natyrisht që ne kemi pasur dëshirë që përmes të një dialogu të fitojmë edhe më shumë, edhe në hapat në integritet në Union Evropian, do të thosha, të fitojmë më shumë edhe me njohjen e atyre që nuk na kanë njohur deri sot, të fitojmë më shumë edhe me raporte me rajonin, dashur e pa dashur, janë të cinguar pa një raport të shëndoshë, por kemi dashur të fitojmë më shumë, do të thosha, edhe në raport me Serbinë, për të përfunduar me atë që mund ta quajmë njohje reciproke.

Nuk është thënë rastësisht, është marrëveshja e parë. E keni parë në titull, nënkupton që kjo marrëveshje është hap për të vazhduar më tutje, ose e kundërta ka qenë mundësia e tillë.

Unë dua të them një fakt, edhe sikur ta shkruanim në marrëveshjen, sikur të mos ishin garant BE dhe SHBA, nuk do të duhej ta nënshkruanim me Serbinë. Dhe po ashtu po them, pajtohem edhe me zotin Shala, fati i kësaj marrëveshje varet në implementim. Implementimin duhet ta kemi ne, në radhë të parë, por presim implementim dhe fuqi nga NATO, BE dhe të tjerët. Nëse ata do ta implementojnë do ta ndryshojnë gjendjen në terren. Nëse do të na ndihmojnë, e nëse nuk e implementojnë, e degradojnë edhe këtë pjesë të arritjes së marrëveshjes së deritanishme.

Natyrisht se në këtë perspektivë unë e shoh edhe një fakt, dhe fakti që është bërë marrëveshja për herë të parë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Nuk është në kuptimin praktik shumë, ose juridik, me rëndësi, në kuptimin psikologjik besoj se është me rëndësi.

Është hera e parë, ne kemi negociuar me ta edhe në Rambuje, këta që kanë pasur fatin të jenë, edhe në Vjenë ata që kanë pasur fatin të jenë, edhe unë kam qenë një prej tyre, po edhe në të parën edhe në të dytën s'e kemi arritur marrëveshjen me ata. Dhe marrëveshja që ka qenë, ka qenë, ne i kemi zbatuar obligimet njëanshëm. Ka qenë fat i madh, edhe në të parën edhe në të dytën, garantët e sotëm, NATO, SHBA e BE na kanë ndihmuar, përndryshe, pa një marrëveshje, edhe çlirimi do të ishte i mëvonshëm, besoj ende do të mund të kishim qenë në luftë me ata, dhe besoj që edhe pavarësia do të kishte qenë më e rëndë. Pra, besimi ynë në SHBA dhe në BE, ne besojmë që edhe këtë pjesë që e kemi bërë.

Në anën tjetër nëse më lejohet ta them, ne kemi pasur edhe kemi vullnet të vazhdojmë me tema të tjera. Temat e tjera që janë përmendur dy, që ka të bëjë energjetika dhe transporti, janë përmendur çështjet e të pagjeturve dhe çështje tjera. Kjo mundësi do të na jepet me një përfundim që të zgjidhen problemet që janë të pazgjidhshme me Serbinë.

Kjo marrëveshje, tash për tash, nëse e lexojmë me kujdes, kryesisht ka të bëjë me normalizimin e gjendjes në veri.

E kam thënë herën e kaluar, ne edhe me luftë, edhe me shpallje të pavarësisë e kemi hequr Serbinë deri në veri, deri te lumi Ibër, nuk kemi mund ta heqim më shumë. Dhe unë dua ta pranojmë një fakt, as s'kemi pasur fuqi, as s'na kanë ndihmuar sa duhet, por në atë anë ka qenë një, ose edhe sonte, më shumë, më pak është prezenca e institucioneve të Serbisë, atje. Kjo marrëveshje është një mundësi që atje të zgjidhet dhe të integrohen qytetarët serbë atje në mënyrë paqësore dhe të dinjitetshme.

Në anën tjetër, kjo marrëveshje, po them, do të shkojë zvarrë, do të ketë telashe, nuk krijojmë iluzion që do të bëhet brenda ditës, por besoj shumë që kjo marrëveshje është një udhërrëfyes se nga duhet të shkojnë gjërat, dhe nëse gjërat do të shkojnë duke u ruajtur Kushtetuta, sistemi juridik i institucioneve, unë besoj se do të ketë integrim, ndoshta më të ngadalshëm se sa me dhunë, ndoshta më ngadalshëm se sa kishim dashur

ne, gjithsesi si do të jetë një mundësi e tillë. Shpeshherë shtetet edhe kur e kanë mundësinë për ta përdorur dhunën e përdorin në fillim dialogun, dhe unë besoj që bëjnë mirë. Dhe në këtë rast është përdorur dhe duhet të përdoret, sa herë që t'i thonë dikujt të jepni pëlqim, edhe unë t'i them dikujt shko bëj dialog, i them shko bëj dialog për të arritur marrëveshje. Sa herë që t'i them shko bën dialog, i them bën dialog të bësh edhe nga pak kompromis. Nëse i mbajmë pozitën e njëjta, s'ke nevojë të shkosh fare.

Dikush kishte pasur të thotë, raport me Preshevën, që u përmend këtu. Unë e them kështu, raportet e ngrira me Serbinë nuk i ndihmojnë shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, por as serbëve në veri. Raportet e ndryshueshme në me Serbinë i ndihmojnë që pastaj të kemi kërkesa të përafërta dhe modeli që mund të përdoret për serbët në Kosovë mund të jetë i pranueshëm se ky model është i propozuar jo shumë prej mendjes sonë, për mendjes së partnerëve tanë ndërkombëtarë dhe atë mendje mund ta bartim pastaj një model i mirë, nëse po ju duket që është, edhe në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Dhe po ashtu duhet ta them ose duhet ta ndryshojmë gjendjen në raportet e fuqisë tonë ose në raport me fuqinë me normalizim, përndryshe status quo-ja nuk u ndihmon shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë për aq sa s'kemi mund t'i ndihmojmë për 13 vjet me radhë.

Nëse më pyet dikush dhe me siguri që duhet të pyet si e definon këtë marrëveshje? Unë e them kështu, marrëveshja është në proporcion me fuqinë që e ka Kosova sot, fuqinë politike, ekonomike, ushtarake, diplomatike si do që e quani, është marrëveshje në përputhje dhe proporcion me mbështetjen ndërkombëtare që e kemi sot dhe është në raport me gjendjen në terren si është sot. Kur t'i ndryshojmë këto, unë jam i bindur se edhe marrëveshja do të ndryshojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoxhaj e ka fjalën.

ENVER HOXHAI: Faleminderit!

I nderuari zoti nënkryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Pas këtyre orëve shumë të gjata unë do të bëj përpjekje që të mos përsëritëm, por më lejoni t'i them në vija shumë të përgjithshme disa reflektime të mia se si e shoh këtë marrëveshje.

Së pari, një marrëveshje e tillë është marrëveshje e parë bilaterale ndërshtetërore në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Është një marrëveshje e cila padyshim ka peshën e vet, jo vetëm në relacionet Kosovë Serbi, por është një marrëveshje e cila ka peshën e vet edhe sa i përket stabilizimit, paqes dhe progresit në rajon.

Ne duhet të jemi të vetëdijshëm që gjeografia e ka bërë Kosovën dhe Serbinë të jenë fqinj, që historia jonë ka qenë një histori e dhembshme, por që edhe Kuvendi i Kosovës edhe Qeveria e Kosovës edhe institucionet e Kosovës kanë përgjegjësi se si ta formësojnë të ardhmen. Kjo marrëveshje e mbyll njëherë e përgjithmonë një kaptinë të dhembshme

të historisë së Kosovës, kaptinën e dominimit, kaptinën e triumfit dhe hap një kaptinë të re të bashkëpunimit në mes të vendeve tona.

Së dyti, marrëveshja në tekstin e saj nuk është asgjë tjetër veç se pranim i ekzistencës politike të shtetit të Kosovës, pranim i sovranitetit tonë të brendshëm, të sovranitetit tonë territorial, pranim i Kushtetutës sonë, i sistemit tonë politik dhe trajtim i Kosovës si shtet fqinj dhe si partner. Dhe kjo marrëveshje është lexuar jo vetëm nga shtetet që e kanë njohur Kosovën, por është lexuar edhe nga vendet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën në këtë formë.

Së treti, marrëveshja është një kornizë e fuqishme për integrimin e komunave në veri të Kosovës, për shpërbërjen e strukturave ilegale të policisë, për ndalimin e financimit, të kontrollimit dhe për shpërbërjen e plotë të të gjitha institucioneve ilegale paralele që kanë ekzistuar atje. Dhe në mënyrë të qartë të gjitha pikat e kësaj marrëveshje në formë praktike operationale synojnë që të arrijnë një gjë të tillë, kështu që marrëveshja është një dokument i rëndësishëm që ta vazhdojmë projektin e ndërtimit të Kosovës multietnike, të Kosovës shumetnike, që është shumë kyç për ne.

Një projekt që ne e kemi realizuar në 2008 dhe 2009 brendapërbrenda Kosovës, një projekt të tillë do të duhej ta jetësojmë edhe në veri.

Së katërti, dhe mendoj që këtu nuk u përmend fare. Në 5 vjetët e shtetësisë dhe në 13 vjetët të lirisë sonë ne e kemi pasur çdoherë kartën e ndarjes territoriale dhe etnike në tavolinë. Marrëveshja njëherë e përgjithmonë i jep fund idesë së ndarjes së Kosovës dhe mendoj që kjo duhet të lexohet dhe të kuptohet drejt nga Kuvendi i Kosovës.

Së pesti, u përmend këtu çështja e dialogut, a do të duhej të hynte Kosova në dialog, a ka pasur nevojë për dialog, apo jo. Më lejoni t'ju them që në këto 6 muajt e fundit, sidomos në nivelin e dialogut në mes të kryeministrit Thaçi, si përfaqësues i Republikës së Kosovës dhe kryeministrit të Serbisë zotit Daçiq, Kosova ka pasur realisht një fuqizim të pozitës së saj ndërkombëtare. Asnjëherë në këto 5 vjet të shtetësisë së saj nuk ka pasur ngritje të Kosovës në skenën evropiane dhe ndërkombëtare se si i ka pasur në këto 6 muajt e fundit.

Prandaj, dialogu si proces, dhe arritja e marrëveshjes si produkt, realisht është dëshmi e pjekurisë sonë politike, e sjelljes sonë evropiane, por mbi të gjitha e vizionit tonë shtetformues, e një vizioni për një Kosovë të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve që jetojnë këtu.

Së gjashti, si shihet marrëveshja në relacionin evropian, Kosovë - Bashkimi Evropian? Më lejoni të ju them që marrëveshja do t'ia mundësojë Kosovës hapjen e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asocimit, që do të jetë marrëdhënia e parë kontraktuale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe institucioneve në Bruksel. Marrëveshja po ashtu do të hapë rrugë që 5 vendet e Bashkimit Evropian që s'e kanë njohur Kosovën ta marrin një vendim të tillë.

Unë nuk e kam ndërmend të flas në emër të tyre, se kur do të ndodhë një gjë e tillë, por mund të ju them se kjo marrëveshje është mirëpritur nga këto vende dhe jam shumë mirënjohës që përveç partnerëve tanë kyç, shteteve kyçe të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, veçanërisht Greqia dhe Sllovakia e kanë përshëndetur arritjen e kësaj marrëveshje.

Së shtati, prej fillimit të dialogut ka pasur një argument të përsëritur në mediet tona që dialogu do të duhej ta bllokonte procesin e njohjes ndërkombëtare të Kosovës. Për dy vjet kemi marrë 25 njohje. Që dialogu do të bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizmat ndërkombëtarë, anëtarësimi ynë në EBRD është përcjell me 46 vota edhe nga vendet që s'e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Prandaj ne shpresojmë që sikurse Serbia që ka thënë po, dhe është pajtuar me agjendën e integriteteve evropiane dhe anëtarësimin evropian të Republikës së Kosovës, po ashtu një ditë të afërt Serbia do t'i thotë po edhe anëtarësimin tonë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Kur debatojmë kaq vonë, nuk dua të them që me këtë marrëveshje është fundi i historisë, mirëpo një gjë duhet t'ju kërkoj që fokusin kryesor Kuvendi i Kosovës duhet ta ketë në implementimin e marrëveshjes. Historia njih shumë marrëveshje që janë arritur deri më tash, mirëpo historia njih edhe marrëveshje të cilat nuk kanë mund të implementohen. Fokusi ynë duhet të jetë se si ta implementojmë një marrëveshje të tillë.

Apeli im i fundit është ky, se dëgjova me vëmendje shumë interpretime të tekstit të marrëveshjes. Ka ndodhur shpeshherë në Ballkan që iluzionet janë marrë si fakte dhe faktet janë marrë si besim. Ju kisha lutur që mos e mbiinterpretoni marrëveshjen, lexojeni si të tillë, se besoj që është në interes të gjithë qytetarëve të Kosovës, edhe të atyre që janë të përfaqësuar në këtë Kuvend të Kosovës.

KRYESUESI: Ju lutem, edhe kaq sa keni folur, ju të Kabinetit qeveritar, nuk keni të drejtë. Me gjithë respektin, por s'keni të drejtë. Mësoni Rregulloren e punës të Kuvendit, ju lutem. Edhe kjo vlen për juve. Nuk keni pasur të drejtë as kaq sa keni folur. Afrim Hoti e ka fjalën.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Le të sjellim në vëmendje disa raste të ngjashme me këtë që ka bërë të premtën, më 19 prill, Hashim Thaçi. Rasti i parë është shitja e Shkodrës Malit të Zi nga Esat Pashë Toptani, në vitin 1913, akt që për fat rezultoi pa suksesshëm. Ai e kreu këtë veprim për të siguruar përkrahjen e Malit të Zi për t'u vënë në krye të Shqipërisë. Do të vazhdonte veprën e tij në vitin 1914, pikërisht kur Greqia nëpërmjet Kristaç Zografos përpunonte dhe impononte të ashtuquajturin Protokoll të Korfuzit për aneksimin e Shqipërisë së Jugut, të ashtuquajturit Vori Epir. Serbia përgatiti dhe i paraqiti Esat Pashës një marrëveshje që u përfundua me qytetin e Nishit, më 17 shtator të vitit 1914. Ajo parashikonte eliminimin e Shqipërisë së pavarur, të shpallur shtet nga Kuvendi i

Kombëtar i Vlorës, më 28 nëntor 1912 dhe të njohur e pranuar si subjekt i së drejtës ndërkombëtare nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, me vendimin e 29 korrikut 1913.

Rreth një vit më vonë duke dashur të sanksiononte juridikisht situatën e krijuar si rezultat i pushtimit të Shqipërisë, Serbia shpejtoi ta plotësonte marrëveshjen e Nishit, të firmosur nga Esat Pasha dhe Nikola Pashiqi, me një akt tjetër, që njihet me emrin Marrëveshja Toptani - Jovanoviq, e cila në pjesën hyrëse mban datën 27 qershor 1915, kurse në pjesën përmbyllëse ka të shënuar datën 28 qershor 1915.

Rasti i dytë është dhurimi i Manastirit të Shën Naumit dhe i një pjese të Vermoshit, Serbisë, në vitin 1925, nga Ahmet Zogu,, si shpërblim për strehimin që Beogradi ofroi pas përmbylljes nga revolucioni demokratik i qershorit të vitit 1924 si dhe për përkrahjen që Serbia i dha për t'u rikthyer në pushtet. Veprimi u realizua mbi bazën e një marrëveshje tjetër që u nënshkrua në Beograd në gushtin e vitit 1924, nga i njëjti kryeministër serb Nikolla Pashiq me Ahmet Zogun, kryeministër shqiptar të rrëzuar nga pushteti dhe të arratisur në Jugosllavi. Marrëveshja e Ahmet Zogut me Serbinë nuk është vetëm dhurim i Shën Naumit dhe i Vermoshit, Marrëveshja parashikonte një spektër të gjerë veprimi dhe mjaft çështje të tjera që për nga rëndësia dhe pasojat përfaqësoi një akt tepër të rëndë dhe të paprecedent.

Në arkiva gjendet Marrëveshja formale, e nënshkruar nga Pashiqi dhe Zogu në Beograd, në gusht të vitit 1924. Fjala është për një marrëveshje që vendosë varësinë e plotë të Shqipërisë. Nga një lexim i shpejtë i tekstit, rezulton se Marrëveshja është një akt zyrtar...

KRYETARI: Deputet, je krejt jashtë rendit të ditës!

AFRIM HOTI: ...kapitulli për shtetin shqiptar krejtësisht i pamotivuar dhe juridikisht i pajustificuar. Në këtë marrëveshje të dy vendet binin dakord për realizmin e bashkimit doganor në bazë të të cilit importet dhe eksportet e mallrave midis dy vendeve të kryeshin pa pengesa dhe në liri të plotë. Lidhur ngushtë me këtë dispozitë figuronte edhe një klazë e cila për nga përmbajtja duket disi e çuditshme. Ajo thotë shprehimisht se edhe transiti nëpërmjet kufijve të dy vendeve do të jetë i lirë për ushtarët e dy vendeve. Më tej, marrëveshja sanksiononte pranimin e detyrimit të Qeverisë shqiptare për të deklaruar pranë Konferencës së Ambasadorëve në Paris, se tërhiqte pretendimin e saj për sovranitetin mbi manastirin e Shën Naumit dhe lokalitetet e Vermoshit dhe Kelmendit, të cilat do të mbeteshin nën zotërimin e Jugosllavisë. Në xhandarmërinë e Shqipërisë do të kishte gjithashtu një xhandarmëri serbe ku do të bënin pjesë edhe oficerë rusë e tjerë. Xhandarmëria do të pajisej me armë dhe do të firmosej nga Qeveria Jugosllave. Marrëveshja nuk linte jashtë vëmendjes një aspekt tjetër mjaft të rëndësishëm, çështjen e administrimit dhe drejtimit të veprimtarisë së institucioneve fetare shqiptare, ajo përcaktonte se Kisha Ortodokse Shqiptare do të tërhiqej nga varësia që kishte nga patriarku i Konstadinopojës dhe do të bashkohej me hierarkinë ortodokse të Beogradit.

Siç shihet nga për marrja e marrëveshjes së përshkruar më lart, duket se bëhet fjalë për një akt juridiko ndërkombëtar bilateral sipas të cilit praktikisht Shqipëria jo vetëm që do

të tkurrej e zvogëlohej në përmasa simbolike, por do të cenonte gati krejt atributet sovrane të një shteti të zakonshëm dhe praktikisht do të eliminohej si subjekt i së drejtës ndërkombëtare.

Marrëveshja, për shkaqe politike, gjeopolitike veproi për fatin e shqiptarëve vetëm në njërën prej aspekteve të saj në realizimin e cenimit territorial të Manastirit Shën Naumit dhe në pjesët e Vermoshit. I të njëjtit rend me këto raste ishte edhe mbajtja me të padrejtë e Kosovës dhe territoreve tjera shqiptare nën Jugosllavinë e pasluftës së Dytë Botërore. Kështu, udhëheqësit institucionalë të asaj kohe nuk ngurruan të bëjnë marrëveshje personale me udhëheqësit e Serbisë, për interesa personale e në dëm të popullit shqiptar të Kosovës.

Viti 2013, Hashim Thaçi, në tekstin ku ka dhënë siglën e tij si kryeministër thuhet: “Komandanti i këtij rajoni duhet të jetë serb, shtetas i Kosovës, i nominuar nga Ministria e Brendshme, nga një listë e dhënë nga katër kryetarët e komunave, në emër të asociacionit”. Përbërja e Policisë së Kosovës në veri do të reflektojë përbërjen etnike të popullsisë së katër komunave. Ky mund të jetë lirisht rasti tjetër i tentativës për të dorëzuar një pjesë të territorit tonë për të lejuar padrejtësi të reja me shqiptarët në Mitrovicë e veri të vendit dhe për të cenuar sovranitetin e fituar me luftën e përpjekje të shumë brezave.

KRYETARI: Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari, zoti kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar, aq sa keni mbetur,

Sonte po diskutojmë tekstin e marrëveshjes së parë, siç quhet ky dokument. Teksti që e kemi para vetes, për mua ka qenë pak a shumë i pritshëm, nëse e kemi parasysh rrjedhën e këtyre bisedimeve, temat që janë diskutuar dhe qasjen që e kemi pasur ndaj tyre.

Mungesë serioze e tërë këtij procesi të bisedimeve është se kanë mbetur jashtë vëmendjes disa çështje me rëndësi esenciale për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë e që kanë të bëjnë me vënien e drejtësisë në vend lidhur me pasojat e krimeve të luftës dhe me zhdëmtimin e atyre të cilëve u janë lënduar të drejtat e punës, u janë lënduar prona e pasuria dhe jeta e tyre, dhe ato pasoja në vitet 90 dhe në luftë sipas vlerësimeve konzervative mund të ofrohen në 20 miliardë euro.

Duhet të jemi të vetëdijshëm se pa zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe pa zhdëmtimin e atyre që kanë pësuar dëme në pasurinë e tyre private, pa vënien në vend të drejtave të tyre, atyre që kanë pësuar nga regjimi okupues serb gjatë vitet 90 dhe të luftës, nuk do të ketë normalizim real të situatës.

Qeveria e Serbisë duhet të bartë konsekuencat e veprimit të regjimit dhe Qeverisë serbe në vitet 90 në luftë. Kjo është e nevojshme për të ndërtuar marrëdhëniet reciproke dhe fqinjësore.

Teksti i Marrëveshjes ka natyrisht zbrazëti të problemeve dhe dykuptësi të veta, veçanërisht nenet 4, 6 dhe 8, ka dallime dhe në përkthime ngase edhe gjuha e tekstit sigurisht se nuk është aq precize dhe jo lehtë e përthyeshme. Po e marr shembull vetëm pikën 4, teksti në shqip, thotë se “asociacioni do të ketë vështrim të plotë mbi fushat si është zhvillimi ekonomik”, në serbisht vështrimi bëhet “nadzor” kurse në anglisht është “oberwju”. Dhe kuptimi i këtyre tri fjalëve lëviz prej kompetencave “vështrim” që s’është kompetencë ekzekutive deri te kompetenca ekzekutive që është fjala “nadzor”, pra që përmban pra fjala “nadzor”. Prandaj është mirë që këto çështje të trajtohen.

Ne sonte jemi në një situatë delikate dhe të përgjegjshme. Mosdhënia e pëlqimit në këtë tekst do ta vështirësonte pozitën tonë ndërkombëtare, pra pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe marrëdhëniet me partnerët tanë kyç. Mosdhënia e pëlqimit, madje nuk do të ishte as në funksion të tejkalimit të gjendjes së rëndë të status quo-s në veri me tendenca të përkeqësimit që një kohë të gjatë.

Situata pas kësaj marrëveshjeje mund të përmirësohet vetëm me kusht, nëse bashkësia ndërkombëtare pra, dhe kryesisht Bashkimi Evropian është e vendosur që të imponojë rregullat e sjelljes së Serbisë, që mos të ketë sjellje të dyfishtë që njërin ta flet e nënshkruan e tjetrën ta bëjë. Mandej, lidhur me këtë, edhe kanë përgjegjësi edhe institucionet e Kosovës, sepse janë partnerë dhe duhet të kërkojnë që gjërat të zbatohen drejt.

Megjithatë, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se ballafaqohemi së paku me tri rreziqe të mëdha, të cilat duhet të adresohen me shumë kujdes në planin e zbatimit. Rreziku i parë është i lidhur me rolin e Qeverisë serbe dhe interferimin e Qeverisë serbe në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Duhet t’i kushtohet kujdes maksimal që të përkufizohet një rol i Qeverisë serbe në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, i cili do të përqendrohej kryesisht në përgjegjësitë e saj jashtë territorit të Kosovës, pra t’i tërheqë forcat policore serbe nga Kosova, të ndalojë financimin jolegal dhe jotransparent dhe të pamundësohet me planin e zbatimit çfarëdo interference e Serbisë në zbatimin e Marrëveshjes në çështjet që janë për nga natyra çështje të brendshme të Kosovës, sepse në qoftë lëmë derë sa më të vogël, ne e kemi sjell Serbinë që vazhdimisht pra të jetë prezente këtu. Kjo është çështje esenciale, dikujt i duket çështje teknike, por është çështje shumë esenciale.

Rreziku i dytë, ka të bëjë me strukturat ilegale në veri që edhe tani po shprehin padëgjueshmëri, madje kinse padëgjueshmëri edhe ndaj Qeverisë serbe. Ato do të tentojnë që të ruajnë status quo-n në mënyrë që më vonë të imponojnë biseda të reja dhe me këtë edhe konsensione të reja.

Rreziku i tretë, pra është dhe po riprodhohet vazhdimisht asimetria, ka të bëjë me një asimetri që ne e kemi pranuar me planin e Ahtisarit dhe një asimetri që tash me këtë marrëveshje shkon, të jemi të sigurtë, edhe pak më larg. Ne kemi raste unike, pra në një shtet multi-etnik, po pajtohemi që serbët mund të gjykojnë vetëm nga gjyqtarët me kombësi të njëjtë, që nuk ka shembuj kurrkund në botë. Në vend se asimetria të shfrytëzohet, domethënë nga Serbia dhe nga tjerët pozitivisht për integrimin e serbëve në

Kosovë, unë po kam frikë se ajo po rrit apetitet për dezintegrim dhe asimetri edhe më të madhe.

Ka ardhur koha që Kosova të insistojë tash e tutje për reciprocitet. Ju e dini sa kemi insistuar çështjen e reciprocitetit. Ky Kuvend duhet ta detyrojë Qeverinë e Kosovës që ta zbatojë reciprocitetin. Bashkësia ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian duhet ta bëjnë një pako standarde të drejtave të minoriteteve që vlejné në gjithë rajonin dhe jo vetëm në Kosovë dhe jo vetëm për një etnikum, atë serb.

I vetmi parim që sjell normalizim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të marrëdhënieve midis shteteve është respekti reciprok dhe parimi i reciprocitetit. Gjithçka tjetër, është një kamuflim që herët a vonë do të shfaqet me probleme.

Dy çështje në fund, dëshiroj të tërheq vërejtjen që si duket kemi harruar t'i përmendim. I pari është që ne kemi harruar të merremi me kthimin e të shpërngulurve shqiptarë nga veriu i Mitrovicës dhe veriu i Kosovës. Ekzistojnë organizma ndërkombëtarë që kujdesen që të gjithë ata që në territorin e Kosovës kanë uzurpuar banesa të tjerëve, i shpërngulin prej banesave. Pse kjo mos të vlejë në veri? Pse ne mos të krijojmë kushte bashkë me bashkësinë ndërkombëtare që shqiptarët e shpërngulur nga Mitrovica e veriut dhe nga pjesë tjera, duhet të kthehen. Mendoj se kjo duhet të jetë shumë serioze në bisedat e mëtejshme.

Çështja e dytë ka të bëjë me integrimin evropian. Ne e kemi një formulim. Aty ky mund të jetë i rëndësishëm, por mendoj se ka ardhur koha që çështja e integritetit evropian të Ballkanit Perëndimor, të shteteve që kanë mbetur mbrapa, duhet të diskutohet seriozisht në Bashkimin Evropian, sepse po më duket qasja është jo produktive, qasja është pak a shumë diskriminuese dhe duhet të ndërtohet një strategji që këtë problem e shikon në pako. Nuk mund të ketë një normalizim as një zhvillim të hershëm, por edhe një përparim të Evropës kah integrimi nëse ne me dekada e me dekada do të merremi me këto katër - pesë shtete që kanë mbetur një nga një. Bashkimi Evropian dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të marrin masa që kjo çështje të trajtohet në mënyrë integrale, që të gjitha, mundësisht të kenë një perspektivë paralele të integritetit evropian dhe mendoj se kjo do të ishte një kontribut produktiv në qetësimin e situatës, dhe ndoshta edhe në stabilizimin e kësaj pjese që po vuan aq gjatë edhe për fajin historikisht, edhe për fajin , domethënë moti, për interferimet që i kanë pasur edhe forca të caktuara. Ju faleminderit.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Në vijë të njëjtë me qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së më duhet që të jap kontributin tim sa i përket draft-dokumentit, i cili në parim është, apo i ka vendosur inicialët për pranim, nga ana e të dy kryeministrave dhe është rezultat i disa rundave të bisedimeve që lidhet kryesisht me parimin e “normalizimit” që për mua gjithmonë kanë qenë nën thonjëza, e unë kam potencuar, vazhdoj t'i besoj dhe potencoj rregullisht, për

arsye që merret vetëm me tema dhe vetëm me agjendën e cila ndërton raporte minimale të fqinjësisë së mirë në kuadër të parimit të Kopenhagës, sepse procesi i integrimeve evropiane apo formati i bisedimeve është ndërtuar në procesin e integrimeve evropiane për të dy vendet. Interesi është që vendi ynë të marrë qartësi, përkundër mandatit të dhjetorit për fillimin e negociatave për stabilizim-asociim, ne kemi edhe tri kushte që pritet të vlerësohen nesër në raport të brendshëm, shpërbërja e strukturave paralele dhe rirregullimi i brendshëm në veçanti në tri komuna në veri, në komunën e parapërcaktuar apo paradizajnuar për veri në parimin e një qyteti me dy komuna, sepse është përballuar, është lënë, në parimet kryesore, nëse përmenden, vazhdimisht Ahtisari e harrohet se procesi Eshton e përballon, e tejkalon atë proces. Ky është proces i ri.

Atëherë, ky dokument qartëson dhe rishkruan të gjitha kompetencat që në rrafshin e pushtetit lokal i kanë këto komuna: e drejta e propozimit, e drejta e përfaqësimit dhe javën e fundit edhe e drejta e monitorimit u njihet si e drejtë themelore që këto komuna do t'i kenë në fushën e detyrave apo përgjegjësiive asimetrrike në raport me komunat me shumicë shqiptare.

Dhe duhet për të qenë i sigurtë për të thënë se eliminohet e drejta e vendimmarrjes dhe ekzekutimit si kërcënim serioz që ka qenë edhe shqetësimi ynë i vazhdueshëm.

Largimi i kërcënimit në krijimin e shtresës së re në vendimmarrje dhe në ekzekutim të vendimeve është kërcënim, sepse ajo cenon funksionalitetin dhe sakaton shtetin e Kosovës.

Duhet parë në implementim se çka nënkupton propozimi, përfaqësimi dhe monitorimi, sepse janë çështje që varësisht si ushtrohet kjo detyrë, varësisht se në çfarë mënyre ushtrohet, në çfarë kapaciteti ushtrohet, në çfarë mënyre financohet dhe si i pasqyrojmë ato financime do të jetë determinuese më vonë.

Një kënd tjetër, për të cilin unë desha të bisedoj, e kam përmend në të gjitha debatet, dua ta ritheksoj, falënderoj kolegët deputetë për solidaritet që ftesa ime e sigurtë, që kryeministri të merret me një temë të rëndë për shqiptarët e lindjes, po vjen në shprehje. 100 000 shqiptarë në lindje të Kosovës, apo në term ushtarak që ka mbetur tash, Luginë, është temë e cila duhet t'i kthehet në tavolinë gradualisht. Nëse deri në qershor dihen temat, janë energjia, minierat, telekomunikacioni, atëherë së paku në korrik e në gusht për të filluar për të menduar, për të mos i lënë ata njerëz në mëshirën e Zyrës Regjionale të OSBE-s në Vranjë e Bujanoc. Mundësisht të gjejmë, të krijojmë ambientin dhe për të filluar të bisedojmë për të drejtat e tyre politike atje, e ministrat tanë të fillojnë t'i listojnë të drejtat civile të tyre, sepse ata nuk kanë të drejtë as civile në Kosovë. Ky është problemi më serioz, sepse ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Drejtësisë, i cili ka premtuar vetë, iu ka premtuar zyre, Zyrën Ndërlidhëse, iu ka premtuar t'ua largojë taksën prej 40 eurosh, u ka premtuar letërnjoftime për ata që kanë bërë pesë në Kosovë, iu ka premtuar regjistrim pa kuotizim, u ka premtuar t'ua financojë gazetën "Jehonën", u ka premtuar zyre të "Vatrës" në Gjilan. Asnjë premtim s'e ka realizuar, asnjë kusht elementar s'ua ka bërë, asnjë më të vogël kujdes s'e ka kallëzuar.

Qeveria ka bërë fond, të cilin unë e mbështes, për zhvillim. Sa i kushton ta bëjë një fond për refundim të taksës së Qeverisë së Kosovës? 20 000 euro vendosën në fond refundim, qytetari shqiptar e paguan taksën në hyrje, në dalje, Qeveria ia jep paret, mbrapa e kthen dhe kënaqet ligji dhe nuk diskriminohen shqiptarët e atjeshëm. Ky është vendimi më elementar që mund të merret sot, nesër. Çka mund të bëhet, mirë është, lehtë, por ne i kemi lënë në harresë ata njerëz, jo duke u dhënë përparësi, nuk besoj që ka përparësi këtu dhe ka prioritete, po kanë mbetur pa kujdes.

Unë ju ftoj që këto katër-pesë premtime nesër kryeministri t'ua realizojë dhe t'u premtojë se ata do të jenë qenë pjesë e bisedave për të drejta politike, por pa i realizuar të drejtat civile në Kosovë, të drejtat civile në Kosovë, Daçiqi bën hajgare me kërkesa politike, sepse ai e humb motivin të flas për të drejta tjera kur e din saktë që qytetari shqiptar ka lindur në Kosovë, i ka bërë 14 vjet fëmija dhe nuk është rezident i Kosovës, ende. Iu ka cenuar e drejta e lindjes, më së pari, dhe e jetës, për shkak të prindërve, kuptohet.

Atëherë, për ta rrumbullakuar krejt këtë, së paku Qeveria jonë le ta bëjë një gjest të mirë në kuadër të këtij procesi të draft-marrëveshjes. Paralel me këtë, autoritet që ia jep rezoluta ose Kuvendi nesër, le ta marrë një përgjegjësi të vogël dhe t'i zgjidhë disa probleme të vogla që i ka për 100.000 banorë shqiptarë, sepse krejt çka po flas me rend, 60.000 banorë serbë të regjistruar atje, a jetojnë gjysma e tyre në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ KELMENDI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot ndodhemi para një fakti të ri dhe një ngjarje të re, e cila sipas pikëpamjes sime, duhet vlerësuar si një nga momentet kthesë në historinë e re të Kosovës.

Afrim, natyrisht, çdo njeri që e do këtë vend, e për më shumë, ka dhënë për këtë vend, nuk mund të jetë plotësisht i kënaqur me të gjitha pikat e kësaj marrëveshjeje, por nga ana tjetër, çdokush duhet të jetë i vetëdijshëm se ajo hap një rrugë të re, jo të nënshtrimit, por të afirmimit të vlerave të mëvetësisë sonë.

Albin, edhe unë, ashtu si shumë nga ju, në këtë sallë e jashtë saj, do të kisha dashur që marrëveshja në mes Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë të kishte vetëm katër pika ku të ishte shkruar shkurt e qartë, se njihet pavarësia e Kosovës, dëmshpërblehet ajo, lirohen edhe ata shqiptarë që po mbahen ende në burgjet serbe padrejtësisht, kthehen në atdhe viktimat e martirët e luftës sonë çlirimtare.

Kjo është e kuptueshme, por sa do qëllim mirë, në këtë fazë është edhe e paarritshme.

Liburn, me shtetin serb nuk jemi ndarë paqësisht, por përmes gjakut. Nuk jemi ndarë me dëshirën e tyre, por me luftën tonë dhe mentaliteti i tyre këtë do ta kuptojë, mjerisht, shumë vonë.

Marrëveshja që shtrohet para nesh, është, sipas bindjes sime, më e mira e mundshme, fillesa e një rruge të drejtë të përfshirjes së Kosovës në institucione ndërkombëtare, por edhe përpjekja më serioze për sensibilizimin e gjendjes politike në të gjitha anët e Kosovës. Duhet të ketë një fillim gjithnjë dhe ky është një fillim i cili, ndryshe nga fjalët e pazarit, ka një mbështetje të fuqishme nga bota politike perëndimore jo vetëm se pse është iniciuar prej tyre, por edhe sepse asgjë nuk na jep të drejtën të mendojmë se të gjithë na e kanë me hile dhe se vetëm ne në këtë sallë e jashtë saj qenkemi të vetmit që mendojmë për shtetin tonë.

Rexhë, të harrosh vlerat, veprimet e vyera të atyre që na ndihmuan në kohën më të vështirë, nuk është tipike e shqiptarëve në Kosovë. Megjithatë, nëse do të kishte qenë një marrëveshje sa për të qetësuar përkohësisht gjendjen e për të lënë pasojë më pas, unë nuk do të kisha qenë dakord, pasi më shumë se ndërkombëtarët, unë e dua Kosovën, por në këtë rast mund të them me bindje se angazhimi i tyre është serioz.

Albin, edhe pas marrëveshjes së Rambujesë, është menduar se tashmë nuk do të ketë Kosovë. Kemi shtetin tonë, pavarësinë, institucionet, gjykatat, po ndërtojmë strukturat e një shteti modern, sado që kjo ndodh me gabime, por shteti i Kosovës ekziston, edhe falë asaj marrëveshje.

Shtetet nuk ndërtohen në një ditë. Ata nuk bëhen të tillë sepse duan një grupim politik, por nga një shumësi faktorësh të cilët nuk shpërfillen vetëm se rritet shkalla e patriotizmit nëpër mbledhje e mitingje.

Unë i jap përkrahjen time kryeministrit të Kosovës, zotit Hashim Thaçi dhe në këtë, krahas bindjes sime, ka pasur jehonën e saj edhe mbështetja që i dha kësaj marrëveshjeje, lideri Ramush Haradinaj, e më pas edhe Isa Mustafa, si dhe përfaqësuesit e botës politike në të gjitha anët. Marrëveshja është fillesa, nuk është fundi, ai që shikon përpara do të shkojë edhe përpara.

Duke biseduar për marrëveshjen me një mikun tim, Halil Selimi, më tha, citoj: “Një konflikt shekullor po mbyllet, aspirata e luftës për liri po përfundon paqësisht, paqja po fiton mbi armiqtë”. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, kryetar!

Deputeti Ramiz Lladrovci, na e prezantoi një listë të dëshirave të tij në këtë foltore dhe na u drejtua konkretisht. Unë mendoj që dëshirat e tij janë plotësisht të realizueshme.

Ramiz, e ke rastin për ta ndihmuar shtet-ndërtimin, e ke rastin të jesh në përputhje me vlerat e UÇK-së, pra refuzojë këtë marrëveshje të dëmshme që na ka ardhur sot në Kuvend.

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Sot ndodhemi përballë Marrëveshjes më të dëmshme për sovranitetin dhe shtetësinë e Republikës sonë që prej përfundimit të luftës, më 1999.

Jemi dëshmitarë se që nga marsi i vitit 2011, kur filluan negociatat e padrejta me Serbinë, Qeveria e Hashim Thaçit i hyri një procesi të koncesioneve të pandalshme, por këto kompromise të vazhdueshme u kurorëzuan me një marrëveshje të turpshme për Kosovën, e cila, nëse do të kalojë apo jo, varet plotësisht nga ndërgjegjja dhe përgjegjësia juaj.

Kur shkoi në negociata kryeministri na premtoi se do t'i shpërbënte strukturat e Serbisë, në veri, po ai u kthye me një marrëveshje që i amnistion dhe i legalizon vrasësit e Enver Zymberit dhe dhjetëra shqiptarëve tjerë nga strukturat kriminale të Beogradit, prej shkurtit të vitit 2000 e deri sot.

Kur filluan negociatat, kryeministri tha: do t'i kthej të pagjeturit, por na e solli një marrëveshje e cila na e humb edhe një pjesë të territorit. Kur filluan negociatat Hashim Thaçi na tha se do ta përfshinte edhe çështjen e Luginës së Preshevës dhe të drejtat e shqiptarëve atje. Jo vetëm që nuk e bëri këtë gjë, por i tradhtoi edhe shqiptarët e veriut të Kosovës.

Kur shkoi në negociata, kryeministri ynë na tha se Serbinë do ta detyronte të na i paguante edhe reparacionet e luftës, por u kthye në Kosovë me një marrëveshje që strukturave të Serbisë tash duhet t'ua paguajmë edhe rogat.

Ky është një kryeministër që me këtë marrëveshje e ka shitur shtetësinë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës.

Zoti Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër në këtë Qeveri, tha se kjo marrëveshje është në përputhje me fuqinë e Kosovës, por unë mendoj që kjo marrëveshje nuk është në përputhje me fuqinë e Kosovës, por është plotësisht në përputhje me impotencën e kësaj Qeverie.

Cili kryeministër shqiptar mund ta pranojë një marrëveshje që në një pjesë të Kosovës ta ndajë pushtetin me Serbinë? Cili politikan shqiptar do t'ia pranonte Daçiqit kërkesën që FSK-ja të mos guxojë të jetë prezente në një pjesë të territorit tonë shtetëror?

Zonja dhe zotërinj, këtë gjë mund ta bëjë vetëm një njeri dhe askush tjetër, vetëm ai që për pushtet personal i bën të gjitha, që nuk njeh kufij, që nuk njeh interesa të popullit dhe nuk njeh gjak dëshmori, që nuk e njeh vuajtjen dhe sakrificat aq të mëdha të shqiptarëve që më në fund ta kenë edhe shtetin e tyre normal larg ndikimit të Serbisë. Këtë mund ta bëjë vetëm një person që është maja e korrupsionit në Kosovë.

Por unë nuk çuditem më së shumti me kryeministrin tonë, sepse e di që ashtu siç i thotë populli: "ai i ka shitur drutë moti". Nuk çuditem as me deputetët e komanduar të cilët e kanë dorëzuar integritetin e tyre moral në momentin që janë zgjedhur përmes manipulimit të votave nga strukturat parapolitike të partisë në pushtet.

Unë sot dëshiroj t'i jap vetes të drejtë ta shpreh indinjatën time të thellë në dy partitë e ashtuquajtura opozitare, Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, të cilat dje e pranuan këtë marrëveshje skandaloze.

Nuk e kam fjalën këtu për deputetët e veçantë të këtyre partive, që mund të jenë kritikë dhe e refuzojnë marrëveshjen, por po dua të them për qëndrimin zyrtar të këtyre subjekteve politike. Prandaj nuk po e kursej veten aspak nga të qenit i ashpër në kritikën time.

Prej ditës së djeshme, këto dy parti le të mos e quajnë më veten opozitare. Ky është dorëzim i lig para Hashim Thaçit, i cili po ju mban nën sqetull sa herë po ia do qejfi.

Dje dëgjuam Vjosa Osmanin, e cila ishte skeptike për marrëveshjen, kurse një ditë pas, partia e saj e pranon marrëveshjen. E dëgjuam Ahmet Isufin, i cili del e thotë se kjo marrëveshje do të na i ndryshojë edhe ligjet e Republikës së Kosovës, kurse partia e tij është e gatshme edhe për këtë çmim. Pra, që Daçiçi të na i ndërrojë edhe ligjet e Republikës sonë, kjo është e pahijshme. Si mund ta bëni vallë një gjë të tillë kur së paku përpara atyre që iu kanë votuar ju kanë votuar për ta sfiduar Qeveri.

Qytetarët sot e presin bashkimin e opozitës që ta shpëtojë interesin qytetar dhe shtetëror të Kosovës nga pangopësia dhe mbrapshtia e kësaj Qeverie aktuale, e jo që t'i bëhemi krah kësaj Qeverie në këto momente, kur po merr vendime shumë të gabueshme për Kosovën. Edhe sa gabime, që po u kushtojnë qytetarëve të Kosovës, duhet t'i bëjë kjo Qeveri që ju të bindeni se tash është çasti që ajo të ikë? A ka një moment të përshtatshëm për juve që të thoni se bashkimi për ta ndryshuar këtë Qeveri është më urgjent sesa pazaret që po i bën ky kryeministër, qoftë edhe me Serbinë?

Unë po u bëj edhe një herë thirrje deputetëve të këtij Kuvendi, por sidomos atyre që i thonë vetes përnjëmend opozitarë, që të mos e pranojnë një marrëveshje që i vendos themelet e autonomisë për veriun e Kosovës. Nëpërmjet këtyre vendimeve, mund të bëheni pjesë e legalizimit të ndarjes së Kosovës.

Kosova duhet të jetë një, dhe jo e ndarë në dy asociacione etnike. Në policinë dhe strukturat e Kosovës nuk ka vend për strukturat kriminale të Beogradit. Gjyqësia e Republikës së Kosovës është një, ne nuk duhet t'i ndajmë gjykatat tona në baza etnike. Do të shpresoj në zgjimin e ndërgjegjes tuaj deri në fund të këtij debati.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Beqiri për replikë.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Me keqardhje, por vërtet është diskutimi i pakuptueshëm i zotit Konjufca. Kjo Qeveri e Kosovës, ky kryeministër kurrë nuk është më i korruptuar për Glauk Konjufcën se sa për ne. Asgjë nuk është ajo që e thotë ky, e që s'e kemi thënë ne disa herë sa u përket të metave të kësaj Qeverie dhe të vetë kryeministrit. Por, nuk i jep të drejtë atij të na mbaj ligjëratë neve se si sillemi që për mendimin tonë, kur janë në pyetje interesat madhore, nacionale dhe shtetërore ne verojmë si subjekt politik.

Më vjen keq që kësisoj, siç mendon ai, opozita nuk bëhet, në kuptimin e asaj që duhet të themi çfarë ai mendon. Prandaj, unë mendoj që duhet t'i japë vërejtjet ai që ka për t'i dhënë për atë që mendon, por më së paku i takon të tjerëve t'u tregojë se çfarë duhet bërë.

Prandaj, ne e kemi thënë vazhdimisht, do ta themi përsëri , ato të meta, ato lëshime që i ka kjo Qeveri kemi ku t'i themi dhe do t'i themi vazhdimisht.

E sa i përket kësaj që është në rend dite, ne e kemi thënë qëndrimin tonë.

KRYETARI: Replikë, Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se ka deputetë të rinj që nuk dinë ta ndajnë momentin kur bëhet opozitë në Kosovë. E Aleanca më së paku ka nevojë t' i mbajë dikush leksione, qoftë patriotike, qoftë politike, qoftë për ta kuptuar momentin në të cilin gjendet Kosova. Definitivisht që vendimet i marrim vetë, jemi tepër të kujdesshëm për ato vendime që i marrim edhe nuk kemi nevojë ama bash hiq, aspak, të na kallëzoj dikush qysh duhet vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,

Duke marrë në trajtim me seriozitetin më të madh të mundshëm këtë temë për të cilën po flasim sot, duke parë edhe ndjeshmërinë edhe në diskursin publik, por edhe në realitetin që ne do të prodhojmë me vendimin tonë sot, unë jam i bindur se duhet t'i themi disa gjëra, dhe ato gjëra t'i themi hapur, direkt dhe me guxim.

Unë duhet të mos pajtohem me zëvendëskryeministrin Kuçi, i cili tha se kjo është forca jonë, ky është realiteti ynë, kaq mund të bëjmë. Unë mendoj se ne kemi shpërdoruar forcën tonë, ne kemi keq ndërtuar realitetin tonë, ne kemi keq ndërtuar shtetin tonë për 15 vjet dhe unë mendoj se ne e kemi prodhuar këtë pasojë si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve tona së bashku, veprime dhe mosveprime të cilat kanë dëmtuar realitetin tonë, kanë dëmtuar ndërtimin e shtetit tonë dhe kanë krijuar situatën në të cilën gjendemi.

Pse mendoj kështu? Mendoj kështu, për shumë arsye, ku ndër to, për 15 vjet ne nuk kemi mund të ndërtojmë shtet ligjor, për 15 vjet ne nuk kemi mund të ndërtojmë shtet të së drejtës, për 15 vjet ne nuk kemi mund të ndërtojmë shtet i cili kujdeset për këtë shoqëri, për 15 vjet ne nuk kemi ndërtuar shtet i cili ka ekonomi të zhvilluar.

Mos ndërtimi i këtij shteti, e ka prurë këtë realitet. Për 15 vjet ne nuk kemi arritur që të mbajmë zgjedhje të lira dhe demokratike në këtë vend. Ne kemi arritur të prodhojmë Kuvend jo përfaqësues, ne kemi arritur të prodhojmë qeveri jo përfaqësuese dhe ky realitet është për të cilin një përfaqësues ndërkombëtar ndalet dhe mendon dhe për të cilin nxjerr konkluzion, dhe për të cilin pastaj ne detyrohem të merremi e të ballafaqohemi me pasoja tona. Këto pasoja janë pasoja të dëmshme për këtë vend, këto pasoja janë pasoja të dëmshme për të ardhmen dhe për të tashmen, sepse shteti i cili është ndërtuar është shtet jo shtet i ëndrrave, jo shtet i luftës, jo shtet i paqes. As ata që e kanë praktikuar luftën, as ata që e kanë predikuar luftën, praktikuar paqen dhe praktikuar edhe luftën edhe paqen nuk e kanë ëndërruar këtë shtet. Ky shtet është një shtet i cili po e dëmton vetveten dhe po e dëmton të ardhmen e Kosovës.

KRYETARI: Për marrëveshjen, për rend dite, deputet!

ARBEN GASHI: Marrëveshja është pasojë e këtij shteti, e kësaj lloj qeverisjeje dhe sidomos kësaj Qeverie, dhe sidomos kësaj Qeverie. Dhe kjo pasojë, ku jemi ne sot, sikur të mbyllej sot do të ishte e keqe më e vogël. Problemi është se kjo do të vazhdojë, do të vazhdojë më 15 qershor dialogu dhe diskutimet politike për energjinë elektrike, për Postë-telekomunikacionin dhe për shumë çështje tjera dhe do të ketë edhe raunde tjera bisedimesh, negociatash, lëshimesh, pajtimesh dhe mospajtimesh. Këto do të jenë problemet e të ardhmes.

Cili është qëndrimi që e ka marrë Grupi ynë politik? Lidhja Demokratike e Kosovës ka marrë qëndrim që e përkrah marrëveshjen. Unë si pjesë e këtij grupi e përkrah edhe unë marrëveshjen. Mirëpo, këto janë shqetësimet e mia dhe shqetësimet e gjithsecilit deputet, janë shqetësime të gjithsecilit qytetar çka do të ndodh nesër, a do të ketë një raund tjetër bisedimesh, sepse disa herë është thënë këtu që s'do të ketë bisedime. U tha se nuk do të ketë bisedime kur u fol për Kosovën multietnike. U tha se nuk do të ketë bisedime kur... u tha standardet para statusit, u tha se nuk do të ketë bisedime kur u tha, standardet para statusit, u tha se nuk do të ketë bisedime më pas Vjenës, por prapë vazhduan. U tha se nuk do të ketë bisedime mbasi që të bëhet reforma kushtetuese, prapë vazhduan, u tha se nuk do të ketë bisedime, në bazë të bisedimeve teknike, prapë vazhduan.

Po thuhet që nuk do të ketë bisedime pas kësaj marrëveshjeje, jam i bindur se do të ketë bisedime, do të ketë edhe marrëveshje tjera, por çështja është si të organizohemi ne, si të ndërtojmë strukturën tonë, si të kemi planin tonë dhe si të bëjmë që bisedimet të jenë në favor të institucioneve të shtetit tonë dhe të popullit tonë. Kjo është çështja për të cilën ne duhet të angazhohemi. Ky është shqetësimi me të cilin ne duhet të ballafaqohemi, ky është realiteti i cili prodhohet sot dhe do të prodhohet edhe në të ardhmen. Prandaj ju kisha lutur që të jemi të arsyeshëm edhe në diskutime, të jemi të arsyeshëm edhe në vendime, edhe në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: I nderuari kryetar,
Meqë ka një kërkesë të deputetëve, që edhe u bë vonë, unë do ta dorëzoj fjalën time të shkruar në sekretari. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

Që nga Konferenca e Paqes së Rambujesë, sa herë që delegacionet e Kosovës janë ulur në tavolinën e bisedimeve më Serbinë, ato janë ndjekur nga opinioni me shqetësim dhe çdo fjalë e thënë është peshuar dhe analizuar sipas aftësive të njerëzve, duke i theksuar kuptimet e errëta të tyre.

Kjo frikë nga bisedimet për Atdheun tonë është mbjellë thellë në ndërgjegjen e shqiptarëve për një shekull e gjysmë, sepse sa herë është biseduar për ta, si pasojë, kanë plasur drama të tmerrshme njerëzore, me pasoja ta përjetshme.

Por, derisa bisedimet e dy shekujve të kaluar vërtet kanë përfunduar me pasoja të rënda për të ardhmen e vendit tonë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur në bisedimet e këtij shekulli.

Në të vërtetë, ka ndodhur e kundërta. Që nga bisedimet në Rambuje, Vjenë, për Pakon e Ahtisarit, për Shpalljen e Pavarësisë, GJND-ja, për Përfundimin e Pavarësisë së Mbikëqyrur, për njohjen e shtetit të Kosovës, për anëtarësim në institucione ndërkombëtare, bisedimet teknike, dhe tash së fundi edhe ato politike me shtetin serb për normalizimin e marrëdhënieve, me apo pa pjesëmarrjen e delegacioneve tona, në të gjitha këto takime, pozicioni politik, juridik e ndërkombëtar i Kosovës është avancuar përherë.

Duhet të përmendet fakti se bisedimet e fundit me Serbinë në Bruksel, frika dhe optimizmi i kanë përcjellë ato deri në fund, kur u nënshkrua kjo marrëveshje ndërmjet dy kryeministrave të dy vendeve, të Kosovës dhe Serbisë.

Këtë porosi na e përsëritën kohë më parë madje edhe dy lideret femra, e SHBA-ve dhe BE-së, zonjave Klinton dhe Eshton, gjatë vizitës që ato ia bënë shtetit tonë të ri, kur patën deklaruar: “Kufijtë e Kosovës janë vënë përgjithmonë dhe ata nuk do të ndryshojnë”.

Madje, zonja Klinton pati thënë se “SHBA-të do t’i qëndrojnë Kosovës pranë, derisa ajo ta përmirësojë qeverisjen dhe t’i kalojë pengesat me Serbinë”.

Të nderuar deputetë,

Populli i Kosovës dhe institucionet e tij u kanë besuar partnerëve euroatlantikë në përkushtimin e përbashkët për konsolidimin e shtetit dhe demokracisë së re të Kosovës.

Të gjithë kemi besuar se jemi në rrugën e duhur të ndërtimit të një shteti funksional, në themelet e të cilit është ekonomia e tregut të lirë dhe të drejtat e njeriut!

Edhe atëherë kur kemi konstatuar se një numër i partnerëve tanë kanë shtruar kërkesa radikale dhe kanë vepruar në kundërshtim me marrëveshjet e arritura bashkë, kemi qenë ne ata që jemi tërhequr, pothuajse në të gjitha kërkesat, me bindje të plotë se në këtë proces kthim prapa nuk do të ketë dhe se në fund do të fitojmë të gjithë. Kështu ka ndodhur edhe me fusnotën kaq shumë të përfolur.

Me këto bindje kemi qenë edhe atëherë kur është miratuar Pakoja e Ahtisarit dhe ligjet që kanë derivuar nga ajo!

Për më shumë, këtë pako e kemi toleruar edhe atëherë kur ajo është lexuar dhunshëm, siç është rasti me disa ligje të fundit!

Të nderuar deputetë,

Veriu për vendin tonë është çështje strategjike.

Gjatë gjithë këtyre viteve, Serbia e ka frenuar shtrirjen e pushtetit tonë atje, duke shkaktuar pengesa, për të cilat i ka përdorur qytetarët serbë të Kosovës.

Siç jemi në dijeni, në veri nuk ka pasur struktura paralele, por ka pasur vazhdimësi të qeverisjes së pushtetit të kohës së Milosheviqit. Ai pushtet është mbajtur nga nomenklatura e vjetër komuniste, me njerëz të njëjtë, me infrastrukturë të njëjtë

institucionale, e madje edhe me shumicën e ligjeve e rregulloreve të njëjta. Ato nuk ka pasur kush t'i ndërrojë, sepse atje nuk kemi pasur zgjedhje demokratike asnjëherë. Atje ka pasur dominime të klaneve sipas fuqisë fizike e të parasë.

Pothuajse të gjithë qemë mësuar me gjendjen në veri. Edhe shqetësimet e prezantuara ishin më shumë një konstatim i gjendjes sa për të thënë diçka si punë zakoni (rutine). Ne qemë mësuar me veriun e Perëndimit të egër, sikur që mësohet një familje me një të çmendur brenda!

Madje, për më keq, dikush u mësua që edhe të përfitojë nga ajo gjendje. Gradualisht u rrit krimi. Në një farë mënyre, veriu u eksportua në jug, e edhe jugu filloi të bëhej veri i Perëndimit të egër.

Kjo gjendje u bë e padurueshme, jo pse në veri ka më shumë serbë e në jug më shumë shqiptarë, por se në të dyja anët kishte interesa që i lidhnin edhe disa njerëz, të cilët e kishin një emër: krim i organizuar.

U desh të ndodhë 25 korriku, dhe ndërhyrja e Policisë për prishjen e një ekuilibri, i cili bashkë me ndërkombëtarët u krijua për më shumë se një deçenie. Ne, përkundër kësaj, e kemi përkrahur dialogun, si mundësinë e vetme për t'i zgjidhur problemet e grumbulluara për një shekull.

Për më keq, vetë protagonist i kryesor i këtyre bisedimeve, kryeministri Thaçi, është akuzuar vazhdimisht lidhur me këto bisedime, me paragjykime, sepse ne nuk kemi pasur asnjë shenjë se ai ka pranuar diçka jashtë Kushtetutës së Kosovës dhe jashtë kompetencave që i ka.

Të nderuar deputetë,
Në këto runde të bisedimeve, tashmë saktë u pa se në fokus të interesimit të delegacionit serb nuk kanë qenë interesat e serbëve të Kosovës, por kujdesi që nomenklatura e vjetër e kohës së Milosheviqit ta vazhdojë pushtetin në Serbi.

Është e rëndësishme se kjo marrëveshje e ka shtruar për zgjidhje një problem të madh, i cili ka pasur kosto të lartë edhe për Kosovën, edhe për Serbinë, e edhe për BE-në e SHBA-të.

Populli i asaj ane e ka paguar më së rëndi këtë gjendje, sepse nuk ka qenë e lehtë të jetohet për 14 vjet nën diktatin e bandave, nën tingujt tmerrues të sirenavë të alarmit, nën krismat e armëve në netët e pabesa.

Ata qindra njerëz (pronarë të paqes dhe qetësisë), të cilët në emër të nacionalizimit serb, agresivitetin e vet e kanë zbratur mbi civilët, bashkëkombësit e vet të pafajshëm!

Pikërisht për këta njerëz, urojmë që kjo marrëveshje të zbatohet sa më shpejt!
Për fund, dëshiroj t'i numëroj disa fakte, një pjesë e të cilave mund të jenë thënë edhe nga parafolësit:

1. Marrëveshja e arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk e tejkalon Pakon Ahtisari, por është marrëveshje në frymën e saj dhe ofron zgjidhje të qëndrueshme për veriun e Kosovës dhe integrim për popullatën serbe të asaj ane;
2. Ne organizimin e brendshëm shtetëror të Kosovës nuk është prishur sistemi kushtetues e juridik;
3. Kjo marrëveshje është rikonfirmim i shenjave për demokratizim të Serbisë dhe sfidë për ta pranuar demokratizimin e saj si domosdoshmëri;
4. Asociacioni që do të themelohet për komunat me shumicë serbe nuk e cenon organizimin e brendshëm të qeverisjes lokale në Kosovë, kjo d.m.th. se do të krijohet një asociacion i njëjtë sikur asociacioni aktual i komunave të Kosovës. E kjo është në harmoni me ligjet e Kosovës;
5. Asociacioni ka për qëllim ta krijojë një grup komunash që pastaj të reflektojë si një “komunë e madhe” brenda sistemit të qeverisjes lokale të Kosovës, por gjithnjë duke funksionuar sipas ligjeve të Kosovës dhe Kartës Evropiane për Vetëqeverisje;
6. Marrëveshja është në funksion të plotë të krijimit të marrëdhënieve të reja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe që kanë për qëllim realizimin e interesave vetjake shtetërore;
7. Zbatimi i marrëveshjes nuk do të jetë i lehtë. Suksesi do të duket kur kjo marrëveshje do të fillojë të zbatohet në pikën që ka të bëjë me organizimin e zgjedhjeve në veri.
8. Me këtë marrëveshje, Kosova është një hap para njohjes së 5 (pesë) shteteve të BE-së, një hap më afër integriteteve.

Duhet t’i falënderojmë SHBA-të dhe BE-në, të cilat kanë luajtur rol aktiv gjatë gjithë këtij procesi dhe ne presim me dashamirësi mbështetjen për zbatimin e kësaj marrëveshje.

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj ta përmend faktin se ne jemi i vetmi popull me të drejta të kufizuara të lëvizjes! Ne nuk mund të lëvizim pa viza, madje as në vendet e BE-së, të cilat kanë mbajtur përgjegjësi për ndërtimin e shtetit tonë dhe të demokracisë, e të cilat vazhdojnë të na mbajnë nën mbikëqyrje.

Kjo nuk ka qenë e paraparë në Pakon e Ahtisarit. Faleminderit!

Nijazi Idrizi, d.v.

KRYETARI: E ka fjalën nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,
Zoti kryeministër me ekipin tënd qeveritar,
Deputetë të nderuar,

Nuk është kaq e disiplinuar LDK-ja, se në LDK është thënë - njëri e jep një mendim, tani tjerët, a po e shihni që flasin. Domethënë, deputetët e kanë mandatin personal, thotë Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Po përtej kësaj, unë dola t’i them, jo pse më detyron dikush, por pse më detyron vetvetja, mandati detyrues qytetar, jo partiak.

Kjo marrëveshje që e kemi sot këtu dhe është për herë të parë, mbas 6 muajsh ne e kemi një tekst në dorë, i mirë, i keq, i dashur, jo i dashur, ne e kemi një evidencë. Zoti kryeministër, është hera e parë, ju e dini, shtatë herë kemi biseduar për këtë temë, shtatë herë kam folur në këtë foltore dhe vazhdimisht kam thënë: s'ka kurrgjë pa letra, sot e kemi një letër. Dhe, në këtë kuptim, e vlen, ndonëse letra në dorë na ka ardhur së paku mua nja 30 minuta para kësaj mbledhje, shumë vonë.

Mund të thuhet që ka qarkulluar, por unë gjithmonë mendoj që letra zyrtare është letër zyrtare, qarkullimet për portalet sociale mund të vijnë, të jenë të vërteta e të pavërteta, dhe edhe ky dokument nuk ka përkthim zyrtar dhe ju garantoj që tri variantet janë kaq të ndryshme sa që e çojnë njeriun në lajthitje.

Sido që të jetë, edhe një herë po them, një tekst e kemi, teksti thotë: Marrëveshje e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve, po, me kënd , kush, nuk thuhet. Kështu thuhet. Nga kjo që duken, këtu janë nja 15 pika.

Në të vërtetë, kolegë të nderuar dhe qytetarë, nëse na dëgjon dikush direkt ose indirekt, kjo në të vërtetë nuk është marrëveshje e parë për parime që rregullojnë normalizim të marrëdhënieve. Nëse titulli, emri e jep substancën, 'nomen est omen' thonë latinët, këta zotërinjtë e drejtësisë e dinë, atëherë kjo në të vërtetë do të duhej të ishte: Marrëveshje për statusin e bashkësisë serbe në veri të Kosovës. Të thuhet qartë.

Këto të 15 pikat nuk merren me asgjë tjetër veçse me statusin, organizimin, veprimin e serbëve në veri të Kosovës, po saktësoj, sepse jo dhe të gjithë serbëve që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Pra, çështja është kjo, tjetër është implikimet, mbasandaj, po të bëhet kjo, ne fitojmë këtë në bashkësinë ndërkombëtare brenda shtetit e tjera. Kjo është çështja. Dhe, këto 15 pika edhe në shikim të shpejtë, edhe në shikim të ngadalshëm, çka tregojnë? Tregojnë që, në të vërtetë prodhojnë një pushtet plus për, ju nëse doni quajini komuna me shumicë serbe në veri, nëse doni quajeni bashkësia e komunave me shumicë serbe në veri, prapë i bie statusi i serbëve në komunat e veriut të Kosovës, statusi serb.

Dhe të gjitha pikat e kanë temë themelore këtë problem, zonja e zotërinj. Dhe, ju jepet me këto 15 pika një pushtet plus serbëve në veriun e Kosovës.

Tash, me gjuhën legjislativë, me gjuhën politike i bie, do të duhet të bëjmë ne biseda të gjata, po unë s'dua t'i bëj. Jo, ka legjislativ, s'ka ekzekutiv. Ka, pushteti është ekzekutiv.

Kjo pjesë e popullatës tash, meqë s'po japin emër, se s'mund t'i jap unë emër tash, se s'i është definuar emri, unë mund t'ia përshkruaj, por të dhënat ia përshkruajnë emrin, unë s'e them, pushtet plus, po.

E pra, nëse i jepet pushtet plus kësaj pjese të popullatës ose po e quajmë qytetarëve të Republikës së Kosovës, absolutisht që krijohet asimetri e pushteteve, qoftë brenda këtij, ta quajmë, minoriteti, unë po e quaj nacionaliteti, çfarë doni thoni.

Për pasojë, ky pushtet plus, patjetër që e prek Kushtetutën, patjetër ligjet. Kot e themi ne s'e prek, po se po, nëse është pushtet plus, e prek.

Sa e prek? E, këtu është çelësi. Pse ne sot nuk duhet të ngutemi të bëjmë votime të nivelit kushtetues, se do të jetë gabim fatal edhe për Qeverinë nëse e lyp, edhe për Hashim Thaçin si kryenegociator dhe për këtë Kuvend. Se votimet për pasoja kushtetuese bëhen ngadalë, nuk jemi në prush, nuk jemi në luftë, shyqyr, momentalisht dhe nuk ka nevojë.

Ne po reflektojmë për situatën dhe duhet të jemi seriozë. Kjo është përgjegjësi e madhe. Çfarëdo ndryshimi që implikohet duhet të bëhet ngadalë, kujdesshëm, të studiohet, nëse duhet të bëhet. Unë po flas për pikëpamjet e mia. Ajo çka unë shoh këtu, ka implikime kushtetuese dhe ligjore, koha do të na tregojë.

Pra, meqë është kështu dhe unë mendoj kështu, sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës nuk duhet të kërkohet të bëhen votime të kësaj natyre vendosëse, por të kërkohet që këto pika të kthehen në program të detajuar - çka lypet me to, çka do me to dhe si një hartë e tërë, rrjet e tërë e kërkesave të sillat si tekst total, me detaje, atëherë mund të mblidhet Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të reflektojë thellë dhe të votojë kështu ose ashtu.

Sepse, keni kujdes, unë këtë po e them sot, e them edhe tjera herë nëse takohemi, le të jenë çfarëdo marrëveshje, le t'i kenë 15 pika, 8 siç i ka pasur përpara ose le t'i bëjë 25, për pa e njohur minoriteti serb i Kosovës pavarësinë e Kosovës dhe pa e njohur Republika e Serbisë, Kosovën e pavarur, nuk implementohen këto marrëveshje, nuk do të implementohen. S'do të mund t'i implementojë jo veç Kosova, Republika e Kosovës, duke biseduar, po themi hajde me Serbinë, por as miqtë tanë, të quajtur ndërkombëtarë, nuk do ta implementojnë këtë marrëveshje ose të tjetrën, ose rrjetin, strukturën e kërkesave për pa e pranuar serbët Kosovën si shtet të tyre të pavarur, kam të bëj me qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe pa e pranuar Serbia, Kosovën.

Kohën, këtu jemi, këto po regjistrohen, do ta shohim. Kur të ndodhë ajo, po, mund të. E kjo, pse kjo? Sepse kjo marrëveshje le të thuhet haptas, as s'iu ka dhënë serbëve, nominalisht, shenjat i ka, nuk i është dhënë autonomi çka ata lypin dhe Serbia mendon që vetëm në atë formë ata e mbrojnë jetën dhe lirinë e vet në Kosovë, as Serbia s'e ka njohur Kosovën. Domethënë, këtu është as, as dhe këtu ka të drejtë, në një mënyrë qysh e interpreton Hashim Thaçi, kryeministri thotë: kanë fituar të gjithë. Ose, s'kanë fituar kurrkush, qysh doni quajeni, po ajo i bie njësoj në esencë, sepse kërkesat e artikuluar nuk kanë ndodhur, ambiciet kanë mbetur. Kjo është marrëveshja për mosmarrëveshjen. Faleminderit!

KRYETARI: Diskutimin e fundit e ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Duke vlerësuar edhe temën, mirëpo duke e vlerësuar edhe kohën e të gjithë deputetëve, fjalimin tim do ta dorëzoj në formë të shkruar, në sekretari. Faleminderit!

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Unë diskutimin tim për këtë marrëveshje do ta filloj me deklaratën e ligjvënësit amerikan, Eliot L. Engel, demokrati më i lartë në Komisionin e Punëve të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve, i cili e përgëzoi Kosovën dhe Serbinë për arritjen e kësaj marrëveshjeje historike, i cili e vlerësoi lart kryeministrin Thaçi për guximin dhe gatishmërinë e tij për të marrë vendime të vështira dhe kryeministrin Daçiq për pragmatizmin e tij dhe vizionin për të ecur përpara.

Eliot Engel tha se marrëveshja dërgon një sinjal të qartë shprese për një rajon që kërkon t'i japë fund konfliktit dhe se popujt e tyre duan të jetojnë në paqe dhe prosperitet në Bashkimin Evropian. Ky është edhe një tjetër konfirmim i faktit se Kosova është e pavarur, sovranë dhe e lirë". Ai shton se shtetet e BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën - Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - tani duhet ta afirmojnë sovranitetin e Kosovës.

Se kjo marrëveshje e afirmon sovranitetin e Kosovës e dëshmoi edhe zëvendëskryeministri serb Vuçiq, i cili tha se "ky është maksimumi që kemi mundur të nxjerrim për popullin tonë në Kosovë". Kjo deklaratë e Vuçiqit është pranim i tërësisë territoriale të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, sepse përfaqësuesit e Serbisë në këtë dialog janë munduar që ta nxjerrin maksimumin për të drejtat e serbëve në Kosovë, dhe përfundimisht kanë hequr dorë nga idetë për ndarjet apo shkëmbim të territoreve.

Gjithashtu, deklarata e kryetarit të Partisë Demokratike Serbe, Vojislav Koshtunica, se Serbia në Bruksel është poshtëruar dhe detyruar nga Bashkimi Evropian që të jetë bashkëpjesëmarrëse në krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës, konfirmon se në fakt Serbia e ka njohur Kosovën.

Të nderuar koleg deputetë,

Deklarimet dhe veprimet e radikalëve në Serbi, çuditërisht apo jo, po përputhen me deklaratimet dhe veprimet e LVV. Pas marrëveshjes, Nikoliq, Daçiq dhe Vuçiq kanë marrë nëpërmjet sms-ve mijëra kërcënime për tradhti. Ju kujtohet se muaj më parë, qeveritarëve tanë u janë dërguar me mijëra sms kërcënues e shantazhues nga aktivistë të Lëvizjes "Vetëvendosje". Kjo metodë e kërcënimeve nëpërmjet sms-ve nga radikalët në Serbi dhe LVV në Kosovë duket se e ka origjinën dhe mësuesit e njëjtë.

Kur shikohen edhe deklaratat e Albin Kurti dhe "Vetëvendosjes", në përgjithësi nuk dallojnë në koncept dhe përmbajtjeje me deklaratat e radikalëve në Serbi dhe atyre në veri.

Albin Kurti tha se marrëveshja e arritur në Bruksel është marrëveshje personale e Thaçit dhe ajo nuk duhet të bëhet edhe marrëveshje e Kosovës me Serbinë.

Deklaratë pothuajse identike dha edhe Kërstimir Pantiq, një lider radikal i veriut, i cili marrëveshjen e vlerësoi si marrëveshje ndërmjet Thaçit dhe Daçiqit dhe ata radikalët në veri nuk do ta respektojnë.

Duke e njohur për një kohë të gjatë Albin Kurtin, dhe dilemat e ngrehura për të, si duket, ai do të vazhdojë të mbetet një promotor i politikës radikale serbe në Kosovë, duke e mohuar shtetësinë e Kosovës, simbolet dhe Kushtetutën e saj, ashtu siç e mohojnë edhe tutorët e tij radikalë në Serbi dhe në veri të vendit.

Kjo marrëveshje u përkrah nga të gjitha shtetet e Bashkimi Evropian, nga SHBA-të, presidenti Obama, sekretari i Kombeve të Bashkuara Ban Ki-Mun, shqiptarët në Shqipëri, Maqedoni e Kosovë, me përjashtim të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe radikalëve serbë në Kosovë dhe Serbi.

Të nderuar deputetë,

Kjo marrëveshje do të hapë rrugën evropiane edhe të Kosovës, edhe të Serbisë, por edhe të rajonit. Me këtë marrëveshje besoj se përfundimisht po përfundon epoka e luftërave dhe konflikteve në këtë pjesë të rajonit.

Përparësi tjetër e kësaj marrëveshjeje është se iu vu kapaku temave patriotike dhe tani politikanët dhe qytetarët do të trajtojnë temat boshtore të zhvillimit ekonomik, të ngritjes së infrastrukturës më të mirë në çdo cep të Kosovës, do të merremi me projekte zhvillimore në bujqësi, turizëm, kulturë, sport etj., ndërsa ne si deputetë do të angazhohemi në hartimin e ligjeve më të mira në shërbim të vendit tonë dhe qytetarëve. Faleminderit!

Bekim Haxhiu, d.v.

KRYETARI: Atëherë, fjala e fundit, është e kryeministrit. Zoti kryeministër e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës...

(Ndërhyrje e deputetëve të “Vetëvendosjes”)

Dëshiroj që të vazhdoj...

KRYETARI: Ju lutem! Ju lutem!

(Vazhdon ndërhyrja e Lëvizjes “Vetëvendosje”.)

KRYETARI: Uluni! Do ta bëjmë një pauzë, për 10 minuta.

(Ndërprerje e mbledhjes)

(Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës)

KRYETARI: Unë po kërkoj edhe një herë nga Grupi i “Vetëvendosjes”, që ta ndërpresë këtë dhe të vazhdojë seanca.

(Ndërhyrje e Lëvizjes “Vetëvendosje”)

Fjalën e ka kryeministri, në emër të deputetit Xhavit Haliti.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Më lejoni që të prezantoj Rezolutën për dhënien e pëlqimit për nënshkrimin e Marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, pra propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, shpreh përkrahje dhe jep pëlqimin për nënshkrimin e marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve e cila është përafuar me 19.4. 2013 nga kryeministri i Republikës së Kosovës dhe kryeministrit të Republikës së Serbisë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet e përmbajtura në këtë marrëveshje.

Kjo rezolutë hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prandaj, deputetë të nderuar, duke ju falënderuar për mbështetje, ju ftoj që ta jepni pëlqimin dhe votimin që do të përcillet tash. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Nëse e keni dëgjuar atë që e tha kryeministri....

(Ndërhyrje e Lëvizjes “Vetëvendosje”)

Kryetarët e grupeve parlamentare, a duan të deklarojnë? Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka vlerësuar dhe e vlerëson shumë lart këtë marrëveshje e cila është arritur dhe Rezolutën të cilën e paraqiti Qeveria e Republikës së Kosovës, e vlerëson si një hap shumë pozitiv në aspektin kombëtar dhe i jep mbështetje dhe u bën thirrje të gjithë deputetëve që të votojnë për të. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, e ka fjalën kryetari i Grupit, Ismet Beqiri. Prezentë janë 102 deputetë, plus 7, gjithsej 109. Nuk mund “Vetëvendosja” ta imponojë demokracinë këtu, prandaj ju lutem shko poshtë dhe mos e pengoni punën.

(Ndërprerje e incizimit)

Është ky vullnet i deputetëve dhe unë s'mund ta ndryshoj mendimin e asnjë grupi parlamentar e as ju s'mund ta ndryshoni. Ajo është çështje tjetër, këtu në Kuvend, nuk ka, ju lutem.

(Ndërhyrje....: Nuk është demokraci kjo!)

ISMET BEQIRI: Kryetar,

Ne e kemi thënë qëndrimin tonë, edhe pse vërtet s'janë kurrfarë kushtesh për të punuar, po ne qëndrimin e kemi dhënë më herët dhe s'kam çka të them më tepër.

KRYETARI: Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Kryetar, mendimet i kemi thënë, po më duket që duhet më shpejt ta përmbyll këtë seancë. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

Tani e bëjmë një pauzë, një orë!

(Pas pauzës, seanca e vazhdoi punën.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në konsultim me kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit, jemi marrë vesh që të vazhdohet me seancën.

Të pranishëm janë 102 deputetë, plus 7, gjithsej 109. Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Zoti kryetar,

Ju lutem, mos lejoni të vazhdohet kjo seancë dhe të miratohet apo të votohet kjo rezolutë!

Zoti kryetar,

Duhet të jemi të gjithë të vetëdijsëm se kjo rezolutë është kundër interesave të qytetarëve të Kosovës, kjo rezolutë është kundër pavarësisë së Kosovës. Mos e lejoni. Sot është mëngjesi më i rëndësishëm për Kosovën.

Mos e lejoni sepse edhe ju, edhe të gjithë ne, do t'i bimë pishman dikur, por do të jetë vonë.

Nuk kemi nevojë të shkojmë prapa tradhtisë. Do të duhet ta ruajmë pavarësinë e Kosovës, ashtu siç e keni shpallur.

Prandaj, kjo rezolutë është kundër interesave të qytetarëve të Kosovës. Kjo rezolutë vetëm interesat e klaneve të Hashim Thaçit i mbron, nuk mbron interesin e Kosovës, nuk mbron interesin e pavarësisë së Kosovës.

Mos e lejoni, zoti kryetar, Jakup Krasniqi, mos e lejo! Mos e lejo! Mos e lejo, sepse nesër do të jetë vonë. Sot është mëngjesi më i rëndësishëm për atë që kanë luftuar dhe që kanë

punuar qytetarët e këtij vendi, është mëngjesi më i rëndësishëm, është nyja, është udhëkryqi: O me Kosovën jashtë Serbisë, o me Serbinë brenda Kosovës. Prandaj, vendosni për të parën - Me Kosovën jashtë Serbisë. Nuk na duhet Serbia as në veri, as në Parlamentin e Kosovës.

Është në duart e të gjithë deputetëve që sot të ndahen në mes turpit dhe në mes detyrës që e kanë si deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës.

(Ndërprerje e gjatë e incizimit)

KRYETARI: Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati.

(Ndërhyrje: Mos votoni, ju lus të gjithëve!)

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

(Ndërhyrje: Mos votoni!)

Kosntatoj se janë gjithsej 89 vota për, 5 kundër dhe 1 abstenim.

Mirupafshim në seancën tjetër!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*